Funded by the European Union

SEESAC

RegionalCooperationCouncil

# STUDIM MBI FAKTORËT QË NXISIN KËRKESËN PËR ARMË ZJARRI DHE KEQPËRDORIMIN E TYRE NË BALLKANIN PERËNDIMOR – **GJETJET DHE REKOMANDIMET**



# STUDIM MBI FAKTORËT QË NXISIN KËRKESËN PËR ARMË ZJARRI DHE KEQPËRDORIMIN E TYRE NË BALLKANIN PERËNDIMOR – **GJETJET DHE REKOMANDIMET**

# Përmbajtja

**Pikat nxitëse: vlerësimi i kërkesës për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor** **10**

Përmbledhje ekzekutive **11**

Hyrje **14**

**Seksioni 1. Aspektet metodologjike** **15**

**Seksioni 2. Teorizimi i kërkesës për armë zjarri** **19**

**Seksioni 3. Shqyrtimi i literaturës mbi kërkesën për armë zjarri** **23**

Faktorët e përzgjedhur të rrezikut **25**

Shqyrtimi i faktorëve mbrojtës **31**

**Seksioni 4. Perceptimet e publikut mbi pasigurinë dhe pronësinë e armëve të zjarrit** **34**

**Seksioni 5. Perspektivat e ekspertëve mbi kërkesën për armë zjarri** **64**

Lidhjet kulturore dhe simbolike me armët e zjarrit **66**

Debatet e vazhdueshme mbi ligjet shtrënguese për armët e zjarrit **67**

Arsyet e lidhura me sigurinë, statusin dhe simbolizmin **69**

Ekspozimi i drejtpërdrejtë dhe trashëgimia historike **70**

Paqartësia mbi aksesin e ligjshëm në armë zjarri **72**

Lehtësia e perceptuar e blerjes së armëve të zjarrit të paligjshme **74**

Normalizimi i armëve të zjarrit tek të rinjtë dhe ndryshimet ndër breza **76**

Narrativat në media ndikohen nga konfliktet **77**

Strategjitë e juridiksioneve dhe situata reale e zbatimit **79**

| | |
|---|---|
| **Seksioni 6. Ndikimet e ligjeve për armët e zjarrit në kufizimin e kërkesës për armë zjarrit** | **81** |
| **Seksioni 7. Kërkesa për armë zjarri në sferën dixhitale** | **85** |
| **Seksioni 8. Gjetjet dhe rekomandimet** | **89** |
| Gjetjet kryesore | **90** |
| Rekomandimet strategjike | **97** |
| **Shtojca 1. Shqyrtimi i hipotezave të përzgjedhura mbi kërkesën për armë zjarri** | **104** |
| **Shtojca 2. Shpjegimi i elementeve që ndikojnë te faktorët e përzgjedhur të kërkesës dhe mbrojtjes.** | **107** |
| **Shtojca 3. Analiza statistikore e variablave parashikues dhe klasifikues** | **110** |
| **Referenca të përzgjedhura** | **111** |

# Tabela e figurave


| | |
|---|---|
| **Figura 1.** | Teorizimi i kërkesës për armë zjarri |
| **Figura 2.** | Konceptualizimi i faktorëve të rrezikut dhe faktorëve mbrojtës |
| **Figura 3.** | Faktorët e përsëritur të rrezikut dhe mbrojtës të identifi kuar në literaturë në Ballkanin Perëndimor |
| **Figura 4.** | Sa i sigurt apo i rrezikshëm është rajoni i Ballkanit Perëndimor? |
| **Figura 5.** | Perceptimet mbi sigurinë: sa të sigurta i konsideroni situatat në vijim, sipas kategorisë? |
| **Figura 6.** | Sa shpesh mendoni se banorët në vendbanimin tuaj përjetojnë llojet e dhunës në vijim? |
| **Figura 7.** | Perceptimet mbi sigurinë: cila është mënyra më efi kase për të përmirësuar sigurinë? |
| **Figura 8.** | Si ndiheni lidhur me mbajtjen e armëve të zjarrit në shtëpi? |
| **Figura 9.** | Efektet e mbajtjes së armëve të zjarrit në shtëpi, sipas ndjenjës së sigurisë, në shtatë situata të përditshme - Nëse do të kishit armë zjarri në shtëpi, a do të ndiheshit |
| **Figura 10.** | Jepni mendimin tuaj në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 nënkupton “Nëse të gjithë do të kishin akses në armë zjarri, do të kishte më pak krim” dhe 10 nënkupton “Nëse të gjithë do të kishin akses në armë zjarri, do të kishte më shumë krim”? |
| **Figura 11.** | Duke mos përfshirë profesionet që lidhen me mbajtjen e armëve të zjarrit (policia, ushtria, shoqëritë private të sigurisë), cila mendoni se është arsyeja kryesore për të mbajtur armë zjarri? |
| **Figura 12.** | Sa i pranueshëm është përdorimi i armëve të zjarrit në secilën prej situatave në vijim? |
| **Figura 13.** | Sa është përqindja e banorëve në juridiksionin tuaj që zotërojnë armë zjarri (të ligjshme apo të paligjshme) |

| | |
|---|---|
| **Figura 14.** | Pa përfshirë personat që zotërojnë, mbajnë, apo përdorin armë zjarri në kuadër të detyrës (policia, ushtria, shoqëritë private të sigurisë), a njihni personalisht dikë që zotëron apo përdor armë zjarri? |
| **Figura 15a.** | A keni pasur përvoja personale me të paktën një situatë që përfshin armë zjarri? |
| **Figura 15b.** | A keni pasur përvoja personale me të paktën një situatë që përfshin armë zjarri? |
| **Figura 16.** | Përqindja e banorëve që kanë përjetuar të paktën një nga dhjetë skenarët që përfshijnë përdorimin e armëve |
| **Figura 17.** | Kush i ka kryer aktet më të fundit të dhunës me armë? |
| **Figura 18.** | A do të mbanit një armë zjarri? |
| **Figura 19.** | Nëse dikush në familjen tuaj, ose një mik i ngushtë, do t'ju thoshte se po mendon të marrë armë zjarri, si do të reagonit? |
| **Figura 20.** | Cila është arsyeja kryesore se pse zotëroni apo do të dëshironit të zotëronit një armë zjarri |
| **Figura 21.** | Cila është arsyeja kryesore se pse zotëroni apo do të dëshironit të zotëronit një armë zjarri, sipas juridiksionit |
| **Figura 22.** | Si do e vlerësonit procedurën e ligjshme për blerjen e një arme zjarri në juridiksionin tuaj? |
| **Figura 23.** | Në opinionin tuaj, sa të aksesueshme janë armët e qqzjarrit të paligjshme në juridiksionin tuaj? |

Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) është iniciativë e përbashkët e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR), të financuar Bashkimit Evropian, e cila ka për qëllim forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe rajonale për kontrollin dhe pakësimin e përhapjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta, duke kontribuuar kështu në rritjen e stabilitetit, të sigurisë dhe të zhvillimit në Evropën Juglindore dhe Lindore.

Ky botim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, nëpërmjet projektit *Mbështetje për përmirësimin e luftës kundër zotërimit të jashtëligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor,* të financuar nga Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II).

**Për më shumë informacion, kontaktoni**:
Drejtuesen e SEESAC
Bulevar Zorana Đinđića 64,
11000 Belgrade Serbia
Tel.: +381 11 415 5300
Faks: +381 11 415 5359
www.seesac.org

**Botuesi:**
Zyra Qendrore e Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC)

**Deklaratë për mohimin e përgjegjësisë**
Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian. Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialeve në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë opinioni nga ana e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian, për sa i përket: 1) statusit ligjor të secilit vend, territor ose zonë, ose të autoriteteve apo grupeve të tij të armatosura; ose 2) përcaktimit të vijave kufitare ose kufijve të tij.

**Redaktoi:**
Alain Lapon, Juliana Buzi,
Dragan Božanić, Tatjana Višacki

**Përkthimi:**
Alba Global

**Dizajni dhe paraqitja grafike:**
KNAP

**Printimi:**
Bigraf Plus, Beograd

**Qarkullimi:**
25 copë

© SEESAC 2025 - Të gjitha të drejtat të rezervuara

ISBN-978-86-7728-400-8

# Falënderime

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për Konsulentin Drejtues të SEESAC, Dr. Robert Muggah, i cili ofroi një analizë profesionale dhe hartoi raportin përmbledhës bazuar në të dhënat e siguruara nga një ekip studiuesish të Ipsos nga gjashtë juridiksione të Ballkanit Perëndimor (BP).

Analiza dhe raporti janë pasuruar me njohuritë e vlefshme të ofruara nga ekspertë të institucioneve të ndryshme të Ballkanit Perëndimor, të cilëve u shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë, ku bëjnë pjesë: Njësitë Qendrore për Armët e Zjarrit, përfaqësuesit nga Ministritë e Brendshme dhe shërbimet policore; ekspertët ligjorë dhe specialistët nga Regjistrat Qendrorë të Armëve dhe përfaqësuesit e prokurorive. Analiza është pasuruar gjithashtu me njohuritë e: drejtuesve të shoqatave të gjuetisë dhe qitjes sportive, psikologëve/punonjësve socialë/mësuesve që punojnë me të rinjtë, gazetarëve dhe shitësve të armëve.

Analiza është pasuruar gjithashtu në mënyrë të konsiderueshme me kontributet dhe komentet e anëtarëve të ekipit të SEESAC, konkretisht: Jelena Bujaković, Martin Van Der Meij, Danijela Đurović, Iva Savić, Violeta Gaši, Vesna Cipruš, Edin Serezlić, Andreja Marčenko dhe Ana Zavišić.

# FAKTORËT NXITËS: VLERËSIMI I KËRKESËS PËR ARMË ZJARRI NË BALLKANIN PERËNDIMOR

# Përmbledhje analitike

Kërkesa e civilëve për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor nxitet nga një ndërthurje komplekse e pasigurisë personale, trashëgimisë kulturore, mosbesimit ndaj institucioneve dhe trashëgimit të konflikteve të së shkuarës. Ky raport jep një analizë gjithëpërfshirëse, të mbështetur në të dhëna, të faktorëve që ndikojnë te zotërimi i armëve të zjarrit në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Serbi, Mal të Zi, Kosovë[1] dhe Maqedoninë e Veriut. Ky studim i porositura nga Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) është synuar për politikëbërësit, agjencitë ligjzbatuese, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, duke ofruar njohuri mbi faktorët që nxisin blerjen e armëve të zjarrit dhe mbi kushtet që e nxisin ose e frenojnë kërkesën.

Në thelb të studimit qëndron një kuadër teorik novator që e konceptualizon kërkesën për armë zjarri si funksion i tre kushteve të ndërlidhura: preferencave, çmimeve dhe burimeve. Këto kushte vlejnë si për tregjet e ligjshme, ashtu edhe për ato të paligjshme dhe ndikohen nga përvojat individuale (si historiku i viktimizimit), faktorët familjarë (duke përfshirë paqëndrueshmërinë familjare), dinamikat e komunitetit (duke përfshirë ndikimet e bashkëmoshatarëve) dhe faktorët shoqërorë (si shteti i së drejtës, normat gjinore dhe trashëgimi i konflikteve). Kuadri bën gjithashtu dallimin midis faktorëve të rrezikut (p.sh. normat që lidhen me maskilizmin, mosbesimin ndaj agjencive ligjzbatuese, ekspozimin ndaj dhunës) dhe faktorëve mbrojtës (p.sh. besimi tek institucionet, rregullimi efektiv, normat kundër dhunës), duke ofruar një qasje shumëdimensionale për vlerësimin e kërkesës për armë zjarri në rajon.

Studimi përdor një qasje të mirëstrukturuar që ndërthur disa metoda, duke përfshirë një anketim të shtresëzuar mbi perceptimet me më tepër se 6,200 persona të anketuar në gjashtë juridiksione, 18 diskutime në grupe fokusi, 6 "grupe krize" dhe mbi 40 intervista me ekspertë (ose Intervista me Informatorë Kyç - IIK) me palë të interesuara si rezidentë, pronarë të armëve të zjarrit, shitës legjitimë të armëve, gazetarë, ekspertë të shëndetit publik dhe zyrtarë publikë. Gjithashtu, studimi shqyrtoi mbi 30 ligje nga rajoni për armët e zjarrit dhe katër direktiva të BE-së për armët e zjarrit nga viti 2008 deri në vitin 2021 dhe përfshin një analizë të monitorimit në mediat sociale të mbi 3 milionë përmendjeve të armëve të zjarrit në platformat e lajmeve dhe rrjeteve sociale. Ky triangulim metodologjik siguron thellësi empirike dhe ndjeshmëri kontekstuale.

Ndër gjetjet e shumta nga anketimi mbi perceptimet, diskutimet me grupe fokusi dhe IIK-të, vlen të përmendim ato më poshtë:

1 Për sa i përket Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, referencat ndaj Kosovës interpretohen në kontekstin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999). Për sa i përket Bashkimit Evropian, ky emërtim nuk cenon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

• **Mungesa e perceptuar e sigurisë nxit kërkesën për armë zjarri, por besimi në vlerën e tyre mbrojtëse mbetet i ulët:** Ndërsa afërsisht një e treta e të anketuarve në mbarë Ballkanin Perëndimor përmendin sigurinë personale si arsyen kryesore për zotërimin e armëve të zjarrit, gjysma besojnë se të pasurit e një arme në shtëpi nuk e rrit ndjesinë e tyre të përgjithshme të sigurisë. Vetëm një në pesë të anketuar mendojnë se armët e zjarrit do ta përmirësonin realisht sigurinë në shtëpi, gjë që tregon se, ndonëse pasiguria nxit interesin për zotërimin e armëve, kjo nuk përkthehet domosdoshmërish në besim tek efektiviteti i tyre si mjete mbrojtëse.

• **Faktorët demografikë dhe gjinorë ndikojnë në k**ërkesën për armë **zzjarri:** Burrat janë gjithnjë e më në favor të zotërimit dhe përdorimit të armëve të zjarrit, krahasuar me gratë. Mbi 50 përqind e të anketuarve meshkuj pohojnë se kanë përdorur armë zjarri, krahasuar me pak më shumë se 10 përqind te gratë. Gjithashtu, **meshkujt me të ardhura të larta dhe meshkujt e rinj** të moshave 18-40 vjeç priren të shprehin interes më të madh për zotërimin e armëve të zjarrit, krahasuar me brezat më të vjetër ose të anketuarit me më pak të ardhura, gjë që tregon për një ndryshim të mundshëm në modelet e kërkesës në të ardhmen.

• **Normat sociale dhe kulturore dhe praktikat tradicionale diktojnë preferencat për blerje dhe zotërim të armëve të zjarrit:** Faktorë të tillë si gjuetia, rekreacioni dhe ritualet festive ndikojnë te kërkesa për armë zjarri, veçanërisht te burrat. Në Mal të Zi, tradita është një ndër arsyet kryesore për zotërimin e armëve, ndërsa në Shqipëri, rekreacioni dhe statusi përbëjnë motive të rëndësishme.

• **Perceptimi i niveleve të larta të zotërimit të armëve të zjarrit pasqyron familjaritetin shoqëror:** Gati dy të tretat e banorëve të Ballkanit Perëndimor vlerësojnë se gjysma e bashkëqytetarëve të tyre zotërojnë armë zjarri, me një pakicë të konsiderueshme që besojnë se zotërimi tejkalon 50 përqind. Këto perceptime variojnë ndjeshëm nga njëri juridiksion në tjetrin. Banorët e Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës kanë më shumë gjasa të perceptojnë nivele më të larta të zotërimit, krahasuar me Serbinë, Shqipërinë dhe Kosovën.

• **Legjislacioni kompleks për armët e zjarrit ndikon te kërkesa për armë zjarri:** Përgjithësisht, banorët i perceptojnë procedurat ligjore për blerjen e armëve të zjarrit si komplekse dhe të vështira për t'u kuptuar. Pothuajse gjysma e tyre nuk ndihen të informuar mjaftueshëm në lidhje me procesin ligjor të blerjes, ku gratë raportojnë një nivel më të ulët informimi se burrat. Të anketuarit në Mal të Zi e perceptojnë procesin si më të thjeshtë krahasuar me mesataren rajonale, ndërsa shumica dërmuese e të anketuarve nga Shqipëria dhe Serbia e përshkruajnë atë si të ndërlikuar. Kjo mospërputhje në perceptimet lidhur me qartësinë e kuadrit rregullator ndikon te kërkesa dhe qëndrimet ndaj zotërimit të ligjshëm të armëve të zjarrit.

• **Ekspozimi i të rinjve ndaj incidenteve me armë zjarri në internet ngre shqetësime lidhur me normalizimin e fenomenit:** Mbi 80 përqind e të anketuarve shprehen të shqetësuar për ekspozimin e të rinjve ndaj përmbajtjeve të dhunshme në media dhe 65 përqind nuk janë dakord që fëmijët të luajnë me armë lodër. Këto qëndrime kundërshtuese janë më të theksuara në Shqipëri dhe Bosnjë-Hercegovinë, dhe më pak në

Kosovë dhe Mal të Zi. Normalizimi i armëve të zjarrit tek të rinjtë në veçanti vështirëson përpjekjet për kontrollin e armëve të zjarrit.

• **Mediat tradicionale dhe dixhitale përforcojnë qëndrimet pozitive ndaj armëve të zjarrit:** Pjesëmarrësit në grupet e fokusit identifikuan mediat tradicionale dhe dixhitale si nxitës të fuqishëm në krijimin e qëndrimeve pozitive ndaj armëve të zjarrit, veçanërisht midis të rinjve. Raportimi provokues mbi krimin dhe dhunën, së bashku me portretizimet e armëve të zjarrit si simbole të heroizmit dhe fuqisë në kulturën popullore, e përforcojnë kërkesën. Platformat e rrjeteve sociale e normalizojnë më tej zotërimin e armëve të zjarrit mes të rinjve, gjë që ndërlikon përpjekjet për kontrollin e armëve të zjarrit dhe tregon nevojën për nisma edukative të targetuara.

• **Ekziston një mbështetje e fortë publike për kontrolle më të rrepta të armëve të zjarrit, pavarësisht frikës nga krimi dhe pasiguria.** Shumica e të anketuarve mbështesin fuqimisht kryerjen e kontrolleve më të rrepta të armëve të zjarrit, ku më shumë se gjysma besojnë se aksesi universal në armët e zjarrit do të rriste nivelin e krimit. Kjo ndjesi është veçanërisht e fortë te grupmoshat e mëdha dhe grupet ekonomisht të disavantazhuara. Vetëm një pakicë e sheh zotërimin në masë të armëve si një faktor që redukton krimin.

Vlerësimi nënvizon se kërkesa për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor nuk mund të kufizohet në një faktor të vetëm. Përkundrazi, ajo është rezultat i një sistemi kompleks ku ndërthuren faktorët personalë, socialë, ekonomikë dhe kulturorë. Duke analizuar preferencat, çmimet dhe burimet nga këndvështrimi i faktorëve të rrezikut dhe të mbrojtjes në nivele të ndryshme, ky studim ofron një bazë të fortë konceptuale për projektimin e ndërhyrjeve të përshtatura sipas kontekstit. Sikurse thekson raporti, ulja e kërkesës për armë zjarri kërkon më shumë sesa thjesht zbatimin e ligjit dhe kontrollin e furnizimit: ajo kërkon një ndryshim strategjik në mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit për të kuptuar dhe influencuar kushtet në të cilat individët zgjedhin të pajisen ose jo me armë.

Raporti përmbyllet me gjashtë rekomandime strategjike për të ulur kërkesën për armë zjarri dhe keqpërdorimin e tyre: (1) realizimi i fushatave të qëndrueshme të ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut, të cilat targetojnë në veçanti burrat në moshë të re dhe familjet e tyre; (2) rritja e sigurisë publike dhe rindërtimi i besimit tek institucionet e policisë dhe të drejtësisë; (3) përmirësimi i sistemeve të licencimit të armëve të zjarrit me vlerësime të bazuara në rrezik dhe monitorim pas marrjes së licencës; (4) nxitja e zotërimit të përgjegjshëm të armëve të zjarrit, ruajtjes së sigurt dhe çarmatimit vullnetar; (5) forcimi i koordinimit rajonal dhe institucional për të kontrolluar qarkullimin e jashtëligjshëm; si dhe (6) përdorimi i platformave dixhitale dhe influencuesve për të sfiduar narrativat pro armëve dhe për të promovuar alternativa konstruktive. Së bashku, këto rekomandime ofrojnë një udhërrëfyes për një ulje gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në prova të kërkesës për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor, në përputhje me Udhërrëfyesin për Kontrollin e AVL-ve 2025-2030 (SEESAC, 2024).

# Hyrje

Dhuna me armë zjarri ka kosto të mëdha në mbarë Ballkanin Perëndimor. Nga qendrat urbane e deri te zonat rurale, trashëgimi i konflikteve të armatosura, mbizotërimi i krimit të organizuar, prania e vazhdueshme e dhunës në familje dhe kontrolli i pabarabartë i armëve të zjarrit kanë kontribuar në nivele vazhdimisht të larta të zotërimit dhe keqpërdorimit të armëve. Në të gjashta juridiksionet, duke përfshirë Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, ndikimet sociale, politike dhe ekonomike të dhunës me armë janë të prekshme. Keqpërdorimi i armëve të zjarrit shkakton dëme fizike dhe psikologjike, cenon besimin e publikut ndaj institucioneve dhe komprometon stabilitetin dhe zhvillimin. Ndonëse autoritetet juridiksionale dhe përkrahësit ndërkombëtarë kanë bërë përparime drejt reduktimit të furnizimit me armë të paligjshme, përmes amnistive, kufizimeve të zotërimit, menaxhimit të stoqeve dhe formave të tjera të bashkëpunimit rajonal, ka ende mangësi të dukshme në përpjekjet për të ulur kërkesën për armë zjarri.

Ky raport, i porositur nga SEESAC, synon të plotësojë këto mangësi. Në vend që të fokusohet te masat e kontrollit të armëve të zjarrit nga krahu i ofertës, ai shqyrton motivet komplekse që qëndrojnë pas zotërimit dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Duke u bazuar tek anketimet mbi perceptimin të porositura kohët e fundit, si dhe te diskutimet me grupe fokusi me të rinj, zotërues të armëve të zjarrit, profesionistë të shëndetit, gazetarë, oficerë ligjzbatues, dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile, studimi heton faktorët psikologjikë, socialë, ekonomikë dhe kulturorë që nxisin kërkesën. E pasuruar me një shqyrtim të literaturës akademike, kontribute nga zyrtarë publikë dhe specialistë joqeveritarë dhe vlerësime novatore të monitorimit në mediat sociale, analiza hedh dritë jo vetëm mbi kategoritë e personave të armatosur, por edhe mbi arsyet që çojnë në pajisjen e tyre me armë - një risi thelbësore për hartimin e politikave efektive të bazuara në prova.

Raporti është i strukturuar në shtatë pjesë. Ai fillon me një përmbledhje të metodologjisë së përdorur për vlerësimin e kërkesës për armë zjarri. Pjesa e dytë paraqet një kuadër teorik novator për konceptualizimin e çështjes. Seksioni i tretë eksploron literaturën e shkencave sociale mbi faktorët e rrezikut dhe të mbrojtjes lidhur me armët e zjarrit, përfshirë edhe në Ballkanin Perëndimor. Seksioni i katërt përmbledh gjetjet nga anketimet e kryera në rajon. Seksioni i pestë analizon njohuritë e përftuara nga grupet e fokusit dhe konsultimet me ekspertë. Seksioni i gjashtë përmbledh një vlerësim të marrëdhënieve midis legjislacionit për kontrollin e armëve të zjarrit dhe kërkesës për to, të shprehura përmes viktimizimit, zotërimit të armëve të zjarrit dhe qëndrimeve ndaj këtyre të fundit. Seksioni i fundit përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për të forcuar strategjitë për uljen e kërkesës. Raporti synon të mbështesë një debat të ekuilibruar, të informuar dhe të orientuar drejt veprimit, një debat që merr seriozisht jo vetëm mënyrën se si furnizohen, trafikohen dhe përdoren armët, por edhe arsyen që fshihet pas kërkesës për to.

# 1.

# ASPEKTET METODOLOGJIKE

Të kuptuarit e nuancave të kërkesës për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor kërkon një qasje me metoda të ndërthurura. Kërkesa për armë nuk është thjesht një fenomen ekonomik apo i nxitur nga tregu; ajo i ka rrënjët në sistemet sociale, kulturore, psikologjike, gjinore dhe politike. Për rrjedhojë, hulumtimi ku mbështetet ky studim bazohet në metoda sasiore dhe cilësore, duke përfshirë anketime juridiksionale të shtresëzuara, grupe fokusi, intervista me ekspertë, si dhe analiza ligjore dhe politike. Pluralizmi metodologjik është thelbësor për testimin e hipotezave në lidhje me nxitësit e kërkesës për armë zjarri. Duke pasur parasysh kompleksitetin e temës, hulumtimi mbështetet në disiplina të ndryshme - antropologji, kriminologji, ekonomi, shkenca politike, psikologji dhe sociologji - të cilat ofrojnë mjete interpretuese për të zbuluar motivet e blerjes së armëve të zjarrit. Në të njëjtën kohë, studiuesit janë të vetëdijshëm për kufijtë e deduksionit: perceptimet, preferencat dhe sjelljet janë dinamike dhe mund të ndryshojnë shpejt. Në fakt, lidhjet shkakësore midis rregullimit dhe kërkesës janë rrallëherë lineare ose të qarta.

Raporti fillon me një shqyrtim të literaturës mbi kërkesën për armë zjarri. Shqyrtimi është thelbësor për të analizuar gjendjen e kërkimit, duke përfshirë studimet teorike dhe ato empirike. Shqyrtimi sistematik nxori në dritë 179 studime të vlerësuara nga palët homologe dhe studime të politikave midis viteve 1998 dhe 2023, që përfshijnë fusha nga shkencat politike dhe kriminologjia e deri te studimet gjinore dhe psikologjia e sjelljes (SEESAC, 2023a). Prej këtyre, 73 fokusoheshin specifikisht te Ballkani Perëndimor. Ajo çfarë bie në sy është se gati dy të tretat e të gjithë artikujve dhe studimeve ishin botuar para vitit 2018. Thënë ndryshe, njohuritë mbi këtë fushë janë të kufizuara dhe të vjetruara. Ndërkohë, një aspekt akoma më domethënës është objekti i punës. Kërkesa për armë zjarri trajtohej si temë qendrore në më pak se një të katërtën e studimeve të fokusuara te Ballkani. Shumica e autorëve e kishin trajtuar atë vetëm kalimthi, si pjesë e një trajtimi më të gjerë të dhunës me armë, trafikimit ose rregullimit të armëve. Analiza e drejtpërdrejtë dhe e mbështetur në të dhëna e faktorëve që diktojnë kërkesën mbetet e kufizuar, duke lënë mjaft vend për kërkime të ardhshme.

Një shtyllë thelbësore e studimit është një anketim gjithëpërfshirës i porositur nga SEESAC dhe i administruar nga IPSOS, me mbi 6200 të anketuar në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi (IPSOS, 2025a). Në çdo juridiksion u zgjodhën mbi 1000 të anketuar duke përdorur metodën e shtresëzimit për të siguruar përfaqësimin demografik, gjeografik dhe socio-ekonomik.[2] Anketimi përfshiu intervistimin e personave të moshës 18 vjeç e lart dhe testoi një sërë hipotezash të lidhura me kërkesën, duke analizuar perceptimet lidhur me sigurinë dhe krimin, qëndrimet ndaj gjinisë dhe zotërimit të armëve, ndikimin e traditës dhe normave kulturore, ekspozimin ndaj tregjeve të paligjshme dhe ndërgjegjësimin për ligjet dhe dënimet përkatëse. Gjetjet

**2** Anketimi përdori një kampion rastësor përfaqësues të shtresëzuar me tre faza. Ajo zbatoi një qasje të thjeshtë kampionimi rastësor pa zëvendësim (SRSWoR). Intervistat u zhvilluan ballë për ballë. Testet "chi-katror" të Pearson-it u përdorën për të testuar dallimet midis të dhënave kategorike dhe për të vlerësuar dallimet statistikore midis shpeshtësive të pritshme dhe shpeshtësive të vrojtuara në një ose disa kategori të një tabele ndërvarësie. Po kështu, u përdorën testet F për të testuar dallimet midis vlerave mesatare, si dhe testi HSD i Tukey (Tukey's Honestly-Significant Difference) për të përcaktuar dallimet midis ndryshoreve të pavarura. Po aty.

tregojnë jo vetëm se kush dëshiron të mbajë armë zjarri, por edhe pse, në çfarë kushtesh dhe se si ndryshojnë qëndrimet dhe kërkesa sipas grupmoshave, gjinive dhe konteksteve socio-ekonomike dhe juridiksionale.

Për të plotësuar anketimet, studimi përfshiu një shtresë të pasur kërkimi cilësor. U kryen 40 intervista të thelluara me informatorë kyç, duke përfshirë pikat e kontaktit për armët e zjarrit në ministritë përkatëse, agjencitë ligjzbatuese dhe regjistrat qendrorë të armëve, prokurorë, gazetarë, shitës legjitimë të armëve dhe përfaqësues të shoqatave të qitjes sportive. Zërat e tyre i dhanë studimit një kontekst institucional, sociologjik dhe historik, si dhe perspektiva të vijës së parë lidhur me sfidat e zbatimit dhe tendencat shoqërore. Përveç kësaj, u mblodhën 18 grupe fokusi (nga 3 për çdo juridiksion) me pronarë aktualë dhe të ardhshëm të armëve, punonjës socialë dhe psikologë që punojnë me të rinjtë, si dhe ekspertë ligjorë me përvojë në lidhje me ligjet për kontrollin e armëve të zjarrit.[3] Këto diskutime hodhën më shumë dritë mbi kuptimet simbolike, emocionale dhe sociale që lidhen me armët e zjarrit. Metodologjia përfshiu gjithashtu 6 dialogë me "grupe krize",[4] nga një për çdo juridiksion, me panele të vogla qytetarësh. Pjesëtarëve në panel iu kërkua të diskutonin në lidhje me një pyetje të vetme: "a duhet të kenë civilët akses më të lehtë në blerjen dhe mbajtjen e armëve të zjarrit?" Këto seanca nxorën në pah një dyzim të theksuar, duke hedhur dritë, ndër të tjera, mbi tensionet midis pasigurisë së perceptuar dhe besimit tek institucionet.

Një tjetër shtyllë metodologjike e anketimit përfshiu një shqyrtim përshkrues të marrëdhënies midis ligjeve të lidhura me armët e zjarrit dhe tendencave të blerjes dhe keqpërdorimit të armëve në Ballkanin Perëndimor (SEESAC, 2023b). Vlerësimi lançoi një rishikim të 31 ligjeve dhe rregulloreve të lidhura me armët e zjarrit, të miratuara ose të ndryshuara që nga viti 2012 në të gjashta juridiksionet, duke identifikuar të përbashkëtat dhe dallimet në kërkesat e licencimit, kufijtë e pronësisë dhe dënimet për keqpërdorimin. Ky hartëzim ligjor u shoqërua me një shqyrtim krahasimor të Direktivave të BE-së për armët e zjarrit dhe ligjeve të tyre transpozuese. Për të shqyrtuar efektet e legjislacionit në praktikë, studimi krahasoi afatet rregullatore me tendencat e vrasjeve, sulmeve dhe vetëvrasjeve të lidhura me armët e zjarrit. Ky komponent u mbështet kryesisht në të dhëna të pjesshme dhe jo të njëtrajtshme me burim të hapur, duke përfshirë panelet e të dhënave të SEESAC dhe anketimet e kryera midis 2017 dhe 2024, si dhe të dhëna të jashtme nga raportet e shoqërisë civile, monitorimet e medias dhe institucionet ndërkombëtare.[5]

**3** Grupet e fokusit përfshinë 5 pjesëmarrës të gjinive dhe prejardhjeve të ndryshme. Po aty.

**4** Grupet e krizave përdoren për të përftuar njohuri më të thelluara lidhur me sjelljet dhe qëndrimet kundërshtuese lidhur me një çështje sociale specifikisht të përcaktuar. Diskutimi fokusohet te një pyetje e vetme po/jo. Pjesëmarrësit ndahen zakonisht në dy grupe (pro dhe kundër) dhe secili sjell argumente në lidhje me pyetjen kryesore. Në diskutimin përmbyllës, bëhet një shqyrtim i të gjitha argumenteve për të identifikuar ato që janë të pranueshme, të papranueshme ose asnjanëse për të dyja grupet. Kjo metodë siguron një kuptim më të thelluar të mesazheve të mundshme kyç për fushatat ndërgjegjësuese ose për formulimin e rekomandimeve politike.

**5** Të dhënat u morën nga një sërë burimesh, duke përfshirë https://www.rcc.int/balkanbarometer/publications dhe monitorimin e treguesve kyç të performancës nga SEESAC, si https://www.seesac.org/f/docs/

Një prej pikave të forta të këtij studimi qëndron pikërisht në projektimin e tij metodologjik. Ai jo vetëm që zbulon dinamikën historike dhe aktuale të kërkesës për armë zjarri, por edhe ofron një instrument të riprodhueshëm për diagnostikimin, monitorimin dhe vlerësimin e ardhshëm në Ballkanin Perëndimor. Në fakt, nuk ekziston asnjë vlerësim tjetër i ngjashëm i publikuar në rajon apo gjetkë. Duhet theksuar se vlerësimi i kërkesës për armë dhe masave për reduktimin e saj nuk mund t'u nënshtrohet lehtësisht metodave eksperimentale si provat me përzgjedhje të rastësishme, për shkak të natyrës së ndërlikuar, të varur nga konteksti dhe thellësisht subjektive të këtij fenomeni. Megjithatë, integrimi i anketimeve, kërkimeve cilësore, analizave ligjore dhe mjeteve statistikore ofron një alternativë pragmatike. Këto metoda lejojnë ndërthurjen (triangulimin) midis perceptimit dhe sjelljes, rregullimit dhe zbatimit dhe kërkesës dhe masave frenuese. Ndonëse qëndrimet individuale diktohen nga faktorë të paqëndrueshëm dhe shpeshherë të pamaterializuar, kjo qasje bën një vrojtim dhe kontekstualizim sistematik të tyre, duke prodhuar njohuri të besueshme dhe të zbatueshme në praktikë.

Instrumentet e zhvilluara për studimin e SEESAC - anketimet e shtresëzuara në nivel juridiksioni, formatet e grupeve të fokusit, modelet e intervistave me informatorë kyç dhe metodat për shqyrtimin e lidhjes midis ligjeve dhe kërkesës për armë zjarri - mund të përshtaten dhe të riaplikohen me kalimin e kohës për të vlerësuar kushtet në ndryshim dhe ndikimet e strategjive për reduktimin e kërkesës në mbarë Ballkanin Perëndimor. Së bashku, ato hedhin baza të forta për autoritetet publike, organizatat joqeveritare dhe partnerët ndërkombëtarë në rajon për gjurmimin e qëndrimeve dhe perceptimeve në ndryshim të vazhdueshëm, për vlerësimin e ndërhyrjeve për reduktimin e kërkesës dhe për informimin e politikave dhe programeve të bazuara në prova. Duke ndërthurur një metodologji të konsoliduar me perspektivat e qytetarëve, metodologjia ofron një kuadër si fleksibël, ashtu edhe solid, për të kuptuar, vlerësuar dhe më pas reduktuar kërkesën e civilëve për armë zjarri të paligjshme në rajon.

ninth-regional-coordination-meeting/9th-Regional-KPIs-Report.pdf. Burimet janë të shtjelluara te SEESAC 2023b.

# 2.

# TEORIZIMI I KËRKESËS PËR ARMË ZJARRI

Në thelb, kërkesa për armë zjarri nuk është një fenomen abstrakt dhe i pakuptueshëm, por produkt i tre kushteve ndërvepruese: preferencës, çmimit dhe burimeve (shihni Figurën 1). Këto kushte formojnë një model teorik bazë të kërkesës, që vlen si për tregun e ligjshëm të armëve, ashtu edhe për tregun e paligjshëm (Brauer and Muggah, 2007). Së pari, individët duhet të shfaqin një preferencë apo motivim për blerjen e një arme zjarri. Kjo mund të nxitet nga kërcënimet e perceptuara ndaj vetë individit apo familjes së tij, përkatësia kulturore ose lidhjet simbolike dhe psikologjike me armët. Së dyti, çmimi i armëve të zjarrit - i shprehur qoftë në terma monetarë apo në formën e penaliteteve ligjore dhe shoqërore - duhet të jetë mjaftueshëm i ulët për të bërë të mundur blerjen. Së treti, individët duhet të kenë burime të mjaftueshme, duke përfshirë të ardhurat e disponueshme, njohuritë teknike ose aksesin në rrjetet sociale, për ta përkthyer preferencën në blerje dhe zotërim. Dobësimi i cilitdo prej këtyre tre elementeve mund të ndikojë te kërkesa: nëse preferencat ndryshojnë për shkak të ndryshimit të normave, nëse çmimi i armëve rritet së tepërmi apo nëse burimet mungojnë, atëherë do të kemi një ulje ose riorientim të kërkesës.

*Figura 1.*
**Teorizimi i kërkesës për armë zjarri**

| | |
|---|---|
| ***Preferencat*** | Një motivim individual që nxit dëshirën për të zotëruar armë zjarri dhe që mund të variojë nga dëshira për vetëmbrojtje dhe qëllimet rekreative e deri tek identiteti kulturor apo statusi social. |
| ***Çmimet*** | Kostot monetare dhe sociale të blerjes dhe mbajtjes së një arme zjarri dhe rreziqet e perceptuara apo pasojat ligjore të lidhura me zotërimin. |
| ***Burimet*** | Kapaciteti i një individi apo i një familjeje për të vepruar mbi bazën e preferencave, duke përshirë të ardhurat, aksesin në tregjet e armëve të zjarrit (të ligjshme apo të paligjshme) dhe njohuritë lidhur me procesin e licencimit. |

Pika e fortë e këtij kuadri teorik qëndron jo vetëm te natyra e tij abstrakte, por edhe tek operacionalizimi i tij përmes testimit të hipotezave me prova empirike. Për të deshifruar sesi këto tre leva operojnë në praktikë, është e rëndësishme të analizohen faktorët e rrezikut - në lidhje me gjininë, zotërimin e armëve në të kaluarën, precedentët penalë, historikun e viktimizimit, lidhjet me sektorin e sigurisë, anëtarësimin në një grup kriminal ose mosbesimin te sistemi i drejtësisë - që intensifikojnë gjasat e preferencave të forta dhe mobilizimit të burimeve për blerjen e armëve të zjarrit (shihni Shtojcën 1). Nga ana tjetër, faktorët mbrojtës - si mungesa e ekspozimit ndaj dhunës, mungesa e tërheqjes ndaj armëve apo perceptimet pozitive lidhur me organet ligjzbatuese - i zbusin këto prirje. Një qasje më e larmishme e paraqet kërkesën jo si një aspekt binar (po/jo), por si një spektër të formuar nga ndërthurja e përvojave jetësore, gjendjeve psikologjike dhe mjediseve sociale, kulturore dhe ekonomike. Anketimet, grupet e fokusit dhe intervistat e

ekspertëve - të gjitha prej të cilave janë përdorur në këtë studim - zbulojnë se faktorët në nivel individual nuk veprojnë në mënyrë të izoluar, por diktohen dhe ndikohen vazhdimisht nga kontekste më të gjera si familja, komuniteti dhe shoqëria (shihni Figurën 2, Shtojca 2).

*Figura 2.*
**Konceptualizimi i faktorëve të rrezikut dhe faktorëve mbrojtës**

| | ***Faktorët e përzgjedhur të rrezikut*** | ***Faktorët e përzgjedhur mbrojtës*** |
|---|---|---|
| **Niveli individual:** Karakteristikat, përvojat dhe qëndrimet personale që ndikojnë drejtpërdrejt te prirja e një personi për të blerë apo për të shmangur armët e zjarrit | Perceptimet e pasigurisë personale ose frika nga viktimizimi;<br>Nocionet e maskilizmit të lidhura me statusin ose mbrojtjen;<br>Qëllimet kriminale ose historiku i sjelljeve të dhunshme;<br>Përvojat e viktimizimit | Bindja personale se armët e zjarrit ulin sigurinë;<br>Ndikimi pozitiv i bashkëmoshatarëve dhe i modeleve jo të dhunshme të sjelljes;<br>Nivelet e larta të arsimit apo të ndërgjegjësimit lidhur me armët e zjarrit |
| **Niveli familjar:** Dinamikat, praktikat dhe marrëdhëniet brenda familjes që mund të nxisin apo të shkurajojnë blerjen e armëve të zjarrit | Prania e armëve të zjarrit në banesë (veçanërisht kur ato ruhen në kushte të pasigurta);<br>Modelet e dhunës në familje apo të abuzimit me substancat;<br>Nxitja për përdorimin e armëve të zjarrit përmes traditës familjare | Mosmiratimi i vetë personit, i partnerit ose i prindërve për zotërimin e armëve të zjarrit;<br>Protokollet e sigurisë dhe të ruajtjes së sigurt të armëve;<br>Mjediset familjare përkrahëse dhe jo të dhunshme; |
| **Niveli komunitar:** Mjedisi rrethues social dhe fizik, duke përfshirë sigurinë e lagjes, rrjetet e bashkëmoshatarëve dhe aksesin në armët e zjarrit | Nivelet e larta të krimit në lagje ose paligjshmëria e perceptuar;<br>Afërsia me tregjet e paligjshme të armëve apo me dyqanet e armëve;<br>Kohezioni i dobët komunitar ose mungesa e besimit social;<br>Besimi i ulët tek institucionet | Normat e forta të komunitetit kundër zotërimit të armëve;<br>Prania efektive e policisë lokale dhe masat e dukshme të sigurisë publike;<br>Fushata edukimi ose çarmatimi të bazuara në komunitet |
| **Niveli shoqëror:** Strukturat politike, ligjore, kulturore dhe ekonomike që formësojnë kontekstin në të cilin individët dhe komunitetet marrin vendime në lidhje me armët e zjarrit. | Rregullimi ose zbatimi i dobët në lidhje me armët e zjarrit;<br>Normat kulturore që i idealizojnë armët ose i asociojnë ato me identitete specifike;<br>Paqëndrueshmëria politike ose pasiguria pas konflikteve | Ligjet gjithëpërfshirëse për kontrollin e armëve dhe mekanizmat e zbatimit;<br>Besimi i gjerë i publikut tek institucionet dhe sistemet e drejtësisë;<br>Ndryshimi i normave sociale që e lidhin sigurinë me çarmatimin |

Për të kuptuar dhe më pas reduktuar kërkesën për armë zjarri, politikëbërësit duhet të lëvizin lirisht midis niveleve individuale dhe atyre shoqërore. Një mënyrë për ta bërë këtë është në sajë të aplikimit të një "modeli social ekologjik" që bën dallimin midis niveleve të ndërlidhura të ndikimit (shihni Figurën 2).[6] Në nivelin individual, historitë personale dhe orientimet psikologjike mund të ndihmojnë në shpjegimin e motiveve dhe të aksesit. Megjithatë, këto përvoja janë të rrënjosura në dinamikat familjare, ku tendencat e dhunës ose shoqërimi me aktorë kriminalë mund të nxisin ose zbusin kërkesën. Në një këndvështrim edhe më të gjerë, karakteristikat komunitare të tilla si niveli i krimit në lagje, numri i dyqaneve të armëve dhe nivelet mbizotëruese të kohezionit social dhe efikasitetit përcaktojnë kontekstin në të cilin merren vendimet personale. Në nivelin shoqëror, motivet diktohen nga regjimet ligjore, cilësia dhe mbulimi i zbatimit të ligjit dhe normat kulturore që kanë të bëjnë me gjininë. Në fakt, faktorët e tillë si dobësia e shtetit të së drejtës, moszbatimi i rregulloreve ekzistuese ose ideologjitë tejet maskiliste mund të krijojnë mjedise mundësuese që normalizojnë posedimin dhe përdorimin e armëve. Nga ana tjetër, institucionet e forta, rregullat e qarta dhe të zbatueshme dhe normat shoqërore që dënojnë armëmbajtjen dhe dhunën me armë si mjet për zgjidhjen e konflikteve shërbejnë gjithashtu si pengesa strukturore. Këto nivele ndërveprojnë në mënyrë të përsëritur: për shembull, besimi tek institucionet ose mungesa e tij ndikon te qëndrimet individuale, ndërsa përvojat personale mund të përshkallëzojnë në pakënaqësi kolektive dhe tendenca socio-kulturore më të gjera.

**6** Modeli social ekologjik është një kuadër që përdoret në shëndetin publik për të kuptuar sesi sjelljet individual dhe rezultatet shëndetësore diktohen nga disa nivele ndikimi, duke përfshirë faktorët individualë, ndërpersonalë, komunitarë dhe shoqërorë. Ai bazohet tek ideja se shëndeti nuk diktohet vetëm nga zgjedhjet personale, por ndikohet nga ndërveprimet komplekse midis njerëzve dhe mjediseve të tyre më të gjera.

# 3.

# SHQYRTIMI I LITERATURËS MBI KËRKESËN PËR ARMË ZJARRI

Për të vlerësuar bazat teorike dhe empirike të kërkesës për armë zjarri, është e rëndësishme të konsultohet literatura e shkencës sociale në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë (SEESAC, 2023a). Shqyrtimi identifikoi një numër të kufizuar, por në rritje, të studimeve në dispozicion të publikut mbi kërkesën për armë zjarri. Nga 179 studime akademike dhe të politikave të identifikuara, 73 fokusoheshin posaçërisht në këtë rajon ose në juridiksione të caktuara të rajonit.[7] Shqyrtimi identifikoi disa faktorë rreziku dhe faktorë mbrojtës që mendohet se ndikojnë në kërkesën për armë zjarri. Më konkretisht, faktorët e rrezikut përfshijnë perceptimet mbi mungesën e sigurisë, normat kulturore dhe sociale, si dhe nivelin e ulët të besimit tek institucionet, ndërsa faktorët mbrojtës janë aspektet strukturore të lidhura me qeverisjen, zhvillimi ekonomik dhe kontrolli i synuar i krimit (shihni figurën 3). Megjithatë, jo të gjithë këta faktorë rreziku u përcaktuan apo u testuan në mënyrë faktike ose empirike, përmes studimit të aplikuar.

*Figura 3.*
**Faktorët e përsëritur të rrezikut dhe mbrojtës të identifikuar në literaturë në Ballkanin Perëndimor**

| ***Niveli*** | ***Faktorët e rrezikut*** | ***Faktorët mbrojtës*** |
|---|---|---|
| ***Në nivel individual*** | Mashkull në moshë të re/të mesme;<br>Mungesa e perceptuar e sigurisë;<br>Përvoja me viktimizimin;<br>Precedentët penalë dhe/ose problemet me abuzimin me substancat;<br>Përfshirja aktive në grupe kriminale;<br>Sfidat psikologjike dhe të lidhura me sjelljen; | Gra të reja dhe të moshuara;<br>Siguria dhe mbrojtja e perceptuar;<br>Niveli më i lartë arsimor dhe/ose të ardhurat më të larta;<br>Ndërgjegjësimi mbi rreziqet dhe trajnimet për sigurinë |
| ***Në nivel familjeje*** | Prania e armëve të zjarrit në banesë;<br>Ekspozimi ndaj dhunës ndërpersonale dhe abuzimi me substancat;<br>Tradita e gjuetisë dhe/ose përdorimi për qëllime rekreative; | Mungesa e pranisë së armëve të zjarrit në banesë;<br>Ruajtja e sigurt e armëve të zjarrit në banesë;<br>Prindërimi pozitiv dhe mbështetja nga bashkëmoshatarët;<br>Mosdhënia e pëlqimit për përdorimin e armëve të zjarrit nga familja apo partneri/ja |

7 Shqyrtimi i literaturës përfshiu zhvillimin e një fjalori lidhur me frazën “kërkesa për armë zjarri”, duke kombinuar kërkimet e termave/frazave në shumë gjuhë dhe funksionet e avancuara të grumbullimit të të dhënave. Ndër termat kryesorë të kërkuar bënin pjesë “armët e zjarrit”, “pushkët”, “armët e dorës”, “revolverët”, “pistoletat”, “armët”, “armët e vogla” dhe “municionet”. Më pas, kërkimet u kombinuan me variabla të tjerë si “kërkesa”, “tregjet”, “arsyet”, “preferencat”, “çmimet”, “kultura”, “normat” etj. Kërkimet e frazave përfshinin gjashtë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, si dhe emrat e kryeqyteteve. Pyetjet u administruan në të gjitha gjuhët përkatëse.

| Niveli | Faktorët e rrezikut | Faktorët mbrojtës |
|---|---|---|
| **Në nivel komuniteti** | Normat sociale që normalizojnë keqpërdorimin e armëve të zjarrit;<br>Dhuna në komunitet dhe pakënaqësitë historike;<br>Efikasiteti dhe kohezioni social i dobët; | Normat sociale që nuk pranojnë dhe/ ose sanksionojnë përdorimin e armëve të zjarrit;<br>Mjedisi i qëndrueshëm në lagje, si dhe niveli i frekuentimit të shkollës dhe arritjeve arsimore;<br>Të dhënat e kufizuara ose inekzistente për incidentet me armë zjarri;<br>Efikasiteti dhe kohezioni social i shëndoshë |
| **Në nivel shoqërie** | Nocionet e burrërisë dhe nderit;<br>Nivelet e larta të pabarazisë;<br>Besimi i ulët i publikut tek institucionet e sigurisë;<br>Mungesa e qëndrueshmërisë në periudhat pas konflikteve;<br>Prania e krimit të organizuar;<br>Faktorët nxitës online dhe teknologjikë; | Normat që favorizojnë barazinë gjinore;<br>Nivelet e ulëta të pabarazisë;<br>Besimi i publikut tek institucionet e sigurisë publike;<br>Perceptimi për rregullore efektive për armët e zjarrit dhe për zbatimin efektiv të tyre;<br>Mbështetja për angazhimet rajonale dhe kombëtare për të përmirësuar sigurinë publike dhe për të ulur numrin e armëve të zjarrit të paligjshme[8] |

**Faktorët e përzgjedhur të rrezikut dhe ato mbrojtës, të identifikuar nga shqyrtimi i literaturës. Nuk i janë nënshtruar testimit apo analizës empirike.*

Gjatë dy dekadave të fundit, SEESAC dhe partnerët e saj kanë zhvilluar një pjesë të konsiderueshme të studimeve dhe të dhënave nga anketimet, të cilat janë në dispozicion të publikut, lidhur me ofertën dhe kërkesën për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, tërësia e literaturës mbetet e kufizuar dhe disi e vjetruar, kështu që duhet bërë kujdes gjatë interpretimit të gjetjeve, veçanërisht lidhur me përgjithësimin e faktorëve të identifikuar të rrezikut dhe mbrojtës (shihni figurën 3x). Studimet mbi faktorët që nxisin kërkesën për armë zjarri janë më të avancuara në rajone si Amerika e Veriut, Evropa Perëndimore dhe Australia, krahasuar me Evropën Juglindore. Edhe pse studimet ekzistuese ofrojnë njohuri të dobishme mbi faktorët e ndryshëm të rrezikut dhe ato mbrojtës që ndikojnë në kërkesën për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor, ekziston një mungesë e dukshme e studimeve mbi preferencat, çmimet dhe burimet që ndikojnë tek arsyet individuale dhe kolektive.

## Faktorët e përzgjedhur të rrezikut

Ekzistojnë disa faktorë të përsëritur rreziku që lidhen me blerjen dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor. Faktorët e përmendur më shpesh që nxisin

8 Për shembull, Udhërrëfyesi për kontrollin e AVL-ve në Ballkanin Perëndimor.

kërkesën për armë zjarri përfshijnë normat e rrënjosura gjinore, perceptimet mbi mungesën e sigurisë, identitetet kulturore dhe tradicionale, qëllimet rekreative (gjuetia, qitja, koleksioni), besimi i ulët tek institucionet, synimet për të lënduar veten apo të tjerët dhe ambicia për veprimtari kriminale. Shqyrtimi i literaturës nxori në pah një sërë referencash lidhur me këta faktorë, por lista e identifikuar nuk është aspak shteruese. Pjesa më e madhe e faktorëve të përzgjedhur të rrezikut bazohen në studimet cilësore nga ekspertët e shkencave sociale që në fillim të viteve 2000.

Aspektet demografike, në veçanti gjinia, mendohet se ndikojnë fuqimisht te zotërimi dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit. Një arsye kryesore për këtë fakt është se burrat përbëjnë shumicën dërrmuese të zotëruesve (SEESAC,2007), viktimave (SEESAC, 2016a) dhe autorëve, ndërsa gratë kanë më pak gjasa të përdorin armë dhe më shumë gjasa që të shprehen se ndihen të pasigurta pranë armëve (SEESAC, 2019n). Blerja dhe zotërimi i armëve të zjarrit nga personat e moshuar është gjithashtu në nivele të ulëta, edhe pse vetëvrasjet trajtohen shpeshherë si arsye për mbajtjen e armëve të zjarrit në shtëpi (SEESAC, 2016b). Sigurisht që dinamikat gjinore dhe kërkesa për armë zjarri mund të variojnë nga një vend në tjetrin: në Bosnjë-Hercegovinë, një numër i konsiderueshëm grash u shprehën se arsyeja e tyre kryesore për të zotëruar një armë ishte mendimi se “një grua duhet të mbajë armë”, një pikëpamje kjo që ndahej nga një pjesë më e vogël e burrave që mendonin se “burrat duhet të mbajnë armë zjarri” (SEESAC, 2019c).

Gjithashtu, mosha dhe formimi arsimor duket se luajnë rol në formësimin e qëndrimeve ndaj zotërimit dhe përdorimit të armëve të zjarrit. Studiuesit kanë zbuluar se meshkujt e rinj në moshë në Ballkanin Perëndimor kanë shumë më tepër gjasa që të shprehin interes për marrjen e një arme zjarri, si dhe janë të përfshirë më shpesh në keqpërdorimin e tyre (SEESAC, 2019m). Nga ana tjetër, meshkujt më të vjetër në moshë përfaqësohen në mënyrë joproporcionale në vetëvrasjet me armë zjarri. Arsimi duket se ndikon te perspektiva mbi armët e zjarrit dhe aksesi në to. Për shembull, në Mal të Zi, nivelet më të ulëta të arritjeve arsimore duket se përkojnë me qëndrimet më pranuese ndaj armëve, ndërsa në Shqipëri, meshkujt e rinj në moshë me nivel arsimor mesatar kanë shfaqur mbështetje veçanërisht të fortë për zotërimin e armëve.

Disa faktorë rreziku individualë për zotërimin dhe keqpërdorimin e armëve në Ballkanin Perëndimor pasqyrojnë tendencat globale, me elemente specifike rajonale. Më konkretisht, meshkujt më të rinj në moshë me histori personale të krimit, abuzimit me substancat dhe ekspozimit ndaj kufizimeve ekonomike, kanë më shumë gjasa që të kërkojnë armë zjarri (Rowhani-Rahbar et al., 2023). Ndërkohë, personat që bëjnë qitje për qëllime rekreative dhe gjuetarët, të cilët zakonisht janë meshkuj të moshës së mesme, formojnë një tjetër grup të konsiderueshëm që shpreh një preferencë për armët e zjarrit. Për më tepër, tregtarët e armëve, të cilët shesin ligjërisht (në mënyrë të paqëllimtë) armë dore që përdoren më pas për kryerjen e krimeve përshkruhen si rrezik për nxitjen e kërkesës për armë zjarri (Wintemute et al., 2005). Këto modele sugjerojnë se normalizimi social dhe cenueshmëria mund të luajnë role të ndërthurura në formësimin e kërkesës për armë zjarri të ligjshme dhe të paligjshme.

Një nga faktorët e rrezikut të cituar më shpesh që nxit blerjen e armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor është perceptimi mbi mungesën e sigurisë (SEESAC, 2004b). Në

disa juridiksione, ekspertët e shkencave sociale e përshkruajnë frikën (Grillot, 2004) si një faktor kyç që shfaqet në formën e cenueshmërisë së perceptuar nga sulmet në banesë (Mugumya, 2004), ndjesisë së kërcënimeve personale (SEESAC, 2019m), ose dëshirës për një nivel më të lartë mbrojtjeje dhe sigurie (SEESAC, 2003). Në fakt, anketimi i SEESAC dhe anketime të tjera kanë identifikuar në mënyrë të vazhdueshme se të anketuarit kërkojnë që të marrin armë zjarri kryesisht për të mbrojtur banesën e tyre (SEESAC, 2015), pronën private (Ćopić and Dokmanović, 2022), sendet familjare (SEESAC, 2016b), asetet e biznesit (SEESAC, 2006d) dhe anëtarët e familjes (Centre for Peace and Disarmament Education and Saferworld, 2005). Mbrojtja personale dhe e familjes janë arsyet më të zakonshme, por ndërkohë janë përmendur rregullisht edhe arsye më të gjera për blerjen e një arme zjarri si mbrojtja e komunitetit (SEESAC, 2004b) ose dhënia e kontributit në sigurinë kolektive (SEESAC, 2004a).

Janë propozuar disa shpjegime për lidhjen e mundshme ndërmjet mungesës së perceptuar të sigurisë dhe zotërimit të armëve të zjarrit. Shpjegimi më i spikatur është trashëgimia e vazhdueshme e luftës. Konfliktet e zgjatura dhe paqëndrueshmëria politike, veçanërisht gjatë viteve 90', kanë ndikuar në perceptimin e publikut dhe kanë krijuar një ankth të vazhdueshëm për dështime të ardhshme të ligjit dhe rendit (Carapic, 2014). Këto shqetësime nuk janë abstrakte. Për shumë persona, ato janë të rrënjosura në kujtesën personale apo familjare të lidhur me krizat, zhvendosjet dhe rënien e institucioneve (Prezelj, 2010). Parë nga ky këndvështrim, marrja e një arme zjarri nuk është thjesht një masë mbrojtëse, por një mjet për vetëmbrojtje ndaj cenueshmërive sistemike (Tholens, 2017). Për rrjedhojë, paqëndrueshmëria politike dhe traumat historike të patrajtuara shfaqen si faktorë të mundshëm rreziku në ruajtjen e kërkesës për armë zjarri (Arsovska and Zabyelina, 2014).

Literatura nga Ballkani Perëndimor dhe rajone të tjera e lidh vazhdimisht marrjen e armëve të zjarrit me përvojat e drejtpërdrejta apo të tërthorta të viktimizimit. Individët që kanë qenë objekt viktimizimi dhe që jetojnë me frikën e përsëritjes së incidenteve kanë më shumë gjasa që të kërkojnë armë zjarri si mjete parandaluese dhe të sigurisë psikologjike. Logjika është e thjeshtë për t'u kuptuar: armët e zjarrit besohet se japin një nivel të caktuar kontrolli dhe reduktojnë cenueshmërinë. Kjo dinamikë nuk njeh kufij, duke nënvizuar se marrëdhënia midis pasigurisë, traumës dhe zotërimit të armëve, është shpeshherë e rrënjosur në sjelljen njerëzore, në kontekste të ndryshme kulturore (Moshary, Shapiro, and Drango, 2022). Parë nga ky këndvështrim, armët e zjarrit nuk janë thjesht mjete të mundshme për t'u mbrojtur, por shërbejnë si "mburojë" simbolike ndaj sulmeve të ardhshme të perceptuara (Pierre, 2019).

Gjatë dy dekadave të fundit, kërkesa për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor është nxitur gjithashtu nga veprimtaritë rekreative dhe faktorët kulturorë, ku përfshihen gjuetia, qitja sportive dhe koleksionimi. Edhe pse preferencat variojnë në juridiksione të ndryshme, si p.sh. më tepër fokus te qitja sportive në Serbi dhe te koleksionimi në Bosnjë-Hercegovinë (Hadzovic, 2003), gjuetia mbetet arsyeja e cituar më shpesh për zotërimin e ligjshëm të armëve të zjarrit (Ćopić and Dokmanović, 2022). Kjo arsye është veçanërisht e pranishme në zonat rurale, ku gjuetia jo vetëm që është një burim i sigurimit të jetesës, por gjithashtu një praktikë kulturore dhe traditë ndër breza (Grillot, 2004). Megjithatë,

edhe këto forma të zotërimit të armëve për qëllime rekreative përmbajnë rrezik. Studimet nga Serbia nënvizojnë se armët e zjarrit të përdorura për vrasjen e grave, shpesh janë përftuar në mënyrë të ligjshme për gjueti, çka tregon se si zotërimi për qëllime rekreative mund të ndërthuret me fenomenin e dhunës nga partneri intim.[9]

Një tjetër faktor i konsiderueshëm nxitës i kërkesës për armë zjarri lidhet me kuadrin kulturor të burrërisë. Disa studime e lidhin pronësinë e armëve dhe keqpërdorimin e tyre me identitetin gjinor, duke argumentuar se armët e zjarrit shërbejnë si simbole të fuqishme të burrërisë dhe statusit (UNDP, 2021a). Sociologët dhe specialistët për çështjet gjinore nënvizojnë faktin se shpeshherë armët interpretohen si simbole të pjekurisë, forcës dhe autoritetit dhe madje në disa raste, janë pjesë e riteve të kalimit në moshë e pjekurisë.[10] Këto norma janë veçanërisht të theksuara në Ballkanin Perëndimor, ku armët e zjarrit konsiderohen si pjesë thelbësore e nocioneve të nderit të meshkujve dhe detyrës së meshkujve për të mbrojtur familjen dhe komunitetin (Pavlov, 2023). Normat sociale tradicionale gjinore përforcojnë nocionin se nga burrat pritet të garantojnë mbrojtje dhe të ardhura, role këto që mund të përfshijnë praninë e armëve të zjarrit në shtëpi (Spasić, 2017).

Pushteti dhe statusi përmes zotërimit të armëve të zjarrit janë gjithashtu të lidhur ngushtësisht me identitetin gjinor. Për disa individë në Ballkanin Perëndimor, zotërimi i një arme krijon ndjesinë e kontrollit apo të ndikimit, veçanërisht në ambiente të karakterizuara nga pasiguria personale dhe mungesa e qëndrueshmërisë sociale (SEESAC, 2016a). Historikisht, armët u kanë dhënë një lloj “force” grupeve të margjinalizuara ose të privuara nga e drejta e votës (Schwandner-Sievers and Cattaneo, 2005). Në disa raste, armët e zjarrit përdoren për të ushtruar autoritetin mbi persona të tjerë, duke përfshirë përmes akteve të kanosjes me bazë gjinore, ose dhunës ndërmjet grupeve të ndryshme në komunitet (UNDP, 2021b). Përdorimi i qëllimshëm i armëve për të ngjallur frikë, qoftë te rivalët politikë apo partnerët në familje, është një arsye e dokumentuar gjerësisht në mbarë rajonin.

Kjo pikë e përbashkët ndërmjet burrërisë, identitetit dhe simbolizmit ka ngjallur debate të vazhdueshme ndërmjet studiuesve rajonalë lidhur me ekzistencën e një “kulture të veçantë të armëve” në Ballkanin Perëndimor. Disa studiues argumentojnë se armët e zjarrit kanë veshur një kuptim të thellë simbolik, duke pasqyruar vlerat e rezistencës, pavarësisë dhe krenarisë mashkullore (Davis, 2002). Të tjerë shprehen se edhe pse këto aspekte janë të rëndësishme, ato mund të mos shpjegojnë plotësisht modelet e aksesit apo të keqpërdorimit (Scrivani, 2018). Megjithatë, ekziston një konsensus lidhur me faktin se armët lartësohen gjerësisht në shoqëri, qoftë në lidhje me lirinë personale, identitetin politik apo nocionet e burrërisë (Schwandner-Sievers and Cattaneo, 2005).

**9** Një studim konstatoi se një në katër autorë të vrasjeve të grave e kishte marrë armën e zjarrit duke cituar si arsye veprimtaritë rekreative (p.sh. gjuetia). Shihni UNDP. 2020.

**10** Një studim i kryer në Serbi nënvizoi modelet kulturore të zotërimit të armëve të zjarrit si një komponent thelbësor i “imazhit” të meshkujve në shoqëri: meshkujt janë mbrojtës dhe luftëtarë, dhe armët e zjarrit shërbejnë si një simbol i qartë e burrërisë në këtë kontekst kulturor. Shihni UNDP. 2021.

Në fakt, "vlerat tradicionale" veçohen shpeshherë nga studiuesit si faktorë që kontribuojnë në pronësinë e armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor (SEESAC, 2004b). Burrat, në veçanti, ka gjasa të përdorin "traditën" si arsye kryesore për të kërkuar apo zotëruar armë (UNDP, 2022). Për shembull, në Shqipëri pronësia e armëve shihet shpesh si e rrënjosur thellësisht në zakonet dhe ceremonitë kulturore, edhe pse zotërimi i ligjshëm privat i armëve filloi të lejohet pas vitit 2014.[11] Armët e zjarrit janë përdorur vazhdimisht në festime, të tilla si dasmat, çka pasqyron rolin e tyre simbolik në jetën në komunitet (Spasić, 2017). Edhe pse kjo logjikë kulturore nuk është e pranishme vetëm në Ballkanin Perëndimor, ajo luan një rol mjaft të dukshëm në qëndrimet rajonale. Tërheqja vizuale ndaj armëve dhe portretizimi i tyre në media dhe në kulturën popullore janë diskutuar më gjerësisht më poshtë dhe përforcojnë statusin e tyre si objekte të dëshiruara, duke ndikuar kështu në perceptimet lidhur me përdorimin dhe rëndësinë e tyre (Goldsmith, Halsey and Bright, 2020).

Duke pasur parasysh lidhjen me faktorët tradicionalë të përmendur më sipër, armët e zjarrit janë perceptuar historikisht si instrumente për zgjidhjen e armiqësive të vjetra (SEESAC, 2021). Ballkani Perëndimor ka një historik të gjatë dhe kompleks të konflikteve ndër breza, dhe armët e zjarrit janë rrënjosur thellë në këtë trashëgimi historike (SEESAC, 2005). Historikisht, armët janë mbajtur jo vetëm për mbrojtje ose qëllime rekreative, por edhe si instrumente hakmarrjeje dhe të ruajtjes së nderit të familjes apo fisit. Përdorimi i armëve ka kontribuuar në zvarritjen e mosmarrëveshjeve afatgjata, në përshkallëzimin e konflikteve dhe në shtimin e cikleve të dhunës. Në këtë mënyrë, armët e zjarrit kanë marrë një vlerë simbolike tejet "të fryrë", duke përfaqësuar prestigjin, pushtetin dhe gatishmërinë për të ruajtur nderin apo për të mbrojtur status quo-në në rastet e përballjes me fyerje apo padrejtësi (Arsovska, 2008).

Armët e zjarrit nuk mbahen dhe përdoren vetëm për të ushtruar dhunë ndaj personave të tjerë (dhunë ndërpersonale), por edhe në aktet e vetëlëndimit, ku kryesisht vlen të përmendet vetëvrasja. Burrat në moshë më të madhe preken në mënyrë joproporcionale. Më konkretisht, burrat në moshë të mesme (36–60 vjeç) dhe burrat e moshuar (mbi 61 vjeç) janë më të rrezikuarit nga vetëvrasjet me armë zjarri (SEESAC, 2019d). Këto modele demografike nënvizojnë ndërthurjen midis moshës, gjinisë dhe aksesit në mjete vdekjeprurëse. Gjithashtu, duket se ekziston një korrelacion mesatar ndërmjet nivelit të lartë të papunësisë dhe vetëvrasjeve me armë zjarri, pasi vështirësitë ekonomike mund të thellojnë dëshpërimin dhe izolimin social (Injac Stevović, et al., 2021). Aksesueshmëria e armëve të zjarrit në këto kontekste siguron atë që disa studiues e përkufizojnë me termin "një zgjidhje e shpejtë dhe e besueshme", një term ky i cili haset edhe në literaturën jashtë rajonit (Ludwig and Cook, 2003). Këto gjetje nënvizojnë nevojën për përgjigje me politika të integruara, të cilat kombinojnë rregulloret për armët e zjarrit me ndërhyrjet e posaçme për shëndetin mendor dhe strategjitë për parandalimin e vetëvrasjes të përshtatura për popullsitë e rrezikuara.

**11** Në fakt, armët e zjarrit nuk lejoheshin përpara vitit 2014 dhe gjatë periudhës së komunizmit. Shihni Arsovska, J. 2008. https://www.academia.edu/12994251/Illicit_arms_trafficking_and_the_limits_of_rational_choice_theory_the_case_of_the_Balkans

Një tjetër faktor i mundshëm strukturor që nxit kërkesën për armë zjarri në rajon është mungesa e besimit të publikut tek institucionet publike. Një sërë anketimesh dhe studimesh cilësore kanë shfaqur një lidhje ndërmjet besimit të ulët tek institucionet dhe dëshirës së lartë për të pasur armë personale (Grillot, 2004). Kur besimi tek agjencitë ligjzbatuese, sistemi gjyqësor dhe institucionet e tjera publike të sigurisë dhe drejtësisë penale është i ulët, individët mund të jenë më të prirur që ta konsiderojnë vetëmbrojtjen si një përgjegjësi personale (Institute for War and Peace Reporting and Saferworld, 2003). Në kushte të tilla, pandëshkueshmëria është më e përhapur dhe rrjedhimisht, zvogëlohet "kosto" e perceptuar e përftimit apo keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Banorët mund të ndihen të detyruar që ta marrin situatën në duart e tyre, veçanërisht nëse sistemet ligjore dhe politike shihen si të ngadalta, të anshme dhe joefikase. Rrjedhimisht, ky zvogëlim i legjitimitetit institucional kontribuon në normalizimin e zotërimit personal të armëve të zjarrit.

Gjithashtu, duket se kërkesa për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor ndikohet nga faktorët gjeografikë dhe politikë. Për shembull, në një periudhë të caktuar, në Maqedoninë e Veriut, niveli i zotërimit të armëve të zjarrit, sipas raportimeve, ishte më i lartë në zonat ku kalonin rrugët aktive të kontrabandimit (Ibid.), ndërsa në Serbi, niveli i pronësisë së armëve ishte më i lartë në rajonet lindore dhe rurale (UNDP and Saferworld, 2005). Këto modele sugjerojnë se faktorë të tillë si afërsia me rrjetet e trafikimit, mosmarrëveshjet e pazgjidhura dhe konfliktet politike në nivel vendor, mund të kontribuojnë në blerjen dhe zotërimin e armëve të zjarrit. Gjithashtu, duket se rol luajnë edhe dallimet midis zonave urbane dhe rurale. Në përgjithësi, popullsitë rurale kanë më shumë gjasa t'i shohin armët e zjarrit si të lidhura me trashëgiminë ose jetesën, edhe pse diçka e tillë nuk pasqyrohet gjithmonë në anketime.[12]

Roli i krimit të organizuar i ndërlikon edhe më tepër këto dinamike gjeografike dhe politike. Shpeshherë, prania e rrjeteve kriminale në qendrat urbane dhe në zonat rurale ndikon që autorët dhe viktimat e mundshme të kërkojnë armë zjarri, qoftë për qëllime keqdashëse ose për mbrojtje (SEESAC, 2004c). Krimi i organizuar nuk lidhet vetëm me nivelet më të larta të dhunës, por edhe me ndryshimet më të gjera shoqërore (Arsovska, 2008), ku përfshihen dobësimi i sundimit të ligjit dhe ulja e sigurisë publike. Faktorët strukturorë, si pabarazia në të ardhura, papunësia e të rinjve, si dhe niveli i ulët i frekuentimit të shkollës dhe i arritjeve arsimore janë perceptuar historikisht si rreziqe shtesë. Në mbarë rajonin, këto modele sugjerojnë se niveli real dhe i perceptuar i ekspozimit ndaj veprimtarive kriminale ka luajtur rol në formësimin e kërkesës për armë zjarri.[13]

**12** Dallimet në nivel nënrajonal theksojnë nevojën për studime të lokalizuara për të kuptuar se si kushtet kontekstuale ndikojnë te motivet dhe aksesi.

**13** Për shembull, në vitin 2024, qëllimet kriminale u përshkruan si arsyeja e dytë më e rëndësishme për zotërimin e armëve në Maqedoninë e Veriut. Një tjetër studim citoi traditën dhe mbrojtjen nga krimi si arsyet kryesore për zotërimin e armëve në Kosovë. Shihni Grillot, S., et al. 2004.

## Shqyrtimi i faktorëve mbrojtës

Në nivel global, dhe aq më shumë në Ballkanin Perëndimor, ekziston një mungesë e qartë e studimeve lidhur me faktorët mbrojtës që reduktojnë kërkesën për armë zjarri.[14] Kur këta faktorë janë shqyrtuar, vëmendja është fokusuar kryesisht në reduktimin e ekspozimit ndaj dhunës, nxitjen e angazhimit arsimor, forcimin e marrëdhënieve pozitive me bashkëmoshatarët, si dhe ndërtimin e familjeve dhe komuniteteve të qëndrueshme. Në Ballkanin Perëndimor, strategjitë më të zakonshme të propozuara, të cilat synojnë të ndikojnë te kërkesa, përfshijnë fushatat e ndërgjegjësimit të publikut mbi rreziqet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit, si dhe hartimin dhe zbatimin e rregulloreve për të parandaluar lëndimet e paqëllimshme. Megjithatë, evidencat që mbështesin efikasitetin e këtyre masave mbeten të kufizuara, edhe në rajone si Amerika e Veriut dhe Evropa Perëndimore, ku kjo temë është studiuar në nivele më të larta (Smart, Morral, Murphy, Jose, Charbonneau, and Smucker, 2024.).

Pavarësisht këtyre mangësive, literatura identifikon disa faktorë të mundshëm mbrojtës të lidhur me uljen e kërkesës për armë zjarri. Këtu përfshihen faktorët demografikë si gjinia dhe mosha, mjediset e qëndrueshme në familje dhe komunitet, përmirësimet socio-ekonomike, si dhe strategjitë e synuara për parandalimin e krimit. Edhe pse shumë prej këtyre faktorëve mbështeten te shkenca sociale, rëndësia e tyre specifike për Ballkanin Perëndimor mbetet në një masë të madhe e pavërtetuar. Mungesa e vlerësimeve të rrepta, si p.sh. e provave me përzgjedhje të rastësishme, nënkupton se duhet bërë kujdes në nxjerrjen e konkluzioneve gjatë zhvillimit të politikave ose programeve në rajon.

Në parim, faktorët mbrojtës janë faktorët që janë të lidhur me zvogëlimin e dëshirës për të marrë armë zjarri dhe me uljen e rrezikut të keqpërdorimit të tyre. Në përgjithësi, ndërhyrjet për zvogëlimin e kërkesës fokusohen te variablat në nivel individual (p.sh. frekuentimi i shkollës, vetëvlerësimi, angazhimi social me bashkëmoshatarët), dinamikat në nivel familjeje (p.sh. mbikëqyrja prindërore, praktikat e ruajtjes së sigurt) dhe kushtet më të gjera sociale (p.sh. siguria në shkollë, disponueshmëria dhe ekspozimi ndaj armëve të ligjshme dhe të paligjshme, si dhe kohezioni në komunitet).[15] Ndikimi i secilit prej këtyre faktorëve në reduktimin e kërkesës, qoftë përmes uljes së preferencës, rritjes së kostove[16], apo ndikimit në burime, varion në mjedise dhe popullsi të ndryshme, çka nënvizon rëndësinë thelbësore të qasjeve sipas kontekstit.

**14** Për shembuj nga SHBA, shihni, Ross, K. et al. 2023. Mattson, S., Sigel, E. dhe M. Mercado 2020.

**15** Teoria e sistemeve ekologjike argumenton se faktorët në nivele të ndryshme ndërveprojnë dhe ndikojnë te sjellja dhe rezultatet, në veçanti në nivel individual, familjeje, komuniteti dhe mes kolegëve/bashkëmoshatarëve.

**16** Ulja e ofertës së armëve të zjarrit të paligjshme mund të rrisë çmimet dhe të reduktojë aksesin në armë, duke rezultuar në ulje të përkohshme të blerjeve, veçanërisht nga personat me burime të kufizuara. Megjithatë, kjo nuk eliminon kërkesën e nxitur nga frika, statusi apo sipërmarrjet kriminale dhe mund të bëjë që disa individë të kërkojnë armë alternative apo rrugë të reja trafikimi. Zvogëlimi në mënyrë të qëndrueshme i blerjeve të armëve kërkon kombinimin e masave të kontrollit të ofertës me ndërhyrje për uljen e kërkesës që trajtojnë faktorë nxitës themelorë si pasiguria dhe krimi i organizuar.

Evidencat nga përtej Ballkanit Perëndimor flasin për potencialin që kanë presionet e jashtme sociale për të kufizuar kërkesën për armë zjarri. Më specifikisht, mosdhënia e pëlqimit nga partnerët intimë dhe bashkëmoshatarët/kolegët lidhur me marrjen e armëve të zjarrit, qëndrueshmëria familjare, si dhe sanksionet në lagje dhe efikasiteti kolektiv, pra aftësia e komuniteteve për të zbatuar normat sociale, janë të gjitha aspekte të lidhura me reduktimin e blerjeve të armëve të zjarrit (Muggah, 2006). Po ashtu, ndryshimet pozitive në klimën politike, cilësia e qeverisjes dhe normat në favor të rritjes së sigurisë, mund të ndikojnë në nivelin e perceptuar të pranueshmërisë dhe nevojës për të zotëruar armë zjarri (Oliphant et al., 2019. and Muggah, Atwood, and Katz, 2016). E thënë ndryshe, zhvillimet në nivele të ndryshme mund të zbusin apo amplifikojnë kërkesën për armë zjarri në varësi të impaktit që kanë te perceptimi i publikut dhe kapaciteti institucional.

Në Ballkanin Perëndimor, ekzistojnë disa faktorë të cilët përmenden shpesh si pengesë për zotërimin e armëve të zjarrit. Faktori më kryesor është bindja e një pjese të konsiderueshme të popullsisë që armët e zjarrit mund të rrisin rrezikun, në vend që ta zvogëlojnë atë, në veçanti për fëmijët dhe anëtarët e familjes (UNDP and Saferworld, 2005). Në përgjithësi, këto shqetësime artikulohen më shpesh nga gratë (SEESAC, 2019n). Shqetësime të përmendura shpesh janë frika nga incidentet me armë, aksesi i paautorizuar dhe lëndimet aksidentale (Spasić and Tadić, 2017). Në veçanti, shumë gra raportojnë se nuk kanë dëshirë për të zotëruar armë zjarri, edhe kur i kanë mundësitë financiare dhe ligjore për diçka të tillë, çka thekson se kërkesa ndikohet nga nevoja e perceptuar po aq sa nga niveli i aksesit (SEESAC, 2004c). Faktorë të tjerë që forcojnë qëndrimin kundër zotërimit të armëve janë perceptimet pozitive lidhur me sigurinë publike, mungesa e trajnimeve për armët e zjarrit (Hadzovic, et al. 2012), si dhe barra financiare e blerjes, zotërimit dhe mirëmbajtjes (Speyer, 2006). Në kontekstet ku legjislacioni për armët e zjarrit zbatohet në mënyrë të rreptë, kostot praktike, ligjore, financiare dhe psikologjike, mund të dekurajojnë zotërimin, veçanërisht nga personat e pavendosur.

Gjithashtu, edukimi i publikut, zbatimi më i fortë i ligjit dhe ndërhyrjet rregullatore mund t'i përforcojnë këto dinamika mbrojtëse. Fushatat e ndërgjegjësimit që e vënë theksin te rreziqet e armëve të zjarrit, në veçanti për partnerët intimë, fëmijët dhe fqinjët, mund të ndryshojnë preferencat, edhe pse rrallë kryhen vlerësime të përshtatshme të tyre (SEESAC, 2003b). Puna efektive e policisë dhe ndëshkimet më të ashpra për zotërimin e paligjshëm kanë gjithashtu gjasa të rrisin kostot e perceptuara të keqpërdorimit dhe pronësisë së paligjshme. Reformat ligjore që kufizojnë zotërimin dhe shtrëngojnë kërkesat për marrjen e lejeve, mund të reduktojnë gjithashtu kërkesën, siç pasqyrohet në ndryshimet në nivelet e regjistrimit të armëve, qëndrimet kundrejt sigurisë së armëve dhe madje edhe te çmimet në tregun e zi.[17]

Gjithashtu, vlen të theksohet se zhvillimet e jashtme gjeopolitike, si lufta Rusi-Ukrainë, dhe tensionet e vazhdueshme në rajon, mund të shërbejnë si katalizatorë të rritjes së kërkesës për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor. Kjo ndodh pasi perceptimi mbi pasigurinë mund të nxisë dëshirën për mbrojtje personale, duke rritur njëkohësisht

17 Këto teori diskutohen në më shumë detaje në seksionin gjashtë.

disponueshmërinë dhe duke ulur kostot e armëve të zjarrit përmes devijimit të tyre nga zonat e konfliktit. Gjithashtu, ekziston ideja se frika e publikut e shkaktuar nga vrasjet në masë dhe perceptimet për rritje të krimit të dhunshëm, mund të ndikojnë te qëndrimet ndaj blerjes së armëve. Megjithatë, këto ide rrallëherë u nënshtrohen testimeve të përshtatshme empirike.

Siç diskutohet gjerësisht më poshtë, portretizimet në media, platformat dixhitale dhe teknologjitë e reja mund të riformësojnë gjithashtu kërkesën për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor, në mënyra që nuk janë eksploruar ende plotësisht. Kultura popullore vazhdon të lartësojë zotërimin e armëve, ndërsa tregjet online, në veçanti ato që funksionojnë përmes mediave sociale ose rrjetit të errët (Dark Web), ofrojnë hapësira të reja dhe tejet të parregulluara për transaksionet me armë zjarri të paligjshme (Persi Paoli, Aldridge, Ryan and Warnes, 2017). Zhvillimet novatore si printimi në 3D, edhe pse nuk janë ende të përhapura në masë, përbëjnë sfida të mundshme të ardhshme në drejtim të kontrollit dhe aksesueshmërisë së armëve të zjarrit (SEESAC, 2024). Pavarësisht rritjes së shqetësimit në nivel global, mungojnë studimet specifike mbi rajonin për vlerësimin e këtyre rreziqeve dixhitale. Monitorimi në media sociale ofron një mënyrë për të nisur hartëzimin e këtyre ndikimeve që po evoluojnë, në veçanti duke pasur parasysh se angazhimi i publikut me përmbajtjet online po rritet dhe po ndikon te normat sociale të lidhura me përdorimin e armëve të zjarrit.

Konfliktet historike, së bashku me zgjerimin e krimit të organizuar, ndihmojnë për të ruajtur nivelet e trafikimit të armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor (Arsovska, 2015). Historikisht, grupet e armatosura kanë pasur akses tek armët përmes stoqeve të tepërta ushtarake dhe furnizuesve të huaj, dhe rrjetet kriminale në ditët e sotme vazhdojnë t’i shfrytëzojnë këto infrastruktura. Kjo panoramë komplekse thekson nevojën për strategji zbatimi të integruara dhe koordinim ndërkombëtar të politikave.

# 4.

# PERCEPTIMET E PUBLIKUT MBI PASIGURINË DHE PRONËSINË E ARMËVE TË ZJARRIT

Një anketim i opinionit publik i realizuar në të gjashtë juridiksionet gjatë periudhës 2024-2025 hodhi dritë mbi kërkesën për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor, një dimension i cili ishte eklipsuar për një kohë të gjatë nga studimet për ofertën, trafikimin dhe keqpërdorimin.[18] Edhe pse në Ballkanin Perëndimor realizohen rregullisht anketime mbi perceptimin për çështjet e lidhura me armët[19], rezultatet e anketimeve të fundit përbëjnë një gjetje të rëndësishme analitike. Ato ofrojnë të dhëna specifike mbi mendimet e individëve në mbarë rajonin lidhur me armët: pse i dëshirojnë armët dhe si ndikojnë faktorët kulturorë dhe ligjorë në qëndrimet e tyre. Disa prej gjetjeve kundërshtojnë dijet tradicionale dhe tregojnë se kërkesa për armë zjarri nuk rritet detyrimisht vetëm nga nivelet e larta të frikës së publikut dhe perceptimet mbi pasigurinë. Gjithashtu, gjetjet nënvizojnë faktin se shumica e banorëve në rajon shprehin mbështetje të fortë për kontrolle më të rrepta për armët.  Anketimi paraqet kontradikta, ndërmjet pasigurisë dhe kufizimit, traditës dhe skepticizmit, familjaritetit dhe hezitimit, të cilat ndërlikojnë çdo narrativë të thjeshtë mbi kërkesën për armë në Ballkanin Perëndimor.

Vëzhgimi i përgjithshëm është se gjinia shfaqet si një faktor i konsiderueshëm dhe i vazhdueshëm që përcakton qëndrimet ndaj zotërimit dhe përdorimit të armëve të zjarrit. Në të gjashta juridiksionet, burrat shfaqin në mënyrë të vazhdueshme qëndrime më të pranueshme ndaj armëve të zjarrit, krahasuar me gratë. Gjithashtu, ata paraqesin një nivel të lartë familjariteti me armët e zjarrit dhe kanë më shumë gjasa, krahasuar me gratë, që të zotërojnë armë zjarri apo të shfaqin interes për zotërimin e tyre. Ekzistojnë dallime edhe ndërmjet grupeve të tjera demografike, por janë më pak të theksuara. Për shembull, të rinjtë, veçanërisht meshkujt e grupmoshës 18-40 vjeç, priren të kenë qëndrime disi më pozitive ndaj pronësisë së armëve të zjarrit krahasuar me meshkujt më të rritur. Në veçanti, meshkujt e grupmoshës 18-30 vjeç kanë gjasa të besojnë se zotërimi i një arme zjarri do të rriste sigurinë e tyre personale. Gjinia dhe mosha janë faktorë që ndikojnë në blerjen e armëve të zjarrit. Më konkretisht, meshkujt kanë shumë më tepër gjasa se çdo grup tjetër që të kërkojnë në mënyrë aktive armë zjarri dhe që t'i përdorin ato.

Nga ana tjetër, niveli arsimor dhe vendndodhja e të anketuarve shfaqin një tendencë më pak konsistente se sa ishte supozuar në literaturë, lidhur me ndikimin e tyre në kërkesën për armë zjarri. Edhe pse individët që raportojnë nivele më të larta arsimore duket se kanë një qëndrim më pak mbështetës ndaj përdorimit të armëve të zjarrit gjatë festimeve, qëndrimi i tyre mbështetës për përdorimin e armëve të zjarrit për vetëmbrojtje ose në përgjigje të kërcënimeve të perceptuara apo si ndëshkim, është shumë pranë mesatares rajonale. Në fakt, dëshira e tyre e përgjithshme për të zotëruar armë zjarri është e krahasueshme me atë të popullsisë së përgjithshme. Ndërkohë, banorët e zonave rurale kanë një nivel pak më të lartë pranimi të zotërimit të armëve të zjarrit, duke përfshirë në të shtënat festive, si dhe raportojnë nivele zotërimi pak më të larta krahasuar me banorët e zonave urbane. Megjithatë, nivelet e interesit për marrjen e armëve të

18 Anketimet u porositën nga SEESAC në vitin 2024 dhe u realizuan në vitet 2024 dhe 2025.

19 Shihni Barometrat dhe Barometrat e Sigurisë (SecuriMeter) të KBR-së në https://www.rcc.int/balkanbarometer/publications dhe https://www.rcc.int/securimeter/publications. Shihni gjithashtu anketimet mbi perceptimin të porositur nga SEESAC në https://www.seesac.org/SALW-Surveys/.

zjarrit janë të ngjashme te popullsitë urbane dhe rurale.

Ekzistojnë ndasi të thella lidhur me opinioni publik për sigurinë në Ballkanin Perëndimor. Në një shkallë nga një në dhjetë, ku 1 simbolizon siguri dhe 10 rrezik, më pak se çereku i të anketuarve (23 për qind) e konsiderojnë rajonin si të rrezikshëm, më shumë se një e katërta (27 për qind) e shohin si të pasigurt dhe pjesa më e madhe (51 përqind) janë neutralë (shihni figurën 4).[20] Meshkujt janë disi më optimistë për sigurinë, krahasuar me gratë. Perceptimet janë më pesimiste nga personat e papunë, banorët në zonat rurale dhe personat me të ardhura nën mesatare. Më konkretisht, 30% e të anketuarve në secilën prej këtyre kategorive e shohin rajonin si të pasigurt/rrezikshëm. Siç parashikohet në literaturë, personat që kanë mbajtur më parë armë ose që kanë pasur ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj armëve të zjarrit, veçanërisht në kontekste të dhunshme, kanë më shumë gjasa ta shohin Ballkanin Perëndimor si një rajon të pasigurt. Edhe pse numri i situatave të perceptuara si të pasigurta në nivel vendor përkon me perceptimet mbi sigurinë në nivel rajonal, lidhja midis tyre është e dobët nga pikëpamja statistikore, çka sugjeron se përshtypjet më të gjera mbi sigurinë në nivel rajonal nuk vijnë thjesht si shumë e përvojave në nivel vendor.

*Figura 4.*
**Sa i sigurt apo i rrezikshëm është rajoni i Ballkanit Perëndimor?**
(**n = 6819,** ky grafik përjashton përgjigjet që bien në kategorinë ndërmjet i sigurt dhe i rrezikshëm)




20 Përveçse kur specifikohet ndryshe, të dhënat e prezantuara në figurat në këtë raport janë paraqitur si përqindje. Në kuadër të anketimeve të porositura nga SEESAC, u zbatuan dy procedura të ndryshme ponderimi. Këto procedura mund të krijojnë mospërputhje të vogla ndërmjet mesatareve rajonale dhe të dhënave në nivel juridiksioni, megjithatë nuk ndikojnë tek interpretimi. Në çdo figurë, përqindjet që kanë diferenca të konsiderueshme statistikore nga mesatarja rajonale, janë shënuar me të kuqe, nëse janë nën mesataren rajonale, dhe me të gjelbër, nëse janë mbi mesataren rajonale. Një diferencë e konsiderueshme nga pikëpamja statistikore tregon se ndryshimi nuk ka gjasa të ketë ndodhur rastësisht dhe mund t'i atribuohet efektit sistematik të një faktori të caktuar.

Qëndrimet ndaj sigurisë në nivel rajonal janë të ndryshme ndërmjet juridiksioneve. Për shembull, në Shqipëri, pikëpamjet janë dukshëm të polarizuara: 37 për qind e shohin rajonin si të sigurt (niveli më i lartë në rajon), ndërsa 30 për qind e konsiderojnë të rrezikshëm. Në dallim, Bosnjë-Hercegovina raporton përqindjen më të lartë të banorëve (35 për qind) që e shohin rajonin si të pasigurt, dhe vetëm një përqindje e ulët (13 për qind) shprehin ndjenjë sigurie. Nga ana tjetër, në Serbi të anketuarit kanë më pak gjasa ta etiketojnë rajonin si të rrezikshëm (18 për qind) dhe janë më të prirur të jenë neutralë (57 për qind), një perceptim ky që mbështetet edhe në Malin e Zi (56 për qind). Ndërkohë, në Maqedoninë e Veriut perceptimet mbi sigurinë janë më të ulëta. Vetëm 17 për qind e konsiderojnë rajonin të sigurt dhe 28 për qind gjykojnë se rajoni është i pasigurt. Perceptimet janë të ngjashme në Kosovë ku 23 për qind e të anketuarve e përshkruajnë rajonin si të sigurt dhe 27 për qind shprehen se është i rrezikshëm. Kjo tablo paraqet perceptimet e fragmentuara që ndikohen si nga konteksti vendor dhe përvojat personale, po ashtu edhe nga realiteti më i gjerë rajonal. Vlen të theksohet se anketimet e pavarura konfirmojnë se perceptimet mbi sigurinë dhe pasigurinë nuk kanë pësuar luhatje të konsiderueshme gjatë viteve të fundit.[21]

**21** SecuriMeter 2024 konstatoi se nuk ka pasur ndryshime të konsiderueshme të perceptimeve mbi sigurinë dhe pasigurinë në Ballkanin Perëndimor gjatë periudhës 2022-2024. Një përqindje relativisht e ulët e popullsisë në çdo juridiksion është "plotësisht dakord" dhe "aspak dakord" me pohimin se rajoni është i sigurt. Pjesa më e madhe e popullsisë janë neutralë. Për shembull, në Shqipëri, 40 për qind janë "aspak dakord" ose "përgjithësisht jo dakord" me pohimin se rajoni është një vend i sigurt për të jetuar, ndërsa në Bosnjë-Hercegovinë kjo shifër ishte 31 për qind, në Mal të Zi 30 për qind, në Serbi 29 për qind, në Maqedoninë e Veriut 28 për qind dhe në Kosovë 21 për qind. Megjithatë, vlerësimi i vitit 2024 zbuloi një rënie, krahasuar me vitet e kaluara, të përqindjes së banorëve që janë plotësisht dakord me pohimin se Ballkani Perëndimor është një vend i sigurt për të jetuar.

*Figura 5.*
**Perceptimet mbi sigurinë: sa të sigurta i konsideroni situatat në vijim, sipas kategorisë?**
**(n = 6819)**

***% aspak e sigurt + pak e sigurt***




Çuditërisht, nuk duhet se ka një lidhje të drejtpërdrejtë apo lineare ndërmjet perceptimeve mbi mungesën e sigurisë dhe preferencave për të marrë armë zjarri. Siç është konstatuar më sipër, ndjesia e pasigurisë së publikut është relativisht e lartë në mbarë rajonin. Mesatarisht, më tepër se shtatë në dhjetë banorë në mbarë rajonin kanë raportuar se ndihen të pasigurt nëse largohen nga shtëpia pa e kyçur derën dhe pothuajse gjysma e banorëve janë shprehur se ndihen të shqetësuar kur largohen dhe nuk ka njeri në shtëpi. Pothuajse gjysma kanë shprehur shqetësim mbi mbajtjen e parave në portofol dhe një e treta kanë frikë të ecin vetëm gjatë natës (shihni figurën 5). Megjithatë, niveli i përhapjes dhe intensitetit të frikës nuk është i njëjtë në mbarë

rajonin. Gratë dhe të moshuarit ndihen më pak të sigurt, krahasuar me burrat, në të gjitha situatat. Të anketuarit nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut raportojnë nivelet më të larta të shqetësimit, ndërsa të anketuarit nga Kosova, Mali i Zi dhe Serbia duket se ndihen disi më të sigurt.[22] Kjo frikë e dukshme lidhet me motivin e mbrojtjes së vetes dhe të familjes, i cili është cituar shprehimisht nga një e treta (34 për qind) e të anketuarve si arsye kryesore për zotërimin e armëve të zjarrit.

Perceptimet mbi dhunën dhe incidentet me armë zjarri variojnë ndjeshëm në Ballkanin Perëndimor dhe një përqindje e konsiderueshme e banorëve shprehin shqetësim lidhur me sigurinë personale në komunitetet e tyre. Rreth 36 për qind e të gjithë të anketuarve raportojnë se vjedhjet e banesave ndodhin të paktën herë pas here[23], 20 për qind mendojnë se gjatë hyrjes me forcë në banesë ushtrohet dhunë dhe në 24 për qind ekziston perceptimi për sulme fizike të shpeshta ose periodike në hapësirat publike (shihni figurën 6). Shqetësimet lidhur me dhunën me armë zjarri janë disi më të ulëta, por gjithsesi të dukshme: 14 për qind e lidhin dhunën me armë zjarri me kontekstin jofamiljar, ndërsa 13 për qind raportojnë incidente që përfshijnë anëtarë të familjes ose të afërm. Ç'është më e rëndësishmja, ekspozimi i mëparshëm ndaj armëve të zjarrit, veçanërisht në kontekste të dhunshme, rrit probabilitetin që individët ta perceptojnë dhunën fizike dhe me armë si më të përhapur. Nga ana tjetër, individët që kanë mbajtur armë zjarri, pa përjetuar dhunë, priren t'i perceptojnë këto incidente si më pak të shpeshta.[24]

**22** Sipas anketimeve, një përqindje e konsiderueshme e banorëve në Ballkanin Perëndimor besojnë gjithashtu se në komunitetet e tyre ndodhin herë pas here, ose edhe shpeshherë, raste të dhunës fizike dhe incidenteve me armë. Më tepër se një e treta besojnë se vjedhjet janë një fenomen i përhapur, një e katërta mendojnë se sulmet në rrugë janë të shpeshta dhe një e pesta janë të shqetësuar lidhur me sulmet gjatë hyrjeve me forcë në banesë. Banorët në Serbi dhe Mal të Zi raportojnë nivele më të larta shqetësimi, krahasuar me mesataren rajonale.

**23** Mesatarja rajonale ulet ndjeshëm falë shifrave të Kosovës. Shihni figurën 6.

**24** Këto tendenca janë konsistente pavarësisht gjinisë, por ndryshojnë sipas llojit të vendbanimit dhe statusit socio-ekonomik. Më konkretisht, të anketuarit nga zonat urbane dhe me të ardhura financiare më të larta kanë më shumë gjasa që ta perceptojnë dhunën si të përhapur.

*Figura 6.*

**Sa shpesh mendoni se banorët në vendbanimin tuaj përjetojnë llojet e dhunës në vijim?**
**(n = 6819)**

***% shpesh + ndonjëherë***




Në nivel juridiksioni, perceptimet mbi dhunën me armë ndryshojnë ndjeshëm. Banorët në Serbi dhe Mal të Zi shfaqin perceptime më të larta se mesatarja për të gjitha llojet e dhunës, veçanërisht lidhur me sulmet fizike dhe incidentet me armë zjarri. Për shembull, të anketuarit nga të gjitha juridiksionet, me përjashtim të Kosovës, raportojnë shqetësime mbi mesatare lidhur me hyrjet me forcë në banesë. Në Serbi, 33 për qind besojnë se sulmet në rrugë ndodhin rregullisht dhe një e katërta raportojnë ekspozim të shpeshtë ndaj dhunës me armë, si në kontekstin familjar po ashtu dhe në atë publik. Mali i Zi ka tendenca të ngjashme, edhe pse me shifra pak më të ulëta. Nga ana tjetër, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut shfaqin përqindje ndjeshëm më të ulëta të dhunës së raportuar me armë zjarri, çka sugjeron një marrëdhënie komplekse ndërmjet sigurisë së perceptuar dhe rrezikut faktik. Bosnjë-Hercegovina paraqet shifra shumë të ngjashme me mesataren rajonale dhe një nivel të lartë shqetësimi lidhur me vjedhjet e banesave, ndërsa Kosova raporton në mënyrë konsistente përqindjen më të ulët të perceptuar të dhunës me armë në të gjitha kategoritë.[25]

**25** Vlen të theksohet se një anketim i kryer nga "Barometer" i KBR-së, i cili paraqitet në Raportin e 9-të rajonal të SEESAC për KPI-të, konstaton se ekziston një nivel relativisht i lartë i pasigurisë së perceptuar lidhur

*Figura 7.*

**Perceptimet mbi sigurinë: cila është mënyra më efikase për të përmirësuar sigurinë?**
**(n = 6819)**




Ajo që ka rëndësi është fakti se pavarësisht perceptimeve të përhapura mbi pasigurinë, shumë prej të anketuarve e refuzojnë idenë se më shumë armë përkthehet në më shumë siguri. Në nivel rajonal, 30 për qind e të gjithë të anketuarve gjykojnë se rregulloret më të rrepta për kontrollin e armëve janë qasja më efektive, 28 për qind bëjnë thirrje për rritje të pranisë së policisë dhe autoriteteve të sigurisë dhe 24 për qind sugjerojnë rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi rreziqet e armëve të zjarrit (shihni figurën 7). Nga ana tjetër, vetëm 10% e të anketuarve e shohin dorëzimin/heqjen dorë nga armët si zgjidhjen më të mirë, dhe një pjesë e ulët prej 5 për qind besojnë se përgjigja është rritja e numrit të individëve që zotërojnë armë për vetëmbrojtje. Personat me përvoja të mëparshme lidhur me armët e zjarrit janë në përgjithësi më në favor të rregulloreve më të rrepta për armët e zjarrit, përmirësimit të masave të sigurisë dhe rritjes së ndërgjegjësimit të

me armët e zjarrit të paligjshme dhe keqpërdorimin e tyre. Mbi 6000 banorë nga kryeqytetet e juridiksioneve përkatëse u pyetën përmes telefonit, gjatë muajve mars dhe prill 2023, nëse ndiheshin të kërcënuar nga keqpërdorimi dhe zotërimi i paligjshëm i armëve në lagjet e tyre. Rezultatet ishin të ndryshme nga anketimi i përmendur më sipër. Shihni KPI 14 në https://www.seesac.org/f/docs/ninth-regional-coordination-meeting/9th-Regional-KPIs-Report.pdf.

publikut. Megjithatë, ata janë disi më të prirur se personat pa përvoja të tilla, në një nivel mbi mesataren rajonale, që të mbështesin rritjen e numrit të personave që zotërojnë armë zjarri për vetëmbrojtje.[26] Të anketuarit në Serbi ishin më të prirur që ta vinin theksin te kuadrot ligjorë më të rreptë, ndërsa në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut nënvizuan rritjen e pranisë së autoriteteve të sigurisë, dhe në Kosovë dhe Mal të Zi mbështetën përpjekjet e çarmatimit.

*Figura 8.*
**Si ndiheni lidhur me mbajtjen e armëve të zjarrit në shtëpi?**
**(n = 6819,** Kjo shifër përjashton përgjigjet “Nuk e di/Refuzoj“)




Në fakt, gjysma (50 për qind) e të anketuarve në të gjithë Ballkanin Perëndimor shprehen se mbajtja e armëve të zjarrit në shtëpi nuk sjell ndryshim në përmirësimin e ndjenjës së sigurisë (shihni figurën 8). Një pikëpamje e tillë është më e lartë në Serbi (59 për qind) dhe më e ulët në Maqedoninë e Veriut (43 për qind). Rreth 22 për qind e të anketuarve konfirmojnë se mbajtja e armëve të zjarrit në shtëpi do të zvogëlonte ndjenjën e tyre të sigurisë (niveli më i lartë ishte në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut me 31 për qind) ndërsa 20 për qind mendojnë se do të rriste sigurinë e tyre (deri në 27 për qind në Malin e Zi). Në përgjithësi, burrat dhe gratë bien dakord se të pasurit e një arme zjarri në shtëpi nuk sjell ndryshim në ndjenjën e tyre të sigurisë. Megjithatë, numri i burrave që janë shprehur se mbajtja e armëve të zjarrit në shtëpi do t'i bënte të ndiheshin më të sigurt, është shumë më i lartë krahasuar me gratë (përkatësisht, 26 për qind dhe 12 për qind). Nga ana tjetër, numri i grave që janë shprehur se mbajtja e armëve do t'i bënte të ndiheshin më pak të sigurta, është më i lartë krahasuar me burrat (përkatësisht, 26 për qind dhe 16 për qind). Gjithashtu, të rinjtë, në veçanti meshkujt e grupmoshës 18-30 vjeç, kanë më shumë gjasa të raportojnë se do të ndiheshin më të sigurt nëse kanë armë zjarri

**26** Niveli i kësaj mbështetjeje është 7 për qind ndër personat që kanë mbajtur armë zjarri, 8 për qind ndër personat me përvoja të lidhura me armët e zjarrit dhe 7 për qind ndër personat që janë përballur me armët e zjarrit në një kontekst të dhunshëm.

në shtëpi (23 për qind).[27]

Personat me përvojë lidhur me armët e zjarrit, qoftë përmes mbajtjes së tyre ose përfshirjes në situata të lidhura me armët e zjarrit, apo ekspozimit në kontekste të dhunshme, kanë më shumë gjasa që të ndihen më të sigurt në rastin e mbajtjes së armëve të zjarrit në shtëpi (përkatësisht 30 për qind, 40 për qind dhe 36 për qind), krahasuar me personat pa përvoja të tilla (përkatësisht 13 për qind, 14 për qind dhe 18 për qind) dhe me mesataren rajonale, e cila është 20 për qind (shihni figurën 8). Kjo ndjenja e sigurisë është edhe më e lartë në mesin e pronarëve aktualë të armëve të zjarrit (59 për qind) dhe të personave që aspirojnë të zotërojnë armë zjarri (69 për qind). Megjithatë, mbajtja e armëve të zjarrit në shtëpi lidhet disi vetëm me ndjenjat e përgjithshme të sigurisë në jetën e përditshme; banorët që ndihen plotësisht të sigurt në komunitetet e tyre kanë më shumë gjasa që të thonë se mbajtja e armëve të zjarrit në shtëpi nuk do të ndikonte në ndjenjën e tyre të sigurisë (58%), si dhe më pak gjasa që të ndihen më pak të sigurt (15 për qind). Ndërkohë, personat që ndihen më të pasigurt kanë më pak gjasa të mendojnë se armët e zjarrit nuk do të kenë ndikim (45 për qind) dhe më shumë gjasa që të besojnë se do të ndiheshin më pak të sigurt (26 për qind).

*Figura 9.*
**Efektet e mbajtjes së armëve të zjarrit në shtëpi, sipas ndjenjës së sigurisë, në shtatë situata të përditshme**
***- Nëse do të kishit armë zjarri në shtëpi, a do të ndiheshit...?***
**(n = 6819,** Kjo shifër përjashton përgjigjet “Nuk e di/Refuzoj“)




Më tepër se gjysma e të anketuarve në Ballkanin Perëndimor besojnë se aksesi universal në armë zjarri do të rezultonte në rritjen e krimit. Në një shkallë nga një në dhjetë, ku 1 nënkupton më pak krim dhe 10 më shumë krim, 54 për qind e të anketuarve

27 Gjithashtu, personat me të ardhura financiare nën mesatare kanë shprehur një ndjenjë më të lartë sigurie në rastin e mbajtjes së armëve në shtëpi (22 për qind), krahasuar me personat me të ardhura mesatare (17 për qind), apo personat me të ardhura mbi mesatare (14 përqind).

e kanë vlerësuar ndikimin 8-10, duke treguar një perceptim të fortë për rritje të krimit (shihni figurën 10). Vetëm 12 për qind kanë parashikuar rënie (vlerësim 1-3), dhe 34 për qind kanë pasur një pikëpamje neutrale (vlerësim 4-7). Gratë kanë pak më tepër gjasa se burrat që të perceptojnë rritje të krimit, ndërsa burrat priren të kenë qëndrime neutrale. Perceptimet ndryshojnë gjithashtu edhe sipas grupeve socio-ekonomike dhe demografike: 62 për qind e individëve me të ardhurave financiare nën mesatare dhe 61 për qind e personave të grupmoshës 61 vjeç e më lart, besojnë se krimi do të rritet në rastin e aksesit universal në armë. Është interesant fakti se përvoja personale me armët e zjarrit nuk i ndryshon në mënyrë të konsiderueshme këto qëndrime. Megjithatë, personat që zotërojnë armë zjarri ose që synojnë të marrin armë zjarri kanë më shumë gjasa që të besojnë se aksesi në armë mund të reduktojë krimin dhe kanë më pak gjasa të besojnë se aksesi në armë do të përkeqësojë nivelin e krimit.

Ekzistojnë dallime të thella midis juridiksioneve lidhur me pikëpamjet e banorëve mbi ndikimin e aksesit universal në armë zjarri te nivelet e krimit. Për shembull, një përqindje dërrmuese e të anketuarve në Shqipëri (76 për qind) besojnë se rritja e aksesit në armët e zjarrit do të rriste krimin, dhe vetëm 11 për qind kanë një pikëpamje më neutrale. Banorët në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut raportojnë nivele shqetësimi më të ulëta. Përkatësisht, 45%, 49% dhe 48% e banorëve në këto juridiksione parashikojnë rritje të krimit. Në veçanti, 18 për qind e të anketuarve në Bosnjë-Hercegovinë besojnë se aksesi universal në armët e zjarrit do të reduktonte në fakt krimin, një shifër kjo që përbën nivelin më të lartë të mbështetjes në rajon. Ndërkohë, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve në Kosovë (43 për qind), Maqedoninë e Veriut (41 për qind) dhe Mal të Zi (38 për qind) mbeten të pasigurt lidhur me ndikimin e mundshëm të disponueshmërisë së gjerë të armëve të zjarrit te nivelet e krimit, çka pasqyron një ndërthurje midis hezitimit dhe pavendosmërisë.

*Figura 10.*

**Jepni mendimin tuaj në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 nënkupton "Nëse të gjithë do të kishin akses në armë zjarri, do të kishte më pak krim" dhe 10 nënkupton "Nëse të gjithë do të kishin akses në armë zjarri, do të kishte më shumë krim"?**
**(n = 6819)**



Qëndrimet e publikut në Ballkanin Perëndimor shfaqin një tendencë mbrojtëse ndaj të rinjve dhe një pikëpamje më tradicionale që favorizon marrjen e njohurive nga të rriturit mbi administrimin dhe përdorimin e armëve të zjarrit. Për shembull, një pjesë dërrmuese prej 81 për qind e të anketuarve në mbarë rajonin bien dakord se ekspozimi ndaj përmbajtjes së dhunshme në media ndikon te sjellja e të rinjve, dhe 65 për qind janë kundër blerjes së armëve të zjarrit lodër për fëmijët. Shqetësimi mbi ekspozimin e të rinjve është i përhapur në të dyja gjinitë, edhe pse gratë kanë shumë më tepër gjasa që të kundërshtojnë blerjen e armëve lodër. Megjithatë, kur bëhet fjalë për të rriturit, ekziston gjykimi i përgjithshëm se duhet të kenë kompetenca lidhur me armët e zjarrit: 65 për qind shprehen se të gjithë meshkujt e në moshë madhore duhet të dinë si të përdorin një armë zjarri, dhe 37 për qind kanë të njëjtën pikëpamje edhe për gratë. Këto shifra janë shumë më të larta se mbështetja për zotërimin e armëve nga burrat dhe gratë.

Pavarësisht niveleve të ulëta të mbështetjes së drejtpërdrejtë për zotërimin e armëve të zjarrit, një përqindje e konsiderueshme, edhe pse pakicë, kanë pikëpamje të konsoliduara mbi aspektet kulturore dhe ligjore të armëve të zjarrit. Rreth 26 për qind e të anketuarve besojnë se zotërimi i armëve është pjesë e identitetit kombëtar, 19 për qind janë në favor të zbutjes së ligjeve për armët, 17 për qind mendojnë se çdo burrë duhet të zotërojë një armë zjarri dhe 10 për qind ndajnë të njëjtin mendim edhe për gratë në moshë madhore. Megjithatë, më shumë se gjysma e të anketuarve (56 për qind) i refuzojnë këto katër propozime, çka tregon se shumica nuk e përkrah zotërimin e armëve të zjarrit. Banorët në Malin e Zi duket se kanë mbështetjen më të lartë ndaj armëve të zjarrit, ndërsa të anketuarit në Shqipëri shfaqin nivelin më të ulët të mbështetjes për zotërimin e armëve. Siç pritej, burrat kanë më shumë gjasa se sa gratë që të mbështesin përdorimin dhe zotërimin e armëve të zjarrit. Megjithatë, përgjigjet nga të dyja gjinitë konvergojnë në shqetësimet lidhur me përmbajtjet e dhunshme në media dhe çuditërisht, në parimin që gratë të zotërojnë armë zjarri.

Faktorët e lidhur me breza të caktuar dhe përvoja formësojnë më tej qëndrimet ndaj armëve të zjarrit. Të rinjtë (18-30 vjeç) shfaqin mbështetje mbi mesatare që gratë të kenë njohuri rreth armëve (41 për qind krahasuar me mesataren prej 37 përqind) dhe të zotërojnë armë (12 për qind krahasuar me mesataren prej 10 përqind), si dhe që të zbuten rregulloret për armët e zjarrit (21 për qind krahasuar me mesataren prej 19 për qind). Ndërkohë, individët me përvoja personale në përdorimin/mbajtjen e armëve të zjarrit ose që zotërojnë armë zjarri shfaqin një mbështetje më të lartë për të drejtat për të zotëruar armë. Përjashtim përbëjnë individët që janë ekspozuar ndaj incidenteve të dhunshme, të cilët shfaqin interes mesatar për zbutjen e kufizimeve mbi disponueshmërinë e armëve. Për ta përmbledhur, edhe pse në mbarë rajonin ekziston shqetësimi i nivelit të lartë të zotërimit të armëve, veçanërisht në kontekstin e sigurisë së fëmijëve dhe sigurisë publike, një përqindje e konsiderueshme e popullsisë, në veçanti meshkujt, të rinjtë dhe përdoruesit me përvojë i konsiderojnë armët e zjarrit si një aftësi të vlefshme dhe në disa raste, si simbol kulturor.

Gjithashtu, ka një nivel të lartë dakordësie mbi faktin se përmbajtja e dhunshme në media ndikon negativisht tek të rinjtë, veçanërisht në Shqipëri (87 për qind) dhe Serbi (84 për qind), ndërsa në Kosovë kjo shifër bie në 62 për qind. Një model i ngjashëm shfaqet

edhe në rastin e armëve të zjarrit lodër, ku Shqipëria (77 për qind) dhe Bosnjë-Hercegovina (72 përqind) kanë nivelin më të lartë të personave kundër blerjes së tyre, ndryshe nga Kosova, Mali i Zi dhe Serbia ku përqindjet janë më të ulëta. Shumica e banorëve në të gjitha juridiksionet besojnë se meshkujt në moshë madhore duhet të dinë si të përdorin armët e zjarrit, ndërkohë që varion mbështetja që gratë të marrin njohuri mbi përdorimin e armëve të zjarrit; në Bosnjë-Hercegovinë (70 për qind për burrat) dhe në Shqipëri (65 për qind për burrat), ka një përqindje të konsiderueshme të personave që mendojnë se edhe gratë duhet t'i kenë këto njohuri (përkatësisht 43 dhe 42 për qind). Maqedonia e Veriut regjistron nivelin më të ulët të mbështetjes për të dyja gjinitë. Mbështetja për zotërimin e armëve të zjarrit është më e ulët. Megjithatë, bien në sy të anketuarit në Mal të Zi dhe Kosovë, të cilët shprehin nivel më të lartë mbështetjeje për zbutjen e ligjeve për armët (përkatësisht 31 dhe 30 për qind) dhe lidhje më të fortë ndërmjet armëve të zjarrit dhe identitetit kombëtar (përkatësisht 39 dhe 29 për qind).

*Figura 11.*
***Duke mos përfshirë profesionet që lidhen me mbajtjen e armëve të zjarrit (policia, ushtria, shoqëritë private të sigurisë), cila mendoni se është arsyeja kryesore për të mbajtur armë zjarri?***
**(n = 6819)**



Opinioni publik lidhur me arsyen e individëve për të zotëruar armë zjarri nuk është aspak uniform në Ballkanin Perëndimor. Siguria dhe mbrojtja janë në krye të listës (33 për qind e të anketuarve), pasuar nga rekreacioni apo zbavitja (23 për qind) dhe statusi (23 për qind), ndërsa tradita është në vendin e fundit me vetëm 16 për qind (shihni figurën 11). Ndër pronarët e armëve të zjarrit, 37 për qind citojnë sigurinë si arsyen kryesore, çka është gjerësisht në përputhje me perceptimin në nivel rajonal, ndërsa 34 për qind përmendin rekreacionin, një shifër kjo mbi mesataren. Megjithatë, për sa i përket pronarëve aspirues, një nivel befasues prej 61 për qind përmendin mbrojtjen si arsyen kryesore. Të ardhurat duket se kanë ndikim tek arsyet: 37 e personave me të ardhura mbi mesatare citojnë sigurinë, ndërsa në rastin e kategorisë së personave me të ardhurave mesatare dhe nën mesatare, kjo arsye është përmendur nga përkatësisht 32 dhe 31 për qind. Edhe pse dallimet gjinore janë të vogla, përqindja e burrave që përmendin mbrojtjen si arsye është më e lartë krahasuar me gratë, ndërsa këto të fundit kanë tendencën që t'i shohin armët e zjarrit si simbol i statusit. Vlen të theksohet se personat që janë përballur me përvoja të dhunshme me armët e zjarrit përmendin statusin si arsye kryesore (30 për qind) në një masë më të lartë se mesatarja rajonale (22 për qind) dhe personat pa përvoja të tilla (22 për qind).

Siç parashikohej, arsyet për zotërimin e armëve të zjarrit janë të ndryshme sipas juridiksionit. Në Malin e Zi, tradita luan një rol të konsiderueshëm dhe është përmendur nga 34 për qind e të anketuarve si arsyeja kryesore, ndërsa siguria është konsideruar si arsye prioritare nga vetëm 22 për qind. Nga ana tjetër, Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova janë më të fokusuara te rreziku. Më konkretisht, 42 për qind e të anketuarve në secilin prej këtyre juridiksioneve kanë përmendur mbrojtjen si arsye kryesore, një shifër ndjeshëm më e lartë se mesatarja rajonale. Në Shqipëri, 33 për qind i shohin armët e zjarrit kryesisht si mjete për qëllime rekreative, ndërsa statusi është cituar nga 27 për qind, një shifër pak më e lartë se mesatarja. Maqedonia e Veriut ofron një profil edhe më të balancuar: siguria mbetet arsyeja më e përmendur me 29 për qind (pak më ulët se mesatarja rajonale), ndërsa rekreacioni është në nivelin 27 për qind (pak më lart se mesatarja rajonale). Këto gjetje nënvizojnë faktorët e ndryshëm kulturorë, ekonomikë dhe kontekstualë që ndikojnë te perceptimi mbi pronësinë e armëve të zjarrit në një rajon të karakterizuar nga shumëllojshmëria sociale dhe politike.

*Figura 12.*
**Sa i pranueshëm është përdorimi i armëve të zjarrit në secilën prej situatave në vijim?**
**(n = 6819)**




Vetëmbrojtja mbetet arsyeja kryesore për përdorimin e armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor. Më konkretisht 54% e banorëve pranojnë përdorimin e saj tyre kur sulmohen dhe 48% pranojnë përdorimin kur perceptohet një rrezik. Mbështetja bie përtej këtyre skenarëve: përdorimi i armëve në të shtënat festive është miratuar nga vetëm 18%, ndërsa një nivel i ulët prej 8% mbështesin përdorimin e armëve të zjarrit për kërcënim ose ndëshkim (shihni figurën 12). Burrat, personat me të ardhura të larta financiare dhe studentët kanë një nivel më të lartë mbështetjeje për çdo skenar, krahasuar me të tjerët. Gjithashtu, familjariteti me armët e zjarrit është një faktor një nxit mbështetjen, pavarësisht nëse lidhet me zotërimin ose mbajtjen e tyre, apo përvojat e mëparshme të dhunshme. Ndër personat që dëshirojnë të zotërojnë një armë zjarri, mbështetja për përdorimin e armëve për vetëmbrojtje arrin 86 për qind në rastet e një sulmi të drejtpërdrejtë dhe 78 përqind kur ekziston rreziku për një sulm.

Megjithatë, niveli i pranimit të armëve të zjarrit nuk është i njëjtë në mbarë rajonin. Mali i Zi del në pah si juridiksioni me mbështetjen më të lartë për përdorimin e armëve në shumicën e skenarëve: 64 për qind e të anketuarve mbështesin përdorimin e armëve për vetëmbrojtje, 57 për qind në rastet e një kërcënimi të mundshëm dhe 35 për qind gjatë festimeve, shifra këto të cilat janë të gjitha mbi mesataret rajonale. Banorët e Bosnjë-Hercegovinës pasqyrojnë të njëjtën tendencë në kontekstet e vetëmbrojtjes, me 64% që mbështesin përdorimin e armëve të zjarrit kur sulmohen. Nga ana tjetër, Maqedonia e Veriut regjistron nivele pranimi nën mesatare. Më konkretisht, vetëm 40 për qind

mbështesin përdorimin e armëve për vetëmbrojtje, qoftë në rastin e rreziqeve reale apo të perceptuara, dhe vetëm 13 për qind mbështesin përdorimin në të shtënat festive. Të dhënat sugjerojnë se qëndrimet ndaj përdorimit të armëve të zjarrit nuk ndikohen vetëm nga përvoja personale dhe statusi socio-ekonomik, por edhe nga konteksti juridiksional dhe normat mbizotëruese kulturore.

*Figura 13.*
**Sa është përqindja e banorëve në juridiksionin tuaj që zotërojnë armë zjarri (të ligjshme apo të paligjshme)**
**(n = 6819)**




Perceptimet mbi zotërimin e armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor luhaten ndjeshëm, edhe pse shumica e banorëve besojnë se është relativisht i përhapur. Rreth 61 për qind e të anketuarve në rajon vlerësojnë se niveli i bashkëkombësve të tyre që zotërojnë armë zjarri shkon deri në 50 për qind (shihni figurën 13).[28] Megjithatë, një pakicë e konsiderueshme kanë një perceptim edhe më të lartë lidhur me zotërimin. 23 për qind mendojnë se niveli i zotërimit është midis 50 për qind apo më lart. Në përgjithësi, burrat janë më konservatorë në perceptimet e tyre, krahasuar me gratë. Më konkretisht, 68 për qind e burrave, krahasuar me 59 përqind të grave, mendojnë se niveli i zotërimit është

28 Rreth 28 për qind e të anketuarve sugjerojnë një nivel midis 1 dhe 25 për qind, ndërsa 35 për qind e tyre besojnë se niveli shtrihet midis 25 dhe 50 për qind.

nën 50 për qind. Megjithatë, të dyja gjinitë kanë pikëpamje të njëjta lidhur me nivelet më të larta të zotërimit, ndërkohë që numri i grave që përgjigjen "nuk e di" është dy herë më i lartë se sa i burrave.

Personat me përvojë të drejtpërdrejtë lidhur me armët e zjarrit, qoftë përmes mbajtjes së tyre, ekspozimit ndaj incidenteve me armë zjarri apo dhunës, vlerësojnë nivele më të larta të zotërimit të armëve krahasuar me mesataren rajonale dhe të anketuarit e tjerë me më pak përvojë. Për shembull, një e treta (33 për qind) e personave të ekspozuar ndaj armëve të zjarrit në kontekste të dhunshme dhe 26-29 për qind e atyre me përvojë të përgjithshme ose që kanë mbajtur armë zjarri, besojnë se më tepër se gjysma e personave janë të armatosur. Ky perceptim pasqyrohet nga pronarët aktualë dhe potencialë të armëve. Më konkretisht, 32 për qind prej tyre besojnë se zotërimi në juridiksionin e tyre e kalon pragun prej 50 për qind. Në nivel juridiksioni, Mali i Zi (33 për qind), Bosnjë-Hercegovina (32 për qind) dhe Maqedonia e Veriut (25 për qind) dallohen për perceptimet për nivel zotërimi mbi mesatar, ndërsa të anketuarit në Serbi (16 për qind), Kosovë (14 për qind) dhe Shqipëri (13 për qind) raportojnë nivele shumë më të ulëta, çka thekson dallimet rajonale në pikëpamjet mbi zotërimin dhe përhapjen e armëve të zjarrit (shihni figurën 13).

*Figura 14.*
**Pa përfshirë personat që zotërojnë, mbajnë, apo përdorin armë zjarri në kuadër të detyrës (policia, ushtria, shoqëritë private të sigurisë), a njihni personalisht dikë që zotëron apo përdor armë zjarri?**
**(n = 6819,** Kjo shifër përjashton përgjigjet „Nuk e di/Refuzoj")




Përvoja me armët e zjarrit nuk është aspak abstrakte në Ballkanin Perëndimor dhe përbën një realitet për shumë banorë. Mbi një e treta e banorëve në Ballkanin Perëndimor (36 për qind) njohin dikë që përdor armë zjarri, me përjashtim të nëpunësve të policisë,

ushtrisë apo shoqërive private të sigurisë (shihni figurën 14). Burrat kanë shumë më tepër gjasa, krahasuar me gratë, që të raportojnë se njohin dikë që zotëron apo përdor armë zjarri, përkatësisht 48 për qind krahasuar me 27 për qind. Për më tepër, banorët me të ardhura mbi mesatare (46 për qind), me nivel më të lartë arsimor (42 për qind) dhe ata që jetojnë në zonat rurale (40 për qind) raportuan një nivel më të lartë të njohjes së përdoruesve të armëve të zjarrit. Siç parashikohej, personat me përvojë personale, si p.sh. ata që kanë mbajtur armë zjarri (61 për qind), janë përballur me armët e zjarrit në situata të caktuara (70 për qind), apo kanë përjetuar dhunë me armë zjarri (68 për qind), kanë më shumë gjasa që të njohin përdorues të armëve të zjarrit. Kjo shifër rritet në 84 për qind në rastin e zotëruesve të armëve dhe 65 për qind në rastin e personave që dëshirojnë të zotërojnë armë. Dallimet në nivel juridiksioni janë të konsiderueshme: Mali i Zi (49 për qind) dhe Serbia (46 për qind) tejkalojnë mesataren rajonale, ndërsa Kosova (26 për qind) dhe Shqipëria (22 për qind) raportojnë nivele familjariteti shumë më të ulëta.

Ndërkohë, rreth 35 për qind e të anketuarve në Ballkanin Perëndimor raportojnë se kanë mbajtur një armë zjarri, 9 për qind vetëm një herë dhe 25 për qind në disa raste. Përvoja me armët ka natyrë thellësisht gjinore: shumica e burrave (56 përqind) kanë përvojë me armët, krahasuar me vetëm 15 për qind të grave. Brezat më të rinj kanë një nivel shumë më të ulët të familjaritetit me armët e zjarrit. Vetëm 24 për qind e personave të grupmoshës 18-30 dhe 28 për qind të grupmoshës 31-40 raportojnë përvojë në mbajtjen e armëve. Grupmoshat më të mëdha, duke përfshirë 44 për qind të personave 51-60 vjeç dhe 42 për qind të atyre mbi 60 vjeç, kanë më shumë gjasa që të kenë përvojë. Mbajtja e armëve të zjarrit është pothuajse universale ndër personat e ekspozuar ndaj armëve të zjarrit përmes situatave të përgjithshme apo të dhunshme: Përkatësisht, 91 për qind dhe 87 për qind prej tyre kanë mbajtur një armë, shumica prej të cilëve në mënyrë të vazhdueshme. Dy të tretat e pronarëve potencialë të armëve të zjarrit raportojnë gjithashtu se kanë mbajtur më parë armë në duar. Në nivel juridiksioni, përvoja me armët e zjarrit është më e zakonshme në Mal të Zi (30 për qind kanë mbajtur disa herë armë), Serbi (31 për qind kanë mbajtur disa herë armë) dhe Bosnjë-Hercegovinë (30 për qind kanë mbajtur disa herë armë), ndërsa në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, 73 për qind e të anketuarve pretendojnë se nuk kanë mbajtur kurrë një armë zjarri në duar.

Përvojat e lidhura me armët e zjarrit në Ballkanin Perëndimor shtrihen në një gamë të gjerë kontekstesh. Më konkretisht, përdorimi në të shtënat festive (7 për qind) dhe për qëllime të paspecifikuara (7 për qind) janë në krye të listës së llojeve të përvojave të raportuara nga të anketuarit (shihni figurën 15a). Më shqetësues është fakti se një pakicë e konsiderueshme raportojnë ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj dhunës: 4 për qind kanë qenë dëshmitarë të një incidenti me armë zjarri, 4 për qind kanë raportuar se u është drejtuar arma dhe 3 për qind kanë përdorur një armë zjarri për vetëmbrojtje. Ndër individët që kanë raportuar përvojë në të paktën një nga skenarët, rreth një e treta (35 për qind) kanë cituar përdorimin e armëve të zjarrit gjatë të shtënave festive dhe po aq për qëllime të paspecifikuara (33 për qind) (shihni figurën 15b). Një numër i konsiderueshëm i kësaj nënkategorie kanë raportuar gjithashtu se kanë qenë dëshmitarë të një incidenti

me armë zjarri (19 për qind), se u është drejtuar arma (18 për qind) ose se kanë përdorur armë për vetëmbrojtje (13 për qind). Burrat kanë shumë më tepër gjasa se sa gratë që të raportojnë përvoja me armët e zjarrit (34 për qind krahasuar me vetëm 7 për qind). Për më tepër, probabiliteti i këtyre përvojave rritet gradualisht me moshën, nga 15 për qind te personat e grupmoshës 18-30 në 25 për qind te personat mbi 51 vjeç. Gjithashtu, individët më të pasur raportojnë më tepër përvoja të lidhura me armët e zjarrit: 24 për qind e personave me status financiar mbi mesatar, krahasuar me 14 për qind të atyre me nivel më të ulët financiar.

*Figura 15a.*
**A keni pasur përvoja personale me të paktën një situatë që përfshin armë zjarri?**
**(n = 6819)**




*Figura 15b.*
**A keni pasur përvoja personale me të paktën një situatë që përfshin armë zjarri?**
**(n = 1308** bazuar në numrin e personave që kanë përvojë me të paktën një situatë që përfshin armë zjarri)



Personat e prirur për të zotëruar armë zjarri kanë më shumë gjasa se mesatarja që të raportojnë lloje të caktuara të kontaktit me armët e zjarrit, ku përfshihen përdorimi në të shtënat festive (21 për qind), përdorimi për qëllime të paspecifikuara (10 për qind), u është drejtuar arma (6 për qind) dhe anëtarësimi në klube të qitjes (4 për qind). Në total, 32 për qind e kësaj kategorie kanë përjetuar të paktën një skenar. Shifrat rriten ndjeshëm kur bëhet fjalë për grupin e vogël të individëve që janë ekspozuar ndaj armëve të zjarrit në kontekste të dhunshme: 55 për qind të tyre u është drejtuar arma, 47 për qind kanë qenë dëshmitarë të incidenteve me armë zjarri dhe 39 për qind kanë përdorur një armë zjarri për vetëmbrojtje. Dallimet në nivel juridiksioni janë të theksuara: Bosnjë-Hercegovina (26 për qind) dhe Mali i Zi (23 për qind) raportojnë nivele përvoje shumë më të larta se mesatarja, ndërsa Maqedonia e Veriut dhe Kosovë kanë nivele më të ulëta (shihni figurën 16).[29]

*Figura 16.*
**Përqindja e banorëve që kanë përjetuar të paktën një nga dhjetë skenarët që përfshijnë përdorimin e armëve**
**(n = 6819)**




Ndër banorët në Ballkanin Perëndimor me një lloj përvoje me armët e zjarrit, një pjesë e vogël, por e konsiderueshme, prej 11 për qind, raportuan përfshirje në një nga katër skenarët kyçë: kanë qenë dëshmitarë të një incidenti me armë zjarri, u është drejtuar

29 Krahasuar me mesataren rajonale, të anketuarit në Mal të Zi raportojnë më shpesh përvoja jo të dhunshme me armët e zjarrit, si përdorim në të shtënat festive, gjueti, trashëgim të armëve dhe anëtarësim në klubet e qitjes, ndërsa të anketuarit në Bosnjë-Hercegovinë raportojnë ekspozim më të lartë ndaj konteksteve të dhunshme, ku përfshihen të qenit dëshmitar të incidenteve, janë kërcënuar me armë zjarri dhe i kanë përdorur për vetëmbrojtje.

një armë, kanë përdorur një armë zjarri për vetëmbrojtje, ose kanë përdorur armë për qëllime të paspecifikuara. Kur iu kërkua të shtjellonin këto përvoja, më tepër se gjysma (52 për qind) raportuan se kanë përjetuar të paktën një nga dhjetë situatat e specifikuara të lidhura me dhunën me armë, të paraqitura në figurat 15a dhe 15b më sipër. Pothuajse gjysma (44 për qind) përmendën kontekstet jo të dhunshme si gjuetia apo trajnimi, pavarësisht se shprehimisht ishin paraqitur vetëm opsionet e dhunshme. Kjo divergjencë nxjerr në pah ndërthurjen e vazhdueshme të aspekteve kulturore në përdorimin e armëve të zjarrit në kontekste jo të dhunshme në rajon, si dhe nënraportimin e dhunës në rastet kur pyetjet strukturohen në mënyrë të ngushtë.[30]

Dinamikat e lidhura me gjininë dhe moshën ndikojnë më tej në shpërndarjen e këtyre përvojave. Burrat kishin shumë më tepër gjasa se gratë që të raportonin përvoja të dhunshme me armë zjarri (56 për qind kundrejt 44 përqind), ndërsa gratë ishin më të prirura që të citonin skenarët jo të dhunshëm (51 për qind kundrejt 41 për qind). Trashëgimia e konflikteve rajonale vazhdon të përbëjë kërcënim: "konflikti i armatosur apo lufta" janë konteksti i dhunshëm i përmendur më shpesh, përkatësisht nga dy të tretat (66 për qind) e personave me përvojë në këto kontekste, dhe kjo shifër është më e lartë me rritjen e moshës.[31] Dallimet gjinore shfaqen gjithashtu edhe në natyrën e përvojave: burrat kishin më tepër gjasa se gratë që të citonin ekspozimin gjatë kohës së luftës (44 për qind krahasuar me 10 për qind), ndërsa gratë përmendnin më shpesh incidentet si sulmet rastësore, grabitjet me armë dhe ushtrimet e trajnimit në shkollë (25 për qind e grave përmendën këtë të fundit, krahasuar me vetëm 1 për qind të burrave). Këto gjetje nënvizojnë ndikimin që ka kujtesa ndër breza dhe dallimet gjinore të ekspozimit, në mënyrën se si përjetohen dhe rikujtohen përvojat e lidhura me armët e zjarrit.

Në Bosnjë-Hercegovinë, përvojat me armët e zjarrit ndikohen thellësisht nga trashëgimia e luftës. Përkatësisht, 65 për qind e personave që raportuan përvoja të dhunshme cituan konfliktet e armatosura, një shifër kjo shumë më e lartë se mesatarja rajonale. Një grup tjetër prej 6 për qind theksuan ekspozimin ndaj dhunës me bazë etnike. Nga ana tjetër, në Maqedoninë e Veriut, përvojat me armët e zjarrit lidhen kryesisht me kontekstet jo të dhunshme, në veçanti me trajnimin ushtarak (38 për qind) dhe me ushtrimet e mbrojtjes civile në shkollë nga periudha e ish-Jugosllavisë, të cituara nga 12 për qind. Praktikat e mbrojtjes civile u shfaqen gjithashtu edhe në Serbi (11 për qind), çka nxjerr në pah rrënjët e edukimit ushtarak ndër breza. Megjithatë, në Shqipëri, përvojat më të shpeshta të lidhura me armët e zjarrit ishin sulmet rastësore ose të shtënat aksidentale, të cilat u raportuan nga 12 për qind e të anketuarve.

Nga 11 për qind e banorëve të Ballkanit Perëndimor që raportuan përvoja me armët e zjarrit në kontekste të dhunshme apo të paspecifikuara, dy të tretat e tyre (66 për qind) u shprehën se përvoja e fundit ka ndodhur mbi pesëmbëdhjetë vite më parë. Incidentet

**30** Bazuar në shifrën prej 11 për qind të të anketuarve në Ballkanin Perëndimor që iu përgjigjën kësaj pyetje, rezulton se vetëm 5 për qind e popullsisë së rajonit raportuan ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj armëve të zjarrit në një kontekst të dhunshëm.

**31** Më specifikisht, më pak se 5 për qind e personave nën moshën 40 vjeç e cituan këtë përvojë, krahasuar me personat mbi 50 vjeç, ndër të cilët pothuajse gjysma e përmendën.

më të vonshme janë më të rralla. 12 për qind brenda vitit të fundit, 11 për qind në 1-5 vitet e fundit dhe 9 për qind në 6-15 vitet e fundit. Burrat kanë shumë më tepër gjasa se gratë që të raportojnë përvoja të kohëve të fundit (13 për qind e burrave dhe 6 për qind e grave kanë pasur përvoja të lidhura me armët e zjarrit gjatë vitit të fundit), megjithatë shumica e të anketuarve nga të dyja gjinitë janë shprehur se përvoja e fundit ka qenë më tepër se një dekadë më parë. Në veçanti, individët me përvoja të dhunshme të lidhura me armët e zjarrit kanë më pak gjasa se mesatarja që të raportojnë përvoja të kohëve të fundit (vetëm 7 për qind kanë cituar incidente në vitin e fundit). Përjashtim përbën Mali i Zi: vetëm 40 për qind e të anketuarve janë shprehur se përvoja e fundit e lidhur me armët e zjarrit ka qenë mbi pesëmbëdhjetë vite më parë, ndërsa 21 për qind kanë raportuar përvoja brenda dymbëdhjetë muajve të fundit, çka sugjeron një marrëdhënie më të ngushtë dhe aktive me armët e zjarrit krahasuar me juridiksionet e tjera.

*Figura 17.*
**Kush i ka kryer aktet më të fundit të dhunës me armë?**
**(n = 654** i referohet vetëm pjesës prej 11 për qind të të anketuarve që kanë cituar përvoja me armët e zjarrit të përdorura në kontekste të dhunshme apo për qëllime të tjera)




Nga 11 për qind e banorëve të Ballkanit Perëndimor që raportuan përvoja të lidhura me armët e zjarrit, qoftë në kontekste të dhunshme ose jo, policia ose ushtria u përmenden më shpesh si aktorët kryesorë të përvojës më të fundit të të anketuarve, më konkretisht nga 29 për qind e të anketuarve (shihni figurën 17). Grabitësit ose kriminelët e dyshuar zinin vendin e dytë me 11 për qind, pasuar nga miqtë, të njohurit apo fqinjët me 10 për qind. Çuditërisht, 22 për qind e të anketuarve pretenduan se nuk ka pasur dhunë dhe rrjedhimisht nuk ka pasur një autor. Aspektet gjinore dhe moshore ndikojnë te perceptimet: 36 për qind e burrave, dhe vetëm 9 për qind e grave, përmendën personelin ushtarak ose të agjencive ligjzbatuese. Ndërkohë, gratë kanë dyfish më tepër gjasa se

burrat (përkatësisht 16 dhe 8 për qind) që të përmendin dikë nga rrethi i tyre social.[32] Këto tendenca janë më të theksuara te personat që deklaruan se kanë pasur përvojë të drejtpërdrejtë në kontekste të dhunshme të lidhura me armët e zjarrit. Pothuajse gjysma (47 për qind) cituan policinë ose ushtrinë, 18 për qind ua vënë fajin kriminelëve dhe 14 për qind përmendën të njohurit.

Modelet variojnë gjithashtu edhe sipas juridiksionit. Në Bosnjë-Hercegovinë, 48 për qind përmendin subjektet publike, shifër kjo ndjeshëm më e lartë se mesatarja rajonale, ndërsa në Shqipëri, pjesa më e madhe e të anketuarve fajësojnë kriminelët e dyshuar (26 për qind) dhe vetëm 8 për qind përmendin personelin ligjzbatues. Në Maqedoninë e Veriut, shifrat për të dyja këto kategori janë të ulëta (përkatësisht 13 për qind dhe 5 për qind), por një pjesë e konsiderueshme prej 52 për qind janë shprehur se nuk ka pasur dhunë, ndërkohë që në Serbi kjo shifër është ndjeshëm më e ulët (36 për qind). Nga ana tjetër, Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova raportojnë një nivel shumë më të ulët të skenarëve jo të dhunshëm, përkatësisht 7 për qind, 10 për qind dhe 10 për qind, duke paraqitur pretendime të ngjashme. Këto diferenca pasqyrojnë se si dallimet në historinë e vendit, institucionet dhe rrjetet personale, ndikojnë te përvojat e publikut me armët e zjarrit në rajon.

*Figura 18.*
**A do të mbanit një armë zjarri?**
**(n = 6819)**




32 Të anketuarit në moshë më të madhe, në veçanti ata mbi 51 vjeç, kanë shumë më tepër gjasa të përmendin aktorët institucionalë (39 për qind), ndërsa në rastin e grupmoshës 18-40 vjeç, kjo shifër është vetëm 5 për qind.

Një shumicë e konsiderueshme e banorëve në Ballkanin Perëndimor nuk kanë interes për të zotëruar armë zjarri. Mbi 78 për qind pretendojnë se nuk dëshirojnë një armë zjarri, 7 për qind shprehën dëshirën për të pasur një armë zjarri dhe 8 për qind janë të pavendosur (shihni figurën 18). 8 për qind e popullsisë kanë raportuar se zotërojnë armë zjarri, prej të cilëve 4 për qind i kanë trashëguar armët, 1 për qind i mbajnë në kuadër të funksionit të tyre zyrtar, 0,3 për qind u identifikuan si koleksionistë dhe pjesa tjetër prej 3 për qind cituan "arsye të tjera". Ashtu siç konfirmohet dhe nga gjetjet në literaturë, burrat kanë shumë më tepër gjasa se gratë që të shfaqin interes për zotërimin e armëve, përkatësisht 10 për qind kundrejt 3 për qind. Mosha është gjithashtu një faktor i qartë përcaktues: 10 për qind e personave të grupmoshës 18-30 shprehin interes, por kjo shifër bie në mënyrë të qëndrueshme dhe arrin deri në 2 për qind te personat mbi 60 vjeç.

Dallimet demografike paraqesin nuanca të rëndësishme për modelet e zotërimit dhe interesit mbi armët e zjarrit. Dëshira për të zotëruar armë zjarri bie në mënyrë të qëndrueshme me kalimin e moshës. Më konkretisht, interes për armët fillon në nivelin 10 për qind te personat e grupmoshës 18 deri në 30 vjeç, bie lehtësisht në 9 për qind te personat e grupmoshës 31 deri në 40 vjeç, dhe vijon të ulet më tej në 7% për grupmoshën 41-50 dhe 5 për qind për grupmoshën 51-60, dhe arrin në vetëm 2 për qind tek individët e grupmoshës 61 vjeç e lart. Kjo tendencë nënvizon një ndasi midis brezave. Përkatësisht, të rinjtë, veçanërisht ata të grupmoshës 18-40 vjeç, shfaqin interes shumë më të lartë për të zotëruar armë zjarri krahasuar me personat e grupmoshës 51 vjeç e lart. Këto gjetje sugjerojnë se perceptimet mbi armët e zjarrit dhe arsyet për zotërimin e tyre mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, çka thekson nevojën për politika dhe ndërhyrje që marrin në konsideratë dallimet moshore në qëndrimet ndaj armëve.

Ekzistojnë dallime të lehta në dëshirën për të zotëruar armë zjarri sipas juridiksioneve. Me përjashtim të Malit të Zi (69 për qind), mbi tre të katërtat e të anketuarve nga Shqipëria (82 për qind), Bosnjë-Hercegovina (75 për qind), Kosova (81 për qind), Maqedonia e Veriut (79 për qind) dhe Serbia (79 për qind) pretendojnë se nuk dëshirojnë të zotërojnë armë zjarri. Vetëm 5 për qind e banorëve në Serbi shprehen se dëshirojnë të zotërojnë një armë zjarri, ndërsa mesatarja në juridiksionet e tjera luhatet ndërmjet 6-8 për qind. Mali i Zi ka një përqindje mbi mesataren (9 për qind) dhe arsyet e raportuara për zotërimin e armëve të zjarrit lidhen me trashëgiminë, koleksionimin ose rolet profesionale. Këto modele pasqyrojnë mënyrën se si ndërthuren faktorët kulturorë, institucionalë dhe ndërmjet brezave duke formësuar qëndrimet në rajon.

*Figura 19.*

**Nëse dikush në familjen tuaj, ose një mik i ngushtë, do t'ju thoshte se po mendon të marrë armë zjarri, si do të reagonit?**
**(n = 6819)**




Kur u pyetën se si do të reagonin nëse një anëtar i familjes apo mik i ngushtë do të mendonte të merrte një armë zjarri, shumica e banorëve në Ballkanin Perëndimor (60 për qind) u shprehën se do e kundërshtonin këtë ide, 16 për qind do e mbështesnin dhe 25 për qind ishin të pavendosur apo indiferentë (shihni figurën 19). Interesant është fakti se në këtë rast qëndrimet janë më tolerantë se sa qëndrimet ndaj zotërimet personal të armëve: 78 për qind shprehen se nuk dëshirojnë personalisht që të zotërojnë armë zjarri, megjithatë një përqindje e lartë (16 për qind) do e mbështesnin dikë të afërt që të mbante armë zjarri. Ky dallim flet për ekzistencën e një niveli të fleksibilitetit social ose respekti për zgjedhjet personale, edhe nga personat që në përgjithësi janë kundër armëve të zjarrit.

Mbështetja për anëtarët e familjes ose miqtë që të marrin armë zjarri rritet ndjeshëm te personat me përvoja të drejtpërdrejta lidhur me armët e zjarrit. 75 për qind e personave që dëshirojnë të zotërojnë armë dhe 56 për qind e zotëruesve aktualë do e inkurajonin një mik apo të afërm që të bënte të njëjtën gjë. Përvoja është një faktor i rëndësishëm: 27 për qind e personave që kanë mbajtur armë zjarri, 34 për qind e personave që janë përballur me situata të lidhura me armët e zjarrit dhe 24 për qind e personave që janë ekspozuar ndaj konteksteve të dhunshme do ofronin mbështetje. Burrat janë dyfish më mbështetës se gratë (22 për qind krahasuar me 10 për qind) dhe niveli i mbështetjes

është më i lartë te burrat e grupmoshave 18-30 dhe 31-40 vjeç.[33] U identifikuan gjithashtu edhe dallime gjeografike: në Shqipëri, 76 për qind e kundërshtuan zotërimin e armëve të zjarrit nga personat e afërt, një shifër kjo ndjeshëm më e lartë se mesatarja rajonale, ndërsa Mali i Zi ka tendenca më pranuese, me përkatësisht 49 për qind kundër dhe 23 për qind në favor.

*Figura 20.*
**Cila është arsyeja kryesore se pse zotëroni apo do të dëshironit të zotëronit një armë zjarri**
**(n = 615** bazohet në 9 për qind të të anketuarve që deklarojnë se do të dëshironin të zotëronin apo zotërojnë aktualisht një armë zjarri për arsye të tjera krahas koleksionimit të armëve, trashëgimit të tyre ose mbajtjes së armëve në kuadër të funksionit zyrtar)




Ndër 9 për qind të të anketuarve në Ballkanin Perëndimor që deklaruan se zotërojnë apo dëshirojnë të zotërojnë armë zjarri, rekreacioni shfaqet si arsyeja kryesore (shihni figurën 20).[34] Pothuajse gjysma (46 për qind) citojnë gjuetinë ose qitjen sportive, pasuar nga shqetësimet mbi sigurinë (26 për qind). Një përqindje më e ulët e popullsisë (12 për qind) përmend vazhdimin e traditave familjare ose ekspozimin personal ndaj dhunës (7 për qind) si arsye e lidhur me dëshirën e tyre për mbrojtje. Dallimi ndërmjet personave që zotërojnë armë zjarri dhe atyre që aspirojnë të zotërojnë armë zjarri është i konsiderueshëm: Rekreacioni përmendet si arsye më tepër nga pronarët aktualë se sa nga personat që aspirojnë të zotërojnë armë zjarri (61 për qind krahasuar me 41 për qind), ndërsa mbrojtja dhe siguria përmendet si arsye më tepër nga personat që aspirojnë të zotërojnë armë (32 për qind krahasuar me 10 për qind). Dallimet gjinore janë

**33** Mbështetja është dukshëm më e lartë nga individët më të rinj të grupmoshës 18 deri në 40 vjeç (18 për qind për grupmoshën 18-30 dhe 19 për qind për grupmoshën 31-40) krahasuar me ata të grupmoshës 51 vjeç e lart (14 për qind për grupmoshën 51-60 dhe 12 për qind për personat mbi 61 vjeç).

**34** Kjo shifër përjashton koleksionistët e armëve të zjarrit, personat që i kanë trashëguar armët dhe nëpunësit e autorizuar për të mbajtur armë.

më të theksuara në dhënien e arsyeve për përdorimin e armëve të zjarrit. Burrat kanë më shumë gjasa se gratë që të përmendin rekreacionin (51 për qind krahasuar me 47 për qind), ndërsa gratë e vënë shumë më tepër theksin te siguria (përkatësisht 47 për qind e grave kanë identifikuar sigurinë si shqetësimin e tyre kryesor krahasuar me vetëm 21 për qind të burrave).

*Figura 21.*
**Cila është arsyeja kryesore se pse zotëroni apo do të dëshironit të zotëronit një armë zjarri, sipas juridiksionit**
(**n = 615** bazohet në 9 për qind të të anketuarve që deklarojnë se do të dëshironin të zotëronin apo zotërojnë aktualisht një armë zjarri për arsye të tjera krahas koleksionimit të armëve, trashëgimit të tyre ose mbajtjes së armëve në kuadër të funksionit zyrtar. Kjo shifër përjashton përgjigjet "Nuk e di/Refuzoj")




Arsyet për zotërimin apo dëshirën për të zotëruar armë zjarri variojnë edhe sipas juridiksionit (shihni figurën 21). Më specifikisht, banorët në Shqipëri kanë më tepër gjasa se mesatarja që të përmendin mungesën e sigurisë (37 për qind) dhe rekreacionin (55 për qind), ata në Bosnjë-Hercegovinë nënvizojnë mbrojtjen e vetes dhe të familjes (19 për qind) dhe mungesën e sigurisë (36 për qind). Në Kosovë, fokusi është më tepër te rekreacioni (50 për qind) ndërsa në Mal të Zi vëmendja kryesore është tek tradita (31 për qind) dhe rekreacioni (48 për qind). Në Maqedoninë e Veriut, perceptimi për mungesën e sigurisë (34 për qind) dhe rekreacioni (33 për qind) vazhdojnë të kenë peshë të lartë, njësoj si në Serbi (përkatësisht 31 dhe 43 për qind). Këto shifra sugjerojnë se preferencat për armët e zjarrit në rajon pasqyrojnë jo vetëm përvojat individuale dhe normat gjinore, por edhe narrativat më të gjera kulturore dhe kombëtare.

Gjithashtu, shfaqet një lidhje e qartë ndërmjet dëshirës për të zotëruar armë zjarri

dhe ekspozimit të mëparshëm ndaj armëve të zjarrit. Personat që shprehin interes për zotërimin e armëve jo vetëm që kanë më shumë gjasa të kenë mbajtur armë zjarri (65 për qind), por edhe të jenë përballur me armët e zjarrit në situata të dhunshme, shpeshherë në periudha të kohëve më të fundit krahasuar me popullsinë e gjerë. Nga ana tjetër, vetëm 27 për qind e individëve që nuk kanë interes për zotërimin e armëve të zjarrit kanë raportuar përvoja të ngjashme. Personat e pavendosur shfaqin gjithashtu përvojë mbi mesatare në mbajtjen e armëve (41 për qind). Megjithatë, ekspozimi i tyre ndaj dhunës dhe përdorimit të armëve të zjarrit gjatë kohëve të fundit është më pranë normave rajonale. Për sa i përket qëndrimeve të tyre, pronarët aktualë dhe aspirues kanë qëndrime më të favorshme ndaj përdorimit dhe zotërimit të armëve se sa popullsia e gjerë. Megjithatë, personat e pavendosur shfaqin nivele mbështetje disi më të ulëta, çka sugjeron se familjariteti me armët e zjarrit luan një rol të rëndësishëm në formësimin e preferencave dhe të perceptimeve.

Në përgjithësi, është e pritshme që individët që dëshirojnë të zotërojnë armë zjarri të kenë qëndrime më pozitive ndaj armëve të zjarrit dhe më shumë përvoja më to. Një mënyrë për të testuar këtë hipotezë është duke analizuar statistikisht pesë faktorë themelorë: përvoja e mëparshme me mbajtjen e armëve të zjarrit, përvoja me armët e zjarrit në kontekste të dhunshme, qëndrimet mbështetëse ndaj zotërimit të armëve, pranimi i përdorimit të armëve të zjarrit në situata të ndryshme dhe pikëpamjet rreth ndikimit të aksesit universal të armëve në nivelet e krimit. Analiza klasifikuese tregon se variablat parashikues me lidhjet më të forta statistikore me kërkesën për armë zjarri janë qëndrimi pozitiv ndaj zotërimit të armëve të zjarrit, përvoja e mëparshme me mbajtjen e armëve të zjarrit dhe pranimi i përdorimit të armëve të zjarrit në skenarë të caktuar. Lidhje më pak të forta janë identifikuar në lidhje me efektet e perceptuara të disponueshmërisë universale dhe përvojës me armët e zjarrit në kontekste të dhunshme (shihni shtojcën 3).

*Figura 22.*
**Si do e vlerësonit procedurën e ligjshme për blerjen e një arme zjarri në juridiksionin tuaj?**
**(n = 6819)**



Pothuajse gjysma e banorëve të Ballkanit Perëndimor shprehen se nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi procedurën ligjore të blerjes së një arme zjarri në juridiksionin e tyre. Nga ana tjetër, 30 për qind e të anketuarve e përshkruajnë procesin si "të ndërlikuar" dhe vetëm 15 për qind e konsiderojnë "të thjeshtë" (shihni figurën 22). Pabarazitë gjinore janë të theksuara: 60 për qind e grave, krahasuar me 38 për qind të burrave, ndihen të painformuar, dhe vetëm 11 për qind e grave, krahasuar me 19 për qind të burrave, e konsiderojnë procedurën si të thjeshtë. Mes burrave, 39 për qind e shohin procesin si të ndërlikuar, duke nënvizuar më tepër hendekun në nivelin e njohurive dhe të aksesueshmërisë së perceptuar. Në përgjithësi, personat që shprehin një dëshirë për të zotëruar armë zjarri janë më të informuar: vetëm 27 për qind prej tyre ndihen të painformuar, megjithatë shumica (52 për qind) vazhdojnë ta karakterizojnë procesin si të ndërlikuar.

Niveli i njohurive mbi procedurat e lidhura me armët e zjarrit varion edhe mes juridiksioneve. Në Shqipëri, Serbi, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë, pothuajse gjysma e të anketuarve pranojnë se kanë mangësi në informacionin rreth procedurave të blerjes së armëve të zjarrit, ndërsa në Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut kjo shifër bie në rreth 40 për qind. Perceptimet mbi kompleksitetin janë gjithashtu të ndryshme: 20 për qind e të anketuarve në Kosovë dhe 25 për qind e të anketuarve në Bosnjë-Hercegovinë e konsiderojnë procesin të vështirë, një shifër kjo më e ulët se mesatarja rajonale (30 për qind), ndërsa të anketuarit në Malin e Zi bien në sy për nivelin relativisht të lartë të njohurive (23 për qind e konsiderojnë procedurën të thjeshtë). Nga ana tjetër, vetëm 10 për qind e të anketuarve në Shqipëri dhe në Serbi e gjykojnë procesin të thjeshtë, çka nënvizon një model më të gjerë të paqartësisë rregullatore dhe njohurive publike të pabarabarta në rajon.

*Figura 23.*
**Në opinionin tuaj, sa të aksesueshme janë armët e zjarrit të paligjshme në juridiksionin tuaj?**
**(n = 6819)**

| | Armët e zjarrit të paligjshme nuk janë gjerësisht të aksesueshme | Armët e zjarrit të paligjshme janë disi të aksesueshme | Armët e zjarrit të paligjshme janë lehtësisht të aksesueshme | Nuk e di/Refuzoj të përgjigjem |
|---|---|---|---|---|
| **Mesatarja rajonale** | 16 | 37 | 23 | 25 |
| Shqipëria | 19 | 30 | 29 | 22 |
| Bosnjë-Hercegovina | 11 | 39 | 31 | 19 |
| Kosova | 15 | 30 | 17 | 38 |
| Mali i Zi | 19 | 38 | 22 | 21 |
| Maqedonia e Veriut | 13 | 39 | 23 | 25 |
| Serbia | 18 | 43 | 16 | 23 |

Perceptimet mbi aksesueshmërinë e armëve të zjarrit të paligjshme janë të ngjashme. Rreth 37 për qind e të anketuarve në Ballkanin Perëndimor besojnë se armët janë disi të aksesueshme dhe 23 për qind i shohin si lehtësisht të aksesueshme (shihni figurën 23). Burrat janë më të prirur se gratë që t'i perceptojnë armët e paligjshme si disi të aksesueshme (42 për qind krahasuar me 34 për qind), ndërkohë që të dyja gjinitë raportojnë pikëpamje të ngjashme kur shprehen se armët e paligjshme janë lehtësisht të aksesueshme (përkatësisht 23 dhe 22 për qind). Familjariteti me armët e zjarrit ka ndikim të fortë te këto perceptime: ndër personat që kanë mbajtur armë zjarri, 43 për qind shprehen se armët e paligjshme janë disi të aksesueshme dhe 29 për qind i konsiderojnë ato lehtësisht të aksesueshme. Këto shifra janë edhe më të larta tek individët e ekspozuar ndaj konteksteve të dhunshme me armë zjarri, ku 41 për qind besojnë se armët e paligjshme janë lehtësisht të aksesueshme dhe 40 për qind i përshkruajnë si disi të aksesueshme.

Në veçanti, perceptimet mbi disponueshmërinë e armëve të paligjshme variojnë ndjeshëm sipas juridiksionit. Banorët në Shqipëri dhe Bosnjë-Hercegovinë, përkatësisht 29 dhe 31 për qind, kanë më shumë gjasa se mesatarja rajonale (23 për qind) që t'i perceptojnë armët e zjarrit të paligjshme si lehtësisht të aksesueshme. Nga ana tjetër, në Serbi, Mal të Zi dhe Kosovë, këtë pikëpamje e kanë më pak se një në pesë të anketuar, çka është në përputhje me perceptimin e gjerë në këto juridiksione se armët e zjarrit nuk janë gjerësisht të përhapura në shoqëri. Në këto juridiksione, rreth 20 për qind e të anketuarve besojnë se armët e paligjshme nuk janë aspak të aksesueshme, ndërsa mesatarja rajonale është 16 për qind. Këto dallime sugjerojnë se dinamikat brenda juridiksioneve, trashëgimia nga konfliktet e së shkuarës dhe zbatimi në nivel vendor, vazhdojnë të ndikojnë te perceptimi i publikut mbi disponueshmërinë e armëve të paligjshme në rajon.

# 5.

# PERSPEKTIVAT E EKSPERTËVE MBI KËRKESËN PËR ARMË ZJARRI

Intervistat cilësore dhe grupet e fokusit japin një panoramë më të shumëllojshme të perceptimit të publikut mbi armët e zjarrit, çka plotëson gjetjet nga anketimi rajonal. Shumë prej mbi 60 të intervistuarit në mbarë Ballkanin Perëndimor e shohin zotërimin e armëve të zjarrit si të lidhur me "vetëmbrojtjen", "traditën" dhe "rekreacionin", aspekte këto të cilat shpeshherë janë të rrënjosura në rolet tradicionale gjinore, si dhe me sigurinë psikologjike. Në fakt, pasiguria në veçanti është shfaqur si një faktor i fuqishëm që nxit zotërimin e armëve të zjarrit dhe dëshirën për të marrë armë në Ballkanin Perëndimor. Ky perceptim është veçanërisht më i theksuar tek të anketuarit që janë pro thjeshtësimit të legjislacionit për armët e zjarrit dhe te disa prej pronarëve aktualë të armëve. Gjithashtu, ky perceptim është gjerësisht i pranishëm te meshkujt që shprehen se kanë një "detyrim" për të zotëruar armë zjarri me qëllimin për të mbrojtur shtëpinë dhe familjen.

Edhe pse ka dallime sipas juridiksioneve, kërcënimet e perceptuara në Ballkanin Perëndimor, në përgjithësi takohen në disa shqetësime të përbashkëta. Këtu përfshihen, frika lidhur me krimin e organizuar, dhuna ndaj personave të tjerë dhe dhuna nga partneri intim, frika nga krimet e të miturve, dhe në Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë, shqetësimet e lidhura me rritjen e numrit të emigrantëve (të cilët konsiderohen si një shqetësim në rritje lidhur me sigurinë).[35] Ndërkohë, disa prej grave citojnë rrezikun nga kërcënimet në ambientet publike dhe familjare dhe shpeshherë, i konceptojnë armët e zjarrit thjesht si mjete për vetëmbrojtje. Ç'është më e rëndësishmja, personat kundër liberalizimit të armëve të zjarri priren të kenë një pikëpamje të ndryshme. Ata gjykojnë se situata e sigurisë në rajon është përmirësuar që nga trazirat e viteve 90' dhe argumentojnë se ruajtja e sigurisë publike është detyrim ligjor i institucioneve dhe jo i individëve. Çuditërisht, një pjesë e pronarëve aktualë të armëve të zjarrit, veçanërisht e gjuetarëve, janë dukshëm kundër idesë se mbajtja e një arme në shtëpi rrit sigurinë. Përkundrazi, ata e vënë theksin te rëndësia e hartimit dhe zbatimit të një legjislacioni të qartë dhe të rreptë për të parandaluar keqpërdorimin.

Lidhja ndërmjet qëndrimeve që përkrahin armët e zjarrit dhe dëshirës për vetëmbrojtje është veçanërisht e pranishme tek individët e intervistuar në Shqipëri, Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë. Kjo lidhje duket veçanërisht e fortë në zonat ku besimi tek institucionet publike përshkruhet si i ulët dhe ku krimi apo prania e grupeve të organizuara duket se është e lidhur me rënien e besimit për mbrojtje nga institucionet publike. Në veçanti, të intervistuarat femra nënvizuan rreziqet me të cilat përballen gratë dhe vajzat në hapësirat publike dhe private, çka sugjeron një nivel të pabarabartë besimi në mbrojtjen institucionale. Megjithatë, një narrativë paralele u shfaq nga të anketuarit e tjerë, të cilët argumentuan se siguria është një detyrë e institucioneve publike dhe se armatosja e civilëve cenon sigurinë publike. Interesant është fakti se disa prej këtyre

35 Edhe pse shumica e personave në rajon janë të hapur ndaj ardhjes së emigrantëve, në veçanti nga jashtë BE-së, shqetësimet rreth sigurisë dhe integrimit të tyre mbeten të përhapura. Sipas SecuriMeter 2024, "31 për qind e shohin emigracionin si një faktor pozitiv për të trajtuar mungesën e numrit të punonjësve, ndërsa 39 për qind shqetësohen për humbjen e vendeve të punës. Shqetësimet e lidhura me aspektet kulturore dhe të sigurisë krijojnë gjithashtu ndasi në opinionin publik pasi 34 për qind e shohin emigracionin si faktor që pasuron diversitetin kulturor, ndërsa 40 për qind u tremben tensioneve sociale."

të intervistuarve u shprehën se situata aktuale e sigurisë është përmirësuar krahasuar me të kaluarën e karakterizuar nga dhuna, çka flet për ekzistencën e një optimizmi të kujdesshëm pavarësisht pasigurisë së vazhdueshme.

## Lidhjet kulturore dhe simbolike me armët e zjarrit

Normat kulturore dhe tradicionale të lidhura me identitetin, trashëgiminë familjare dhe modelet e roleve gjinore u veçuan si faktorë që nxisin kërkesën për armë zjarri. Kur u pyetën mbi arsyet për zotërimin e armëve të zjarri, shumë prej të anketuarve në grupet e fokusit përmendën gjuetinë si "një traditë familjare" ose armët e zjarrit të zotëruara nga babai i tyre apo nga të afërmit e tjerë meshkuj. Intervistat treguan se armët e zjarrit konsiderohen shpesh si pasuri familjare dhe lidhen në përgjithësi me praktikat e gjuetisë të trashëguara ndër breza. Zotërimi dhe përdorimi i armëve të zjarrit u përshkruan gjithashtu si aspekte të lidhura ngushtësisht me burrërinë dhe detyrën e perceptuar të meshkujve për të mbrojtur shtëpinë dhe familjen. Burrat shihen si zotëruesit dhe përdoruesit kryesorë të armëve të zjarrit. Megjithatë, disa pjesëmarrës, duke përfshirë tregtarë të armëve dhe pronarë të poligoneve të qitjes, konstatuan një rritje të interesit të grave për armët e zjarrit.

Armët e zjarrit mbartin gjithashtu një vlerë të brendshme simbolike të lidhur me identitetin kombëtar, rezistencën historike e madje edhe me tensionet në komunitet. Këto lidhje të thella kulturore ishin veçanërisht më të theksuara tek të anketuarit që jetonin në zonat rurale, aty ku të shtënat festive dhe tentativat për të zgjidhur mosmarrëveshje të gjata mes familjeve mund të përfshijnë përdorimin e armëve të zjarrit.[36] Pjesëmarrësit në grupet e fokusit pranuan se këto tradita nxisin kërkesën, si dhe normalizojnë dhe lartësojnë zotërimin e armëve në mënyra që vështirësojnë dhënien e mesazheve lidhur me sigurinë publike. Gjetjet e anketimit, të cilat nënvizonin mbështetjen për mbajtjen e armëve nga burrat dhe kundërshtinë e gjerë për armët lodra për fëmijët, janë në përputhje me këto dinamika kulturore. Për ta përmbledhur, tradita jo vetëm që nxit kërkesën, por gjithashtu, shpeshherë eklipson shqetësimet e brendshme lidhur me rrezikun e tyre.

Për sa i përket qëndrimeve sociale kundrejt zotërimit të armëve të zjarrit, rajoni duket se ka qëndrime të ndara. Nga njëra anë, shumë pjesëmarrës pranuan sfidat e lidhura me blerjen e armëve të zjarrit, duke përfshirë pengesat burokratike, kostot e larta për ruajtjen e sigurt dhe stigmatizimin shoqëror. Disa prej të anketuarve konstatuan se në disa raste pronarët e armëve etiketohen në mënyrë të padrejtë si agresivë apo kriminelë, çka i nxit disa të fshehin armët e ligjshme dhe të paligjshme. Nga njëra anë, shumica e të intervistuarve kundërshtuan rritjen e aksesit dhe përcaktuan se qëndrimi i tyre mbështetet te vlerat paqësore, siguria publike dhe besimi se civilët nuk duhet të armatosen. Këto

**36** Këto gjetje janë konfirmuar gjithashtu nga SEESAC (2021) https://www.seesac.org/f/docs/Armed-Violence/In-Focus-Armed-Violence-Monitor-on-Celebratory-Shootings-in-SEE-in-2021_.pdf.

pikëpamje të kundërta ndërmjet juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor dhe madje edhe brenda vetë juridiksioneve pasqyrojnë tensionet më të gjera sociale ndërmjet sigurisë individuale dhe kolektive, të cilat u identifikuan gjithashtu edhe në anketim.

Sipas të anketuarve në grupin e fokusit, mjedisi i mediave tradicionale dhe dixhitale në Ballkanin Perëndimor luan gjithashtu një rol të tërthortë, por të konsiderueshëm, në formësimin e qëndrimeve të publikut ndaj armëve të zjarrit. Disa persona besojnë se ekzistojnë dy mekanizma kryesorë që udhëheqin këtë marrëdhënie. Së pari, raportimi provokues i incidenteve me armë zjarri, duke përfshirë rastet e vrasjeve në masë, vrasjeve të grave dhe krimit të organizuar. Shpeshherë, mbulimi mediatik nuk përmban thelb, amplifikon frikën dhe në disa raste, lartëson në mënyrë të paqëllimshme përdorimin e armëve të zjarrit. Së dyti, sipas raportimeve, mediat e përhapura, si videot muzikore, serialet televizive, videolojërat dhe filmat lartësojnë modelet tejet maskiliste dhe patriarkale në të cilat armët e zjarrit janë simbole të pushtetit, heroizmit dhe kontrollit. Të intervistuarit në grupin e fokusit besojnë se këto portretizime kontribuojnë në normalizimin e kulturës së armëve, veçanërisht tek audiencat e meshkujve të rinj në moshë.

Media sociale konsiderohet se amplifikon kërkesën për armë zjarri nga meshkujt e rinj në moshë, shumë prej të cilëve kalojnë një kohë të konsiderueshme në mjediset e lojërave online dhe në forumet e bisedave (chat). Platformat e tilla si Instagram, TikTok, YouTube dhe Discord ofrojnë hapësira ku influencuesit dhe përdoruesit postojnë përmbajtje që idealizojnë zotërimin e armëve, shpeshherë pa kontekst apo kritika. Edhe pse është e vështirë të përcaktohet në mënyrë empirike lidhja e drejtpërdrejtë shkak-pasojë ndërmjet ekspozimit në media dhe blerjes së armëve të zjarrit, studimet në mjedise të ngjashme sugjerojnë se ekspozimi i përsëritur ndaj përmbajtjes së dhunshme apo të fokusuar tek armët mund të rrisë indiferencën ndaj dhunës dhe të ndryshojë normat lidhur me zotërimin e armëve (Krahe, Moller, Huesmann, Kirwil, Felber and Berger, 2011). Në Ballkanin Perëndimor, ku trashëgimia e konflikteve të së shkuarës dhe besimi i dobët tek institucionet janë faktorë ekzistues që nxisin kërkesën, forcimi i kulturës së armëve të zjarrit përmes medias mund të shërbejë si një faktor i fuqishëm për rritjen e mëtejshme të kërkesës.

## Debatet e vazhdueshme mbi ligjet shtrënguese për armët e zjarrit

Debatit mbi zotërimin e armëve dhe kuadrin ligjor për armët e zjarrit janë tema që krijojnë ndasi në mendime në Ballkanin Perëndimor. Në disa raste, mbështetësit e zotërimit të armëve të zjarrit përmendin "të drejtën" e vetëmbrojtjes si një arsye themelore, një pikëpamje kjo e cila ndahet si nga burrat po ashtu dhe nga gratë. Megjithatë, gratë në veçanti shprehin më shumë shqetësime mbi sigurinë personale në hapësirat private dhe publike. Arsye të tjera përfshijnë gjuetinë, e cila shpeshherë përshkruhet si traditë e gjatë familjare, si dhe dëshirën për të ruajtur armët e trashëguara si pjesë të trashëgimisë familjare. Në disa raste, tregtarët e armëve, gjuetarët dhe personat e apasionuar pas

qitjes sportive e konsiderojnë zotërimin e armëve të zjarrit si një "të drejtë" individuale. Megjithatë, shumë persona të tjera nga këto kategori nënvizojnë gjithashtu rëndësinë e zotërimit të përgjegjshëm, nivelit të lartë të ndërgjegjësimit nga mbajtësit e armëve dhe kufizimeve të rrepta ligjore, në veçanti lidhur me përdorimin e armëve të zjarrit për vetëmbrojtje.

Pjesëmarrësit në grupin e fokusit nga të gjitha juridiksionet e Ballkanit Perëndimor pranuan rëndësinë e kërkesave aktuale për marrjen e lejeve për armë zjarri, por e vunë theksin te mangësitë në zbatim. Ekzistonte një shqetësim i përhapur mbi mungesën e monitorimit dhe zbatimit pas marrjes së lejes, ku përfshihet mungesa e kontrolleve në terren apo e vlerësimeve të shëndetit mendor. Ekspertët e konsultuar e vunë theksin te sanksionet e papërshtatshme për zotërimin e paligjshëm, rregulloret që lejojnë zotërimin e armëve të zjarrit gjysmëautomatike nga civilet dhe konvertimi i armëve jovdekjeprurëse, si cenueshmëri të rënda, në veçanti në Serbi dhe Mal të Zi.[37] Këto të dhëna përforcojnë gjetjet e anketimit se paqartësitë mbi alternativat ligjore për zotërimin e armëve të zjarrit, gërshetuar me aksesin e perceptuar si të lehtë në armë zjarri të paligjshme, kontribuojnë në një mjedis të rrezikshëm lidhur me armët e zjarrit.

Njësitë Qendrore për Armët e Zjarrit në Ballkanin Perëndimor e vunë theksin te mjedisi rregullator i fragmentuar në rajon. Zyrtarët konfirmuan ekzistencën e kontrolleve të rrepta, megjithatë pranuan se shpeshherë zbatimi është i pabarabartë dhe pengohet nga normat mbizotëruese kulturore, kapacitetet e kufizuara operacionale dhe armët e trashëguara. Shqipëria u veçua për legjislacionin e saj të shëndoshë, edhe pse tregtia e paligjshme (duke përfshirë përmes platformave online) u përshkrua si një sfidë e vazhdueshme. Bosnjë-Hercegovina vazhdon të luftojë tepricën e armëve nga konfliktet e së shkuarës, ndërsa Kosova has vështirësi në kryerjen e kontrolleve rutinë në terren. Mali i Zi dhe Serbia raportojnë sfida të vazhdueshme me armët e zjarrit nga periudha e luftës dhe në kryerjen e vlerësimeve mjekësore për aplikantët për leje për armë zjarri, ndërsa Maqedonia e Veriut ka bërë përpjekje për integrimin e proceseve të miratimit, por has vështirësi si pasojë e nivelit të ulët të ndërgjegjësimit të publikut. Në maj të vitit 2023, pas dy incidenteve tragjike të vrasjeve në masë, Serbia pezulloi përkohësisht dhënien e lejeve të reja për armë zjarri, inicioi një amnisti njëmujore në nivel kombëtar që u mundësonte banorëve të dorëzonin vullnetarisht armët e paligjshme pa u përballur me sanksione, si dhe urdhëroi kryerjen e verifikimeve gjithëpërfshirëse mbi lejet ekzistuese për armët e zjarrit, çka thekson se si ngjarje të brendshme të papritura mund të ndryshojnë prioritetet rregullatore.

---

**37** Armët gjysmëautomatike janë të lejuara sipas ligjit dhe Direktivës së BE-së "Për armët e zjarrit". Shembujt përfshijnë armët e zjarrit të gjata gjysmëautomatike, me pajisje mbushëse dhe fole fishekësh, që së bashku mund të mbajnë më tepër se tre fishekë në rastin e armëve të zjarrit me ndezje anësore dhe më tepër se tre por më pak se dymbëdhjetë fishekë në rastin e armëve të zjarrit me ndezje qendrore; armët e zjarrit të shkurtra gjysmëautomatike (me disa kufizime); armët e zjarrit të gjata gjysmëautomatike; dhe armët e zjarrit të gjata me përsëritje dhe gjysmëautomatike me tytë të pavjaskuar me gjatësi deri në 60 cm. Shihni BE (2021) Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, 115/21 8.

## Arsyet e lidhura me sigurinë, statusin dhe simbolizmin

Diskutimet në grupet e konsultimit për rastet e krizave në Ballkanin Perëndimor identifikuan një grup të përbashkët shqetësimesh nga personat që kundërshtonin thjeshtësimin e procesit të blerjes dhe marrjes së armëve të zjarrit. Ndër shqetësimet më kryesore ishte mundësia që armët e zjarrit të ndikojnë në përshkallëzimin e mosmarrëveshjeve të përditshme në incidente me pasoja vdekjeprurëse. Pjesëmarrësit paralajmëruan se thjesht prania e një arme mund të provokojë agresion, veçanërisht nëse përfshihen edhe elemente si gjaknxehtësia apo konsumimi i alkoolit. U nënvizuan gjithashtu shqetësime lidhur me shëndetin mendor: disa pjesëmarrës argumentuan se depresioni, abuzimi me substancat dhe trauma e patrajtuar, e pranishme në veçanti në shoqëritë pas konflikteve, rrisin tej mase rrezikun e disponueshmërisë së gjerë të armëve të zjarrit. Një tjetër shqetësim i përsëritur ishte cenueshmëria e fëmijëve: praktikat e dobëta të ruajtjes së armëve të zjarrit, në veçanti në familjet ku detyrimet ligjore nuk zbatohen rreptësisht, u konsideruan si një kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj sigurisë së fëmijëve. Pjesëmarrësit përmendën shumë raste të aksidenteve tragjike të lidhura me armët, të cilat e kanë përforcuar më opinionin e publikut në favor të rregulloreve më të kujdesshme.

Megjithatë, personat që mbështesin rritjen e aksesit në armë zjarri dhanë argumentet e tyre të lidhura me nocionet e lirisë personale, traditës kombëtare dhe sigurisë publike. Gjuetia dhe qitja sportive u cituan në mënyrë të përsëritur, si veprimtari rekreative të ligjshme, dhe shpeshherë të trashëguara ndër breza, të cilat kërkojnë akses në pajisje të përshtatshme, duke përfshirë në armë zjarri. Për shumë persona, veçanërisht në komunitetet rurale në Serbi dhe Mal të Zi, armët janë pjesë e trashëgimisë kulturore, dhe trashëgohen nga baballarët dhe gjyshërit. Vetëmbrojtja u identifikua gjithashtu si një arsye e fortë, në veçanti nga gratë që i tremben dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore dhe që besojnë se një armë zjarri ofron të paktën garanci psikologjike, edhe pse jo detyrimisht mbrojtje fizike. Interesant është fakti se pak pjesëmarrës përmendën shprehimisht përdorimin e një arme në një situatë kërcënuese; në fakt, ata e përshkruan zotërimin e një arme si burim të vetëbesimit apo si mbrojtje simbolike.

Edhe pse disa të anketuar në seancat e grupeve të konsultimit për rastet e krizave pretenduan se mbajtja e armëve nga banorët e përgjegjshëm mund të lehtësojë parandalimin e krimit dhe të dhunës, pjesa më e madhe nuk e rekomanduan rritjen e përdorimit të armëve. Nga ana tjetër, ata bënë thirrje për akses selektiv, duke argumentuar se banorët që zbatojnë ligjin nuk duhet të penalizohen për veprimet e kriminelëve. Gjithashtu, ata sugjeruan se rritja e aksesit të ligjshëm mund të frenojë veprimtaritë në tregun e paligjshëm, i cili lulëzon falë kërkesës së lartë dhe ofertës së kufizuar. Megjithatë, edhe mbështetësit e liberalizimit të armëve pranuan se, për të parandaluar keqpërdorimin dhe për të shmangur lëndimet, është thelbësore që të ekzistojnë kërkesa për kontrollet mjekësore, ruajtjen e sigurt dhe dhënien e lejeve. Ndërkohë, personat që e kundërshtojnë liberalizimin e armëve theksuan se thjeshtësimi i kuadrit ligjor, i cili perceptohet aktualisht

se nuk zbatohet siç duhet, mund të rezultojë në rritje të aksidenteve, vetëvrasjeve dhe përplasjeve të dhunshme.

Diskutimet theksuan rolin e vazhdueshëm të vlerave sociale dhe të besimit tek institucionet në formësimin e qëndrimeve ndaj armëve të zjarrit. Normat gjinore vazhdojnë të luajnë një rol përcaktues: shpeshherë, burrat i lidhnin armët e zjarrit me mbrojtjen e kombit dhe të familjes, ndërsa gratë kishin mendime më të ndara, pasi disa prej tyre citonin vetëmbrojtjen ndërsa disa të tjera ishin fuqimisht kundër aksesit të armëve nga civilët. Tradita mbetet një faktor nxitës, edhe pse jo në nivele konsistente, i cili përmendet shpesh për të justifikuar mbajtjen e armëve dhe shumë rrallë për ta kundërshtuar atë. Kishte evidenca të pakta lidhur me faktin se armët e zjarrit konsiderohen si simbole të statusit apo pushtetit. Megjithatë, edhe disa prej mbështetësve të aksesit të ligjshëm sollën në vëmendje shqetësimet e lidhura me lartësimin e armëve në media, dhe në veçanti me ndikimin e tyre tek të rinjtë. Pjesëmarrësit nga të dy kahet në panelet e grupeve të konsultimit për rastet e krizave ranë dakord se edukimi i publikut, mesazhet e përgjegjshme dhe zbatimi i rreptë janë elemente kryesore për të parandaluar që armët e zjarrit të kthehen në rrezik për shëndetin publik dhe në një instrument "vetëdrejtësie".

Siç u theksua më sipër, media dhe kultura popullore besohet se ushtrojnë një ndikim të konsiderueshëm tek të rinjtë përmes lartësimit të armëve të zjarrit, veçanërisht nëpërmjet muzikës, filmave dhe përmbajtjes online. Megjithatë, ekspertët që punojnë ngushtësisht me të rinjtë, veçanërisht mësuesit, psikologët dhe punonjësit socialë, argumentojnë se keqpërdorimi i armëve të zjarrit është më pak pasojë e medias dhe më tepër një pasqyrim i sfidave më të thella kulturore: zbehja e autoritetit të familjes, dobësimi i mbikëqyrjes shoqërore, ndikimi nga bashkëmoshatarët dhe përkeqësimi i sistemit arsimor. Edhe pse armët e zjarrit portretizohen në disa raste si simbole të statusit, shumica e pronarëve dhe blerësve të mundshëm nuk janë dakord me këtë pikëpamje dhe shpesh shprehin zhgënjim ndaj stereotipave që vënë shenjën e barazisë midis zotërimit të armëve dhe dhunës apo kriminalitetit. Në të njëjtën kohë, kostot ekonomike të zotërimit të armëve të zjarrit, në veçanti për veprimtari si gjuetia, mund të veprojnë si një faktor kufizues, pasi shumë persona kanë pranuar se zotërimi i ligjshëm i armëve shoqërohet me një barrë të konsiderueshme financiare.

## Ekspozimi i drejtpërdrejtë dhe trashëgimia historike

Diskutimet në grupet e fokusit me pronarët e armëve të zjarrit nga Ballkani Perëndimor identifikuan një grup arsyesh që janë gjerësisht në përputhje me gjetjet e anketimit, ku përfshihen dëshira për siguri, rekreacioni dhe tradita. Shumë pjesëmarrës, veçanërisht në Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinë, identifikuan gjuetinë dhe qitjen sportive si arsyet kryesore për zotërimin e armëve. Siç u konstatua nga literatura dhe anketimi, këto veprimtari shpesh trashëgohen ndër breza, dhe armët e zjarrit trajtohen më shumë si pasuri familjare dhe mjete rekreacioni se sa si simbole të statusit apo

agresionit. Rregullat lidhur me përdorimin e armëve, veçanërisht brenda familjeve, zbatoheshin përgjithësisht në mënyrë strikte nga kryefamiljari, çka nënvizon ekzistencën e një kulture të rrënjosur thellë të pronësisë së kontrolluar dhe për qëllime të qarta. Interesant është fakti se pronarët pranonin ekzistencën e kostove të armëve të zjarrit, si dhe të shpenzimeve për lejet dhe municionet, por pavarësisht këtyre kostove financiare, ata raportuan se zotëronin disa armë zjarri, çka do të thotë se këto kosto nuk shiheshin gjithmonë detyrimisht si faktorë pengues të mjaftueshëm.

Personat që deklaruan se nuk ishin të angazhuar në veprimtaritë e gjuetisë, përmendën si arsye koleksionimin apo trashëgiminë, të cilat ishin të lidhura shpeshherë me vlerën emocionale. Disa pronarë i përshkruan armët e zjarrit si kujtime nga baballarët apo gjyshërit, pra si simbole të vazhdimësisë familjare dhe jo si instrumente për vetëmbrojtje. Megjithatë, ekziston një dallim i dukshëm ndërmjet këtyre narrativave personale dhe opinionit të publikut të gjerë: të dhënat e anketimit tregojnë se pjesa më e madhe e banorëve nuk do ishin dakord që një mik apo anëtar i familjes të merrte një armë zjarri.[38] Edhe pse shumë pronarë të armëve u shprehën se kishin marrë qëndrime neutrale nga rrethi i tyre shoqëror, disa të tjerë, në veçanti gratë dhe pronarët më të rinj në moshë, deklaruan se i fshihnin armët, veçanërisht nga fëmijët, si pasojë e frikës nga stigmatizimi apo lëndimet aksidentale. Kjo kontradiktë pasqyron një tentativë komplekse për të gjetur ekuilibrin midis krenarisë së lidhur me traditën dhe shqetësimit nga perceptimi i publikut.

Ndjesia e sigurisë që krijohet falë zotërimit të armëve, u shfaq si një arsye e lidhur me faktorët psikologjikë dhe kontekstualë gjatë intervistave në grupin e fokusit. Pronarët, në veçanti në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë, cituan nivelin e ulët të besimit tek agjencitë ligjzbatuese, nivelet e larta të krimit dhe madje edhe frikën nga konfliktet e reja, si arsye për zotërimin e armëve. Këto perspektiva ishin në kundërshtim me anketimin e anëtarëve të publiku të gjerë.[39] Shpeshherë, gratë në këto grupe e lidhnin interesin e tyre për armë zjarri me vetëmbrojtjen nga dhuna në familje apo sulmet seksuale. Megjithatë, një numër i ulët pjesëmarrësish shprehën gatishmërinë për t'i përdorur realisht armët e zjarrit në situata kërcënuese. Kufizimet ligjore dhe frika e humbjes së lejes apo e përballjes me sanksione penale, shërbejnë si faktorë pengues të fuqishëm. Shumica e pronarëve ishin në dijeni të faktit se që përdorimi i një arme zjarri të konsiderohet për vetëmbrojtje duhet të përmbushen disa kushte ligjore tejet specifike, çka përforcon konkluzionin se armët mbahen më shumë si garanci simbolike dhe psikologjike se sa për përdorim praktik.

Dallimet gjinore në zotërimin e armëve të zjarrit janë gjithashtu të theksuara. Grupet e fokusit, veçanërisht në Shqipëri dhe Kosovë, nënvizuan se armët e zjarrit vazhdojnë të trajtohen masivisht si një fushë që u përket meshkujve. Gjatë diskutimeve,

---

**38** Vlen të përmendet se blerja e një arme zjarri ndryshon nga trashëgimi i saj. Shumica e personave marrin në zotërim një armë zjarri pasi një anëtar i familjes ndërron jetë dhe nuk janë në dijeni të procesit ligjor të dorëzimit të armës, ndërsa personat që kërkojnë të blejnë një armë zjarri duhet të shqyrtojnë aktivisht procedurat për blerjen dhe marrjen e lejes.

**39** Për shembull, më tepër se 85 për qind e të anketuarve në Kosovë raportuan se ishin "të kënaqur" me policinë nga muaji maj 2024. Shihni https://app.powerbi.com/view?r=eyJrIjoiYWFhZWIxZTEtMDc2Yi00MjUyLTgwZWUtMTI3ZDNkMzE2NWJiIiwidCI-6ImIzZTVkYjVlLTI5NDQtNDgzNy05OWY1LTc0ODhhY2U1NDMxOSIsImMiOjh9.

gratë e pranuan shpeshherë këtë normë, duke cituar arsyet historike dhe kulturore për mbizotërimin e burrave në fushën e pronësisë së armëve. Megjithatë, disa pjesëmarrës e kundërshtuan këtë stereotip: pjesëmarrëset femra në Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë ndanë përvoja personale të angazhimit në gjueti dhe në blerjen e armëve të zjarrit për të mbrojtur familjen. Megjithatë, narrativat e tyre në përgjithësi theksuan vazhdimin e traditave familjare të meshkujve dhe jo një refuzim individual të pritshmërive gjinore. Shpeshherë, gratë kishin hezituar për të mbajtur armët e zjarrit që kishin trashëguar, por i kishin vlerësuar ato për rëndësinë sentimentale dhe jo detyrimisht për funksionin e tyre.

Pikëpamjet mbi kuadrot ligjorë për armët e zjarrit ishin të përziera, por në përgjithësi të informuara. Shumica e pronarëve të armëve ishin në dijeni të procedurave për marrjen e lejes dhe u shprehën se ishin në përputhje me rregulloret. Megjithatë, ata u shprehën gjithashtu të frustruar me dispozitat që i konsideronin si tejet strikte apo "diskriminuese", në veçanti me dispozitat që parashikojnë revokimin e lejes për shkelje të vogla. Pronarët e armëve bënë thirrje për një verifikim sigurie (vetting) më të rreptë, në veçanti për sa i përket vlerësimeve mjekësore dhe psikologjike, si dhe përmendën problematikën e korrupsionin në procesin e certifikimit. Disa nënvizuan ironinë se procedurat tejet komplekse mund të nxisin në mënyrë të paqëllimtë kërkesën për armë zjarri të paligjshme. Edhe pse disa pronarë armësh pranuan se kishin njohuri të drejtpërdrejta mbi tregun e paligjshëm, shumë besonin se ekzistenca e tij vazhdonte të mbështetej nga armët e mbetura nga luftërat në rajon dhe zbatimi i pamjaftueshëm. Disa prej pjesëmarrësve në grupin e fokusit bënë thirrje për organizimin e fushatave nga institucionet publike me qëllim regjistrimin e ligjshëm të këtyre armëve, duke sugjeruar se masat e qarta dhe më pak ndëshkuese ndaj zotërimit të armëve mund të reduktojnë veprimtarinë në tregun e zi dhe të rrisin sigurinë publike.

## Paqartësia mbi aksesin e ligjshëm në armë zjarri

Diskutimet në grupet e fokusit në Ballkanin Perëndimor konfirmuan se gjuetia, e cila është e rrënjosur thellë në traditën kulturore dhe rregullohet përmes shoqatave formale, përbën arsyen kryesore për zotërimin e ligjshëm të armëve të zjarrit. Anëtarësimi në një shoqatë gjuetie përfshin kalimin e provimeve të rrepta mbi ligjet për faunën dhe përdorimin e përgjegjshëm të armëve të zjarrit. Vetëm pas përmbushjes së këtyre kërkesave, një person mund të aplikojë për leje për armë zjarri, një proces ky që dominohet masivisht nga meshkujt. Edhe pse është rritur popullariteti i qitjes sportive për zbavitje, veçanërisht në popullsinë urbane dhe pjesëtarët e kthyer të diasporës (kryesisht në Kosovë), këto veprimtari janë rreptësisht të rregulluara. Me përjashtim të disa rasteve, pjesa më e madhe e poligoneve të qitjes janë hapësira të kontrolluara ku kërkohet identifikim dhe ushtrohet mbikëqyrje. Edhe pse teorikisht personat e mitur mund të trajnohen nën mbikëqyrjen

e të rriturve[40], tragjeditë e viteve të fundit si vrasjet në shkollë në vitin 2023 në Serbi[41], vrasjet në shkollë në Bosnjë-Hercegovinë në vitin 2024[42], dhe vrasjet në masë në Mal të Zi në vitin 2025,[43] kanë ngjallur debate mbi rregullat dhe rregulloret.[44] Pavarësisht paqartësive ligjore, aktualisht po kthehet në normë marrja e masave paraprake më të rrepta lidhur me përfshirjen e të rinjve.

Narrativat kulturore të lidhura me gjuetinë dhe qitjen sportive për zbavitje janë të ndërthurura fort me nocionet e trashëgimisë, identitetit dhe burrërisë. Shumë pjesëmarrës e përshkruan gjuetinë si një trashëgimi ndër breza, e cila ka vlera sentimentale që shpesh tejkalojnë shqetësimet praktike. Një shembull prekës erdhi nga një 70 vjeçare e ve, e cila kishte kaluar një proces të mundimshëm të marrjes së lejes thjesht për të ruajtur pushkën e bashkëshortit të saj të ndjerë si një kujtim familjar. Edhe pse gjuetia i ka rrënjët në zonat rurale, interesi po zgjerohet edhe në kontekstet urbane si pasojë e rritjes së të ardhurave dhe ndryshimeve në stilin e jetesës. Megjithatë, normat e rrënjosura gjinore vazhdojnë të jenë të pranishme. Gjuetia dhe qitja shihen si fushë që u përket meshkujve, ndërsa përfshirja e grave kufizohet nga përgjegjësitë e tyre familjare. Për shembull, udhëtimet e gjuetisë në fundjavë u përshkruan si jo të përshtatshme për gratë, duke përforcuar stereotipat se armët e zjarrit janë "mjete të burrave".

Qitja sportive për zbavitje dhe gjuetia janë veprimtari ku shfaqen gjithashtu pakënaqësi lidhur me politikën për armët e zjarrit. Gjuetarët dhe qitësit sportive e paraqesin gjerësisht veten si të përgjegjshëm dhe në përputhje me rregullat, duke theksuar zbatimin e rreptë nga ana e tyre të kërkesave ligjore dhe të lidhura me sigurinë. Në fakt, shumica e pronarëve të armëve të zjarrit, gjuetarëve dhe tregtarëve të armëve në të gjitha juridiksionet, shfaqën një nivel të lartë të njohurive mbi ligjet dhe kufizimet aktuale për zotërimin dhe përdorimin e armëve të zjarrit. Pjesa më e madhe e të anketuarve besojnë se dispozitat aktuale për armët e zjarrit janë të rrepta dhe kufizuese. Disa pronarë dhe tregtarë, si p.sh. në Kosovë, mbështesin masa akoma më të rrepta, duke përfshirë certifikata mjekësore dhe kontrolle në terren, si pjesë të procesit të marrjes së

---

**40** Për shembull, disa regjime ligjore u lejojnë të miturve që të përdorin lloje të caktuara të armëve të zjarrit. Në fakt, lojërat olimpike për të rinjtë përfshijnë katër disiplina me armë zjarri (p.sh., pushkë dhe pistoleta me ajër), duke përfshirë për të rinjtë e grupmoshës 15-18 vjeç.

**41** Më 3 maj 2023, një student 13 vjeçar hapi zjarr në Shkollën Fillore Vladislav Ribnikar në Beograd, duke vrarë nëntë shokë klase dhe një roje sigurie, si dhe duke plagosur gjashtë persona të tjerë. Autori, i cili ishte shumë i vogël për t'u ndjekur penalisht sipas ligjit në Serbi, përdori armët e zjarrit me leje të babait të tij. Shihni https://apnews.com/article/serbia-school-shooting-parents-trial-b74c4c3c057854501529511e28dbd6bb.

**42** Më 21 gusht 2024, tre pjesëtarë stafi të një shkolle të mesme në pjesën perëndimore të Bosnjë-Hercegovinës humbën jetën pasi një nga sanitarët hapi zjarr duke përdorur një pushkë automatike dhe më pas vrau veten. Një tjetër incident ndodhi më 27 maj 2024, ku si pasojë e të shtënave me armë zjarri në një qendër pritjeje pranë Sarajevës, gjashtë persona përfunduan në spital. Shihni https://balkaninsight.com/2025/05/27/shooting-at-migrant-centre-in-bosnian-capital-leaves-six-injured/.

**43** Më 1 janar 2025, Mali i Zi përjetoi incidentin më të rëndë të vrasjeve në masë kur 45 vjeçari Aco Martinović vrau 13 persona dhe plagosi tre të tjerë si pasojë e një sërë të shtënash në Cetinje dhe fshatrat përreth. Shihni https://balkaninsight.com/2025/05/06/four-months-after-second-mass-shooting-in-montenegro-public-demands-answers/.

**44** Shihni, për shembull, UNDP https://www.undp.org/serbia/projects/reduce-risk-increase-safety-3.

lejes. Të tjerë, si p.sh. në Serbi dhe Mal të Zi, pretendojnë se procedurat e rrepta zbatohen vetëm për banorët e përgjegjshëm dhe që zbatojnë ligjin.[45]

Një numër i konsiderueshëm i pronarëve të armëve të zjarrit u ankuan se legjislacioni i vendos një barrë të padrejtë dhe lejon revokimin e lejes për incidente të vogla. Disa e perceptojnë këtë si një formë të diskriminimit institucional, dhe e portretizojnë veten si "qytetarë të dorës së dytë", pavarësisht respektimit të ligjit. Shumica besojnë se kërcënimi i vërtetë nuk vjen nga pronarët e pajisur me leje, por nga armët e paregjistruara të periudhës së luftës, të cilat vazhdojnë të qarkullojnë në rajon. Interesant është fakti se në Kosovë, për shembull, u konstatua se disa anëtarë të shoqatave të gjuetisë janë anëtarësuar jo për të ushtruar këtë veprimtari, por për të zotëruar në mënyrë të ligjshme armë zjarri moderne, çka tregon se, në disa raste, anëtarësimi në këto shoqata mund të përdoret si shteg për të realizuar ambiciet më të gjera të zotërimit të armëve. Megjithatë, në shumicën e poligoneve të qitjes, pronarët e klubeve të qitjes theksuan se masat e sigurisë janë të rrepta dhe ekzistojnë kërkesa të qarta për ruajtjen e sigurt të armëve të zjarrit, monitorimin e vazhdueshëm dhe mbikëqyrjen rutinë nga policia, çka përbën një kontrast të konsiderueshëm krahasuar me shqetësimet për qarkullimin e pakontrolluar të armëve të paligjshme.

## Lehtësia e perceptuar e blerjes së armëve të zjarrit të paligjshme

Diskutimet në grupet e fokusit me tregtarët e licencuar të armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor ofruan një perspektivë të ndryshme mbi faktorët që nxisin kërkesën për armë. Më konkretisht, gjuetia, mbrojtja personale dhe traditat kulturore u shfaqën si motive kryesore. Pistoletat (në veçanti 9x19 mm), shotganët, karabinat dhe pushkët e gjuetisë mbeten armët e zjarrit më të kërkuara. Edhe pse kërkesa ndryshon sipas juridiksioneve, armët e zjarrit për gjueti mbizotërojnë në Serbi, Shqipëri dhe Mal të Zi, ndërsa pistoletat janë veçanërisht të kërkuara në Maqedoninë e Veriut. Interesant është fakti se në Bosnjë-Hercegovinë ekziston një rritje e interesit për armët e zjarrit sinjalizuese apo me gaz, të cilat përdoren në dasma dhe evente festive, pasi tregtarët po i promovojnë aktivisht si alternativa jovdekjeprurëse ndaj armëve me municione reale. Në Kosovë, ekspertët nënvizuan popullaritetin (në rritje) të municioneve manovër, krahas rritjes së kërkesës për armë zjarri, në dukje për mbrojtje personale.[46]

Tregtarët në mbarë rajonin konstatojnë një rënie apo stanjacion të kërkesës pas incidenteve të vrasjeve në masë.[47] Këto ngjarje, së bashku me presionin nga publiku dhe

45 Gjuetarët ankohen shpesh për dispozitat ligjore tejet shtrënguese lidhur me ruajtjen e armëve të zjarrit, rregulloret për përdorimin dhe rrethanat në të cilat parashikohet revokimi i lejes për armë zjarri.

46 Vlen të theksohet se armët për alarm dhe sinjalizim janë të ndaluara në Kosovë dhe lejohet të përdoren vetëm nga federata sportive si armë për sinjalizim (nisjen e garave sportive).

47 Gjatë viteve të fundit, disa incidente të "vrasjeve në masë" kanë ndodhur në rajon.

shtrëngimin e rregulloreve ligjore, kanë rezultuar në kryerjen e më shumë kontrolleve të imtësishme të blerësve dhe shitësve. Pavarësisht rënies, kërkesa për armë zjarri për gjueti mbetet relativisht e qëndrueshme, e nxitur nga tradita dhe rekreacioni. Qitja sportive ose për çlirimin e stresit vazhdon të tërheqë një "klientelë" të posaçme, ndërsa në juridiksione të tjera, veçanërisht në Kosovë, armët e zjarrit blihen si pasojë e frikës nga krimi apo konflikteve të mundshme në të ardhmen. Nga ana tjetër, në Maqedoninë e Veriut, disa klientë më të rinj në moshë kanë shfaqur më pak interes në blerjen e armëve të zjarrit, dhe kanë zgjedhur të çaktivizojnë armët e trashëguara. Arsyet janë të shumëfishta dhe variojnë nga ndryshimet e vlerave ndër breza e deri te rregulloret më të rrepta dhe rritja e ndërgjegjësimit mbi rreziqet e armëve të zjarrit.

Shitësit kanë theksuar në mënyrë të përsëritur pajtueshmërinë e tyre të rreptë me standardet për importin, ruajtjen dhe shitjen e armëve të zjarrit. Importi mbetet një barrë nga pikëpamja burokratike dhe shpeshherë, për të realizuar importin nevojiten disa leje dhe automjete të specializuara, veçanërisht në Kosovë. Disa banka refuzojnë të hapin llogari për dyqanet e armëve, duke stigmatizuar më tej një biznes të sanksionuar me ligj. Shumica e shitësve mbajnë regjistra të detajuar për klientët dhe bashkëpunojnë me kontrollet e policisë. Pavarësisht kësaj, ata pranojnë se procedurat ligjore mund të jenë kaq të ndërlikuara sa që mund të nxisin në mënyrë të paqëllimshme disa shitës drejt tregut të paligjshëm. Në Shqipëri dhe Kosovë, rritjet e çmimeve si pasojë e kostove të larta të importit dhe kompleksiteti i zinxhirit të furnizimit kontribuojnë gjithashtu në këtë rrezik.[48]

Normat kulturore dhe rolet tradicionale gjinore luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e profileve të klientëve. Burrat përbëjnë shumicën dërrmuese të strukturës demografike të blerësve. Në përgjithësi, ata janë të grupmoshës 30–45 vjeç, kryesisht nga zonat rurale ose shtresat me të ardhura të larta nga zonat urbane, dhe janë të motivuar nga dëshira për të mbrojtur familjen apo për të ushtruar gjuetinë. Armët e zjarrit vazhdojnë të shihen gjerësisht si simbole mashkullore dhe tregtarët konstatojnë se shpeshherë gratë shmangin tërësisht zotërimin e armëve, ose përballen me paragjykime gjinore kur tentojnë të blejnë armë. Tregtaret femra të armëve në Shqipëri dhe Bosnjë-Hercegovinë raportuan se disa klientë meshkuj refuzojnë të bëjnë biznes me to, duke përforcuar qëndrimet e rrënjosura patriarkale. Disa tregtarë përmendën ndikimin e kulturës popullore, si filmat, muzika dhe videolojërat, ndërsa të tjerë konstatuan efekt të ulët te klientët e rinj, çka tregon tendenca të përziera në rajon.

Tregtarët në të gjitha juridiksionet kanë dhënë disa rekomandime për politikat. Ata bënë thirrje në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e edukimit të publikut mbi përdorimin dhe pronësinë e përgjegjshme të armëve të zjarrit, zbatim më të rrepta ndaj zotërimit të paligjshëm dhe fushata legalizimi më efektive për të reduktuar numrin e armëve të zjarrit të periudhës së luftës që janë ende në qarkullim. Tregtarët në Kosovë theksuan nevojën për programe të mbështetura nga institucionet që synojnë të rinjtë

48 Sipas të anketuarve në grupin e fokusit, çmimi i armëve të zjarrit është ulur në disa vende dhe çmimet e municioneve janë rritur, duke ushtruar më shumë presion mbi tregtinë e ligjshme.

dhe nxisin sigurinë lidhur me armët e zjarrit në shkolla. Në Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut tregtarët kërkuan trajnime dhe ekzaminime mjekësore më të rrepta për pronarët potencialë. Në Serbi, thjeshtësimi i ligjeve për armët e zjarrit dhe rritja e mundësive për t'u praktikuar nën mbikëqyrje, u panë si alternativa të mundshme për të larguar banorët nga tregu i paligjshëm. Në tërësi, tregtarët nënvizuan se një qasje e ekuilibruar që kombinon edukimin e publikut, transparencën institucionale dhe aksesin e ligjshëm, është thelbësore për të ruajtur sigurinë dhe traditën në fushën e zotërimit të armëve.

## Normalizimi i armëve të zjarrit tek të rinjtë dhe ndryshimet ndër breza

Diskutimet në grupin e fokusit me ekspertët që punojnë me të rinjtë në Ballkanin Perëndimor shfaqën një rritje të normalizimit të armëve të zjarrit tek të rinjtë, çka përforcon tendencat e konstatuara tashmë në të dhënat e anketimit rajonal. Shumë të rinj, veçanërisht në Mal të Zi, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut, shprehin interes për të zotëruar armë zjarri, jo vetëm me arsyen për vetëmbrojtje, por edhe për arsye të lidhura me statusin, çka është alarmante. Në Maqedoninë e Veriut, disa të rinj i barazojnë armët e zjarrit me identitetin dhe lirinë personale, ndërsa në Kosovë dhe Shqipëri, arsyet lidhen më tepër me shqetësime praktike si mbrojtja. Ekspertët konstatuan se edhe adoleshentët e mitur dhe nxënësit e shkollave po fillojnë të "kopjojnë" këto pikëpamje, çka sugjeron krijimin e një tendence ndër breza.

Ndikimi i familjes është identifikuar si një faktor thelbësor në formësimin e qëndrimeve ndaj armëve të zjarrit. Ekspertët theksuan se ambientet familjare problematike, të karakterizuara nga neglizhenca, dhuna apo mungesa e ndërveprimit me prindërit, shpesh i lënë të rinjtë të ekspozuar ndaj ndikimeve të jashtme, ku përfshihen bashkëmoshatarët dhe media. Familjet që mbajnë armë zjarri në shtëpi, veçanërisht pa i ruajtur siç duhet, kontribuojnë më tej në perceptimin se zotërimi i një arme është diçka normale, apo madje thelbësore. Ekspozimi ndaj narrativave të konfliktit brenda familjes, veçanërisht në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë, u përmend si faktor që përforcon idenë se armët përfaqësojnë siguri, patriotizëm apo përgjegjësi burrërore. Në disa raste, shtëpia u përshkrua si e paplotë pa një armë zjarri, duke theksuar kalimin ndër breza të traumave historike dhe narrativave kulturore.

Përtej familjes, motivet e të rinjve ndikohen ndjeshëm nga dinamikat me bashkëmoshatarët, përjashtimi social dhe ndikimi nga media. Armët e zjarrit konsiderohen shpesh si instrumente të pushtetit dhe ndjesisë së përkatësisë, veçanërisht nga djemtë që përpiqen të ngjisin shkallët e hierarkisë në një grup apo të ushtrojnë dominimin e tyre. Ekspertët përmendën shtimin e problemeve të shëndetit mendor, si p.sh. ankthi, si faktorë të tjerë që amplifikojnë pasigurinë dhe nevojën e perceptuar për mbrojtje. Siç u theksua nga rishikimi i literaturës dhe anketimet, lartësimi i armëve të zjarrit në media sociale dhe në industrinë e zbavitjes, si dhe aksesi në përmbajtje të dhunshme, krijojnë një mjedis ku armët portretizohen si sende në modë dhe fuqizuese. Në këtë

kontekst, ambientet e paqëndrueshme në familje dhe lagje, së bashku me mungesën e veprimtarive konstruktive ekstrakurrikulare, mund të shtyjnë të rinjtë drejt sjelljeve të rrezikshme, ku përfshihet zotërimi i armë të zjarrit të paligjshme.

Një nga gjetjet më shqetësuese lidhet me distancimin emocional të shfaqur nga disa të rinj në përgjigje të ngjarjeve traumatike, ku përfshihen të shtënat e rreme dhe dhuna reale në shkollë. Ekspertët nga Serbia konstatuan mungesën e një niveli të pritshëm apo të përshtatshëm të frikës dhe shqetësimit, veçanërisht nga studentët jashtë Beogradit, pas të shtënave në shkollë të majit 2023. U raportua se disa fëmijë reaguan në mënyrë shpërfillëse apo me humor të zi, si pasojë e ndikimit nga mbulimi mediatik provokues dhe përmbajtja me mungesë empatie. Mungesa e dukshme e empatisë, e kombinuar me reduktimin e ndjesisë së rrezikut, interpretohet nga disa ekspertë si një formë e "lodhjes nga dhembshuria", një tregues shqetësues se të rinjtë kanë më pak gjasa të përthithin plotësisht rreziqet e lidhura me armët e zjarrit. Tendenca të ngjashme u raportuan se janë vëzhguar në Sarajevë gjatë incidenteve të kërcënimit për bombë, ku të rinjtë shfaqën një nivel befasues të mungesës së ndërgjegjësimit apo frikës.

Sipas specialistëve, aspektet gjinore vazhdojnë të ndikojnë në perceptimin dhe qasjen e të rinjve ndaj armëve të zjarrit. Djemtë vazhdojnë të kenë shumë më tepër gjasa që të mbajnë apo të shprehin interes për armët e zjarrit, si pasojë e normave mbizotëruese gjinore që lartësojnë forcën fizike dhe agresionin. Megjithatë, ekspertët identifikuan një rritje modeste të interesit të femrave, si pasojë e ekspozimit ndaj përmbajtjes së dhunshme në media dhe në disa raste, si pasojë e kuriozitetit apo dëshirës për vëmendje. Në një incident në Bosnjë-Hercegovinë, një vajzë studente mori me vete në shkollë një armë zjarri, jo nga dashakeqësia, por si pasojë e kuriozitetit dhe ndoshta si formë për të kërkuar vëmendje. Edhe pse incidente të tilla janë të rralla, ato flasin për një ndryshim të gjerë: ndërkohë që dhuna bëhet gjithnjë e më normale, kufijtë tradicionalë gjinorë lidhur me armët e zjarrit mund të fillojnë të humbasin, duke vështirësuar përpjekjet parandaluese. Specialistët në juridiksione nënvizuan nevojën urgjente për edukim gjithëpërfshirës, mbështetje për problemet e shëndetit mendor dhe kontrolle rregullatore më të rrepta për të luftuar këto modele të reja.

## Narrativat në media ndikohen nga konfliktet

Profesionistët e medias në Ballkanin Perëndimor dhanë informacione mbi mënyrën se si perceptohen, raportohen dhe diskutohen armët e zjarrit në diskurset publike. Një temë e përsëritur në të gjitha juridiksionet është trashëgimia e trazirave politike, veçanërisht në Serbi, Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë, ku ka ende në qarkullim armë të paregjistruara nga vitet 90'. Në Shqipëri, këto armë mund të përdoren për gjueti ose qitje festive; në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë qarkullimi i vazhdueshëm i tyre mund të jetë i lidhur me perceptimet për mungesën e sigurisë dhe mungesën e

besimit tek institucionet.[49] Gazetarët nga Bosnjë-Hercegovina nënvizuan se shoqatat e gjuetisë të krijuara pas luftës mund të shërbejnë si justifikim për blerjen e ligjshme të armëve të zjarrit, duke rritur dyshimet e aktorëve ndërkombëtarë. Në mbarë rajonin, vazhdon të ekzistojë lidhja kulturore e armëve të zjarrit me burrërinë dhe heroizmin, duke përforcuar narrativën gjinore që kufizon aksesin e grave në armë, edhe në rastet kur një nga shqetësimet është vetëmbrojtja.

Një shqetësim kryesor në radhët e gazetarëve është përdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje, një fenomen që sipas tyre raportohet në nivele të ulëta dhe keqkuptohet. Në Serbi, hetimet e mediave për vrasjen e grave treguan se rreth 30% e këtyre rasteve përfshinin armë zjarri, shumë prej të cilave ishin të trashëguara ose të paligjshme. Armët e zjarrit, edhe kur nuk përdoren, shërbejnë shpeshherë si instrumente të dhunës psikologjike, pasi autorët e përdorin praninë e armës për të frikësuar partnerët. Gazetarët në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë u shprehën se armët e zjarrit po përdoren gjithnjë e më tepër si instrumente shantazhi kundër grave, veçanërisht në kontekstet kur përgjigjja e policisë është e papërshtatshme ose kur stigmatizimi kulturor pengon raportimin. Pavarësisht këtyre tendencave alarmuese, ekziston perceptimi se bashkëpunimi institucional apo aksesi në të dhëna të konsoliduara është në nivele minimale, çka e bën të vështirë për median që të përcjellë objektin e problemit në mënyrë të saktë, apo që të advokojë për përgjigje me politika të bazuara në evidenca.

Roli i medias në formësimin e narrativave mbi armët e zjarrit është i konsiderueshëm dhe i kufizuar. Në Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, shpeshherë, raportimet kufizohen në kronikat mbi krimin apo përmbledhjet e tragjedive me profil të lartë. Gazetarët cituan nxitjen drejt historive provokuese, mungesën e interesit editorial dhe kufizimet në burime si pengesat kryesore për të pasur një mbulim të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm. Disa të tjerë përmendën kulturën popullore, ku përfshihen muzika, filmat dhe media sociale, si faktorë që amplifikojnë tërheqjen ndaj armëve të zjarrit, veçanërisht tek meshkujt e rinj në moshë. Edhe pse gazetarët bëjnë thirrje për eliminimin e këtyre narrativave të dëmshme, ata hasin vështirësi si pasojë e mbështetjes së kufizuar financiare dhe mungesës së angazhimit të audiencës. Në të gjitha juridiksionet, gazetarët theksuan nevojën për fushata ndërgjegjësimi të synuara, trajnime më të mira për gazetarët dhe rritje të aksesit në të dhënat nga autoritetet. Pa këto elemente, përpjekjet për të nxitur pronësinë e përgjegjshme të armëve të zjarrit, apo për të reduktuar kërkesën, nuk ka gjasa të fitojnë terren të konsiderueshëm.

**49** Kjo përkon me gjetjet e anketimit të fundit. Për shembull, në vitin 2023 pati një rënie të lehtë të perceptimeve mbi kënaqësinë me punën e institucioneve në nivel qendror. Perceptimi i të anketuarve mbi sigurinë është reduktuar në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023. Rreth 80 për qind e të anketuarve ndiheshin të sigurt në ambientet jashtë shtëpisë, ndërkohë që në vitin 2023 kjo shifër ishte 83 për qind. Ekzistojnë dallime të konsiderueshme ndërmjet shqiptarëve në Kosovë dhe serbëve në Kosovë. Shihni, për shembull, UNDP. 2024. Public Pulse Brief XXV, https://www.undp.org/kosovo/publications/public-pulse-brief-xxv.

## Strategjitë e juridiksioneve dhe situata reale e zbatimit

Përfaqësuesit e institucioneve publike nga Shqipëria, Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut ndajnë angazhimin e përbashkët për të shtrënguar kuadrot ligjorë për zotërimin e armëve të zjarrit dhe për të përmirësuar mekanizmat e zbatimit me qëllim parandalimin e marrjes në mënyrë të paligjshme të armëve. Njësitë Qendrore për Armët e Zjarrit në të gjitha juridiksionet nënvizojnë se ka procedura që parashikojnë verifikimin e precedentëve penalë, kontrollin mjekësor dhe verifikimin në terren (përveçse në Kosovë) përpara dhënies së lejeve. Arsyet kryesore ligjore të deklaruara për zotërimin e armëve mbeten të njëjta: gjuetia, qitja sportive, armët e trashëguara dhe mbrojtja personale. Siç pritej, një shqetësim i përbashkët i juridiksioneve është përhapja e vazhdueshme e armëve të zjarrit të paligjshme, në veçanti e armëve me origjinë nga konfliktet e së shkuarës apo armëve të modifikuara nga modelet e ligjshme. Sipas të anketuarve, këto sfida përshkallëzohen nga niveli i pamjaftueshëm i zbatimit. Megjithatë, janë identifikuar dallime ndërmjet juridiksioneve lidhur me nivelin e zbatimit dhe të rreptësisë së ligjit, natyrën e besimit të publikut tek institucionet dhe efikasitetin e perceptuar të regjistrave dhe sistemeve të të dhënave.

Në Shqipëri dhe Bosnjë-Hercegovinë ka një fokus të fortë te ruajtja e regjimeve të rrepta të licencimit për të reduktuar keqpërdorimin e armëve të zjarrit. Shqipëria aplikon një ndër pragjet ligjore më të rrepta në rajon: aplikantët duhet të jenë mbi 25 vjeç, të mos kenë precedentë penalë dhe t'u nënshtrohen një verifikimi dhe trajnimi gjithëpërfshirës.[50] Në Bosnjë-Hercegovinë, ligjet për armët e zjarrit kanë ndryshime të vogla sipas kantoneve, por ekzistojnë disa masa mbrojtëse si inspektimet e rrepta në terren dhe revokimi i lejeve për shkelje të vogla. Të dyja juridiksionet raportojnë se shumica dërrmuese e krimeve me armë zjarri kryhen me armë të paligjshme dhe të paregjistruara, shumë prej të cilave qarkullojnë që nga koha e konflikteve të së shkuarës. Të dyja juridiksionet bien dakord se fushatat që nxisin dorëzimin vullnetar të armëve të paligjshme, të mbështetura nga sanksionet e larta dhe kontrollet më të rrepta për importin/eksportin, kanë dhënë rezultate pozitive.

Në Kosovë dhe në Mal të Zi ekzistojnë dy qasje të kundërta. Pavarësisht procedurave relativisht të integruara dhe harmonizimit ligjor me standardet e BE-së, në Kosovë është raportuar mungesë e kontrolleve në terren, e cila është një anomali në të gjithë rajonin. Edhe pse përfaqësuesit e institucioneve pranojnë rritjen e kërkesës për armë zjarri (në veçanti nga pjesëtarët e kthyer të diasporës), ata pranojnë gjithashtu mangësitë në zbatim dhe sanksionet e dobëta për shkeljet. Nga ana tjetër, Mali i Zi e vë theksin te mangësitë në zbatim, duke përfshirë te koordinimi i dobët mes institucioneve, hedhja e të dhënave inkonsistente dhe mangësitë në vlerësimet mjekësore. Megjithatë, të dyja

---

50 Në vitin 2020, autoritetet në Shqipëri prezantuan një projektligj për të ulur moshën minimale të zotërimit të armëve në 22 vjeç, në përputhje me kuadrot ligjorë të BE-së. Shihni https://euronews.al/en/new-law-on-firearms-lowered-age-permit-and-authorization-for-cold-weapons-revoked/.

juridiksionet nënvizojnë rolin që kanë faktorët kulturorë, si simbolika e armëve të zjarrit për identitetin mashkullor dhe mbrojtjen e familjes, në nxitjen e kërkesës. Ekspertët nga Mali i Zi nënvizojnë gjithashtu sfidën e armëve të mbetura nga lufta, të cilat kontribuojnë në trafikimin e paligjshëm.

Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë bërë ndryshime rregullatore së fundi për të trajtuar kërkesën dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit. Maqedonia e Veriut u ka hequr komiteteve policore kompetencën e vendimmarrjes diskrecionale, duke krijuar një proces licencimi më të standardizuar dhe më transparent. Megjithatë, zyrtarët vazhdojnë të mbështeten fuqimisht te njohuritë e oficerëve për të parandaluar keqpërdorimin, çka thekson rëndësinë e inteligjencës njerëzore për të plotësuar regjistrat formalë. Në përgjigje të vrasjeve në masë të vitit 2023, Serbia prezantoi një moratorium të përkohshëm për dhënien e lejeve dhe sigurinë personale, si dhe miratoi dispozita të reja ligjore me fokus tek armët e zjarrit të paregjistruara dhe të modifikuara.[51] Përfaqësuesit nga të dyja juridiksionet theksojnë se pronarët e ligjshëm të armëve të zjarrit nuk përbëjnë shqetësimin kryesor. Përkundrazi, fokusi është te përhapja e armëve të konvertuara, me origjinë nga periudha e luftës, të cilat vazhdojnë të furnizojnë tregun e zi dhe të nxisin dhunën.

Autoritetet publike theksojnë se ndikimet sociale dhe kulturore në kërkesën për armë zjarri janë përgjithësisht të njëjta në të gjitha juridiksionet. Frika, tradita dhe identiteti mashkullor, pavarësisht nëse e kanë zanafillën te krimi modern apo konfliktet historike, vazhdojnë të ndikojnë te modelet e zotërimit. Në të gjashtë juridiksionet, pronësia e armëve vazhdon të jetë një fushë e dominuar masivisht nga meshkujt dhe përdorimi i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje vazhdon të jetë një shqetësim serioz, edhe pse raportohet në nivele të ulëta. Në Serbi, armë perceptohen herë pas here si simbole të statusit dhe pushtetit, veçanërisht nga burrat më të pasur. Një perceptim i ngjashëm është konstatuar edhe në Kosovë. Në Maqedoninë e Veriut, individët më të rinj dhe më të pasur po tërhiqen gjithnjë e më shumë drejt armëve të zjarrit, më tepër për shkak të prestigjit se sa për arsye të lidhura me mbrojtjen. Ndërgjegjësimi i publikut mbi sigurinë dhe ligjet për armët e zjarrit mbetet i ulët në shumicën e juridiksioneve, çka thekson nevojën për fushata të edukimit dhe informimit të të rinjve.

Zyrtarët bien dakord për një grup rekomandimesh kyçe për politikat: zbatimi i inspektimeve periodike në terren, forcimi i vlerësimeve mjekësore dhe psikologjike, rritja e koordinimit ndërmjet agjencive dhe zgjerimi i përpjekjeve për edukimin e publikut. Gjithashtu, autoritetet publike theksojnë rëndësinë e bashkëpunimit rajonal, veçanërisht në trajtimin e trafikimit ndërkufitar dhe në harmonizimin e standardeve të zbatimit. Disa zyrtarë theksuan nevojën për të balancuar masat parandaluese me prakticitetin, duke paralajmëruar se pengesat e tepërta ligjore mund të shtyjnë banorët drejt tregut të paligjshëm. Së fundi, edhe pse ekzistojnë gjerësisht mjete ligjore, sfida kryesore mbetet zbatimi i tyre, duke u siguruar që rregullat të aplikohen në mënyrë konsistente, sanksionet për shkeljet të jenë proporcionale dhe armët e zjarrit të mos bien në duart e personave që përbëjnë kërcënim.

**51** Pak kohë pas vrasjeve në shkollë në maj të vitit 2023, autoritetet në Serbi prezantuan një moratorium gjashtëmujor për dhënien e lejeve të reja për zotërimin dhe përdorimin e armëve të zjarrit për banorët.

# 6.

# NDIKIMET E LIGJEVE PËR ARMËT E ZJARRIT NË KUFIZIMIN E KËRKESËS PËR ARMË ZJARRIT

Ekziston mundësia që të vlerësohet ndikimi i legjislacionit për armët e zjarrit dhe i direktivave të harmonizuara me ato të BE-së, në kërkesën e civilëve për armë zjarri në gjashtë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor. Bazuar në dhjetëra ligje dhe direktiva për armët e zjarrit të miratuara ndërmjet viteve 2012 dhe 2022, SEESAC porositi një studim përshkrues për të shqyrtuar marrëdhënien midis këtyre ligjeve dhe disa aspekteve që mbështesin kërkesën për armë zjarri, ku përfshihen nivelet e licencimit, dhuna me armë, motivet personale dhe besimi tek institucionet. Si pasojë e të dhënave të kufizuara në intervale kohore dhe mospërputhjeve në raportim, nuk është e mundur që të jepen konkluzione mbi lidhjet shkak-pasojë.[52]

Që nga viti 2012, të gjashta juridiksionet kanë miratuar legjislacion të ri për armët e zjarrit ose kanë ndryshuar ligjet ekzistuese, shpeshherë me qëllimin për të qenë në përputhje me Direktivën e BE-së "Për armët e zjarrit". Këto kuadro ligjorë mbulojnë zotërimin, mbajtjen, ruajtjen, regjistrimin dhe tregtinë. Vlerësimi bazohet në mbi 31 ligje kombëtare dhe ndryshimet përkatëse, si dhe në katër direktiva kyçe të BE-së, dhe fokusohet në periudhën 2012-2022. Të dhënat administrative për licencimin, sekuestrimet dhe dhunën me armë zjarri u morën nga grupet zyrtare të të dhënave dhe burimet e hapura. Megjithatë, cilësia, plotësia dhe krahasueshmëria e këtyre të dhënave ndryshonte ndjeshëm ndërmjet juridiksioneve dhe në varësi të periudhës kohore, duke kufizuar kështu analizën e shtrirë në kohë.

Modelet e dhënies së lejeve për armë zjarri tregojnë se reformat ligjore nuk kanë mjaftuar për të reduktuar kërkesën për armë zjarri. Në fakt, institucionet në Serbi, Mal të Zi dhe Kosovë regjistruan rritje të numrit të lejeve pak kohë para miratimit të ligjeve ose pas miratimit të tyre, çka tregon se regjistrimet u bënë për qëllime strategjike ose për të qenë në përputhje me ligjet që do të miratoheshin. Një përjashtim të rëndësishëm përbën Shqipëria, pasi numri i lejeve u ul përkohësisht pas ndryshimit të fundit në ligjin "Për armët". Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovina raportuan gjithashtu rritje modeste të lejeve të reja. Në të gjitha juridiksionet, numri total i lejeve për armë zjarri ka vijuar të rritet. Këto modele sugjerojnë se civilët mund të kërkojnë të garantojnë aksesin e tyre në armë zjarri para se të hyjnë në fuqi kufizimet e reja, ose i perceptojnë reformat si një legjitimim të zotërimit të armëve të zjarrit, të autorizuar nga institucionet.

Arsyet kryesore për lejet për armë zjarri mbetën konsistente në mbarë rajonin. Lejet u dhanë kryesisht për arsye të vetëmbrojtjes, gjuetisë dhe qitjes sportive. Shqipëria regjistroi një rritje të numrit të lejeve për gjueti pas miratimit të legjislacionit, ndërsa Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut ishin juridiksionet që lëshuan numrin më të madh të lejeve të reja për vetëmbrojtje dhe qitje sportive. Serbia regjistroi rritjen më të lartë të lejeve për gjueti pas miratimit të legjislacionit të ri. Edhe pse ekzistojnë disa dallime midis juridiksioneve, kërkesa e përgjithshme mbeti në nivele të qëndrueshme pavarësisht

52 Grupi i të dhënave të SEESAC për legjislacionin dhe kërkesën për armë zjarri, i disponueshëm .

regjimeve rregullatore më të rrepta.[53] Kjo nënkupton se armët e zjarrit vazhdojnë të perceptohet si mjete të vlerës kulturore, mbrojtjes personale dhe rekreacionit.

Krahas modeleve të licencimit, studimi eksploroi treguesit e tregut si numri i dyqaneve të armëve dhe inventarët e municioneve. Me përjashtim të Shqipërisë, ku numri i dyqaneve të licencuara për tregtimin e armëve pësoi rënie të lehtë pas miratimit të legjislacionit, të gjitha juridiksionet e tjera regjistruan rritje të subjekteve të tregtimit me pakicë dhe raportuan stoqe të municioneve gjatë viteve 2012-2022. Në veçanti, Maqedonia e Veriut regjistroi një rritje prej pesëfish të inventarëve të municioneve, ndërsa Bosnjë-Hercegovina regjistroi rritje të numrit të dyqaneve të tregtimit të armëve gjatë kësaj periudhe. Këto tendenca konfirmojnë më tej faktin se kufizimet ligjore nuk zvogëluan zinxhirët e furnizimit apo kërkesën, por u shoqëruan me zgjerimin e tregut, me shumë mundësi si pasojë e rritjes së qartësisë rregullatore ose rritjes së interesit.

Ligjet për armët e zjarrit, në rastet kur janë kombinuar me dorëzimin vullnetar, sekuestrimin dhe fushatat e legalizimit, kanë reduktuar me sukses numrin e armëve të paligjshme nga qarkullimi. Në fakt, numri i armëve të zjarrit të konfiskuara u rrit ndjeshëm në Serbi, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë pas miratimit të ligjeve të reja dhe reformave të harmonizuara me ato të BE-së. Shqipëria dhe Bosnjë-Hercegovina raportuan gjithashtu përpjekje për mbledhjen e armëve të lidhura me reformat ligjore dhe fushatat e amnistisë. Në Malin e Zi, u regjistrua një rritje e numrit të armëve të hequra nga qarkullimi gjatë periudhës 2012-2016. Këto programe kontribuuan në uljen e stoqeve të paligjshme. Megjithatë, ekzistojnë lidhje të dobëta ndërmjet ndryshimeve ligjore dhe uljes afatgjatë të kërkesë së paligjshme.

Miratimi i ligjeve për armët u shoqërua gjerësisht me ulje të vrasjeve dhe vetëvrasjeve me armë zjarri. Shqipëria dhe Bosnjë-Hercegovina regjistruan përgjysmim të nivelit të vrasjeve gjatë periudhës 2012-2022. Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Kosova përjetuan gjithashtu tendenca në rënie, ndërsa Mali i Zi regjistroi nivele të qëndrueshme. Po ashtu, vetëvrasjet dhe plagosjet me armë zjarri pësuan rënie në shumicën e juridiksioneve, veçanërisht në Serbi dhe Mal të Zi. Megjithatë, është e vështirë të përcaktohet lidhja shkak-pasojë si rezultat i mangësive në të dhëna dhe ndikimit të mundshëm të variablave të tjerë socio-politikë. Pavarësisht kësaj, tendencat konsistente në të gjitha juridiksionet sugjerojnë se legjislacioni mund të kontribuojë në rezultatet më të gjera të reduktimit të dhunës.

Efektet e legjislacionit në nivelin më të gjerë të krimeve me armë janë të ndryshme. Në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, niveli i krimeve me armë zjarri ra ndjeshëm pas miratimit të legjislacionit. Megjithatë, në Malin e Zi, krimet me armë zjarri, duke përfshirë grabitjet, u rritën pas miratimit të legjislacionit. Shqipëria regjistroi rezultate të përziera, përkatësisht rritje të prodhimit dhe mbajtjes së paligjshme, por nivele të qëndrueshme të viktimave nga armët e zjarrit. Këto rezultate kontradiktore

**53** Në fakt, sipas të dhënave administrative të marra nga SEESAC, gjatë periudhës 2022-2024, numri i lejeve për armë zjarri vijoi të rritej në mënyrë të qëndrueshme për disa kategori në të gjitha juridiksionet.

tregojnë se si kuadrot e ndryshëm ligjorë mund të ndikojnë te modelet e gjera të krimeve (me armë zjarri). Megjithatë, nevojitet një analizë më e bashkërenduar.

Është më pak e qartë nëse legjislacioni ka ndikuar në qëndrimet ndaj blerjes dhe përdorimit të armëve të zjarrit. Me përjashtim të Shqipërisë[54], nivelet e zotërimit të armëve të zjarrit vazhduan të rriten në shumicën e juridiksioneve pas miratimit të legjislacionit përkatës. Një shqyrtim i të dhënave administrative sugjeron se nivelet e zotërimit vijuan të rriten gjatë periudhës 2022-2024.[55] Edhe pse këto shifra duhet të interpretohen me kujdes si pasojë e raportimit të pabarabartë dhe tendencës për t'ju përgjigjur pyetjeve në përputhje me normat sociale, ato flasin për një kërkesë të vazhdueshme të civilëve për armë zjarri. Ndikimi i traditës familjare, kultura rekreacionale dhe konfliktet historike kanë gjithashtu gjasa të kontribuojnë në këto modele.

Edhe pse legjislacioni për armët e zjarrit luan një rol të rëndësishëm në formësimin e mjedisit rregullator, ai nuk redukton thellësisht kërkesën e civilëve në Ballkanin Perëndimor. Tendencat e zotërimit të armëve vijojnë të jenë të pranishme dhe në disa raste janë rritur pavarësisht kontrolleve më të rrepta, çka tregon se kërkesa varet më pak nga aksesi ligjor se sa nga perceptimet e rrënjosura mbi mungesën e sigurisë, besimin e kufizuar tek institucionet dhe ndikimin e vazhdueshëm të normave kulturore dhe historike. Edhe pse janë të nevojshme, reformat ligjore nuk janë të mjaftueshme. Ato duhet të shoqërohen nga masa të qëndrueshme të informimit të komunitetit, fuqizim institucional dhe iniciativa të synuara të çarmatimit, për të reduktuar kërkesën në mënyrë kuptimplotë. Për të mbështetur këto përpjekje, kërkimet në të ardhmen duhet t'u japin prioritet studimeve të shtrira në kohë për të identifikuar marrëdhënien në evoluim e sipër ndërmjet rregulloreve, perceptimit të publikut dhe blerjes së armëve.

**54** Sipas Muggah (2023), numri total i aplikimeve për leje për armë zjarri në Shqipëri ra gjatë periudhës 2012-2016, përkatësisht nga 3600 në vitin 2012 në 1100 në vitin 2016. Megjithatë, numri i tyre u rrit gjatë periudhës 2022-2024. Gjithashtu, në vitin 2022, vetëm 4 për qind e popullsisë u shprehën se dëshirojnë të zotërojnë një armë zjarri ndërsa 93 për qind thanë se nuk e dëshirojnë diçka të tillë. Rreth 25 për qind u shprehën se arma do i bënte të ndiheshin më të sigurt. Krahasuar me vitin 2024, 82 përqind e banorëve në Shqipëri deklaruan se nuk dëshironin një armë zjarri dhe 18,3 për qind u shprehën se një armë në shtëpi do i bënte të ndiheshin më të sigurt. Shihni SEESAC (2025).

**55** Për shembull, në Serbi, të dhënat mbi regjistrimin e armëve të zjarrit të mbajtura nga civilët sugjerojnë se numri total i personave fizikë të pajisur me leje për armë zjarri, për të gjitha kategoritë e licencave/lejeve/autorizimeve, u rrit nga 359 584 në vitin 2022 në 364 958 në vitin 2024. Në Shqipëri, numri total i armëve të zjarrit të regjistruara në të gjitha kategoritë u rrit nga 76 928 në vitin 2022 në 82 040 në vitin 2024. Në Mal të Zi, numri total i personave të pajisur me leje për armë zjarri, në të gjitha kategoritë, u rrit nga 3569 në vitin 2022 në 5064 në vitin 2024. Ndërkohë, edhe në Kosovë, numri i të gjitha armëve të zjarrit të regjistruara nga personat fizikë, për çdo kategori, u rrit nga 5589 në 8532.

# 7.

# KËRKESA PËR ARMË ZJARRI NË SFERËN DIXHITALE

Falë një studimi të monitorimit në media sociale të kërkesës për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor, u monitoruan platforma online të aksesueshme për publikun që mund të ndikojnë ose të pasqyrojnë perceptimin e publikut mbi çështjet e lidhura me armët e zjarrit. Analiza u fokusua te platformat e hapura, duke përfshirë kanalet kryesore të mediave sociale (të tilla si X/Twitter, Instagram, Facebook, YouTube, TikTok), portalet kombëtare dhe lokale të lajmeve, forumet në Reddit, si dhe faqet e internetit të institucioneve si p.sh. të ministrive të brendshme dhe departamenteve të policisë. Mbledhja e të dhënave u mbështet në kërkimin përmes fjalëve kyçe, veçanërisht në X, Instagram dhe YouTube, pa u fokusuar në llogari specifike në këto platforma.[56] Një instrument monitorimi privat i quajtur "Synthesio" mundësoi gjurmimin e grupi të konsiderueshëm të faqeve përkatëse të internetit në nivel rajonal, të identifikuara sipas gjuhës.[57]

Pavarësisht shtrirjes së tij, studimi u përball me disa kufizime metodologjike. Në veçanti, vlen të përmendet mungesa e aksesit në platformat e mbyllura, si aplikacionet e inkriptuara të mesazheve, apo grupet private, si WhatsApp dhe Telegram. Mbulimi i burimeve ishte i paplotë si pasojë e mungesës së një indeksi universal për të gjitha faqet e internetit dhe llogaritë në media sociale. Identifikimi sipas gjuhës orientoi procesin e përzgjedhjes së burimit dhe jo të juridiksionit, çka mund të ketë rezultuar në anashkalimin apo klasifikimin e gabuar të disa diskutimeve me rëndësi. Edhe pse u bënë përpjekje për të garantuar përfshirjen e faqeve dhe të platformave që kanë ndikim dhe që vizitohen shpesh, analiza përfshiu vetëm një pjesë të diskutimeve online mbi armët e zjarrit. Edhe pse informacionet kanë baza kontekstuale, ato nuk mund të përgjithësohen për të gjitha bisedat dixhitale apo popullsitë në Ballkanin Perëndimor.

Në tërësi, monitorimi në mediat sociale, i realizuar gjatë periudhës prill 2022 - shkurt 2025, theksoi se armët e zjarrit përbëjnë një temë që diskutohet ndjeshëm në platformat online në Ballkanin Perëndimor. Më konkretisht, u regjistrua se armët e zjarrit ishin përmendur 3 milionë herë brenda një periudhe trevjeçare.[58] Numri tejet i lartë i referencave të drejtpërdrejta për armët e zjarrit, municionet dhe sinonimet e tyre, është tregues i një interesi publik të konsiderueshëm, edhe pse metodologjia e përdorur nuk ofron një standard të qartë referencë për të bërë krahasime. Vlen të theksohet se 85% e përmendjeve të dokumentuara rezultuan nga burimet e gazetarisë/mediatike, çka

56 Në rastin e Facebook, si pasojë e kufizimeve teknike, monitorimi u kufizua në vetëm 53 llogari biznesi të siguruara nga UNDP SEESAC ose të identifikuara nga IPSOS; faqet personale dhe grupet në Facebook u përjashtuan. Të dhënat në TikTok përfshinë rreth 92 500 llogari në nivel global.

57 Platforma "Synthesio" gjurmoi faqe interneti në disa gjuhë, duke përfshirë në shqip (338), serbisht (757), boshnjakisht (2136), maqedonisht (400) dhe malazisht (134). Këtu nuk përfshihen llogaritë në media sociale, ose forumet online, si p.sh. në Reddit.

58 Pjesa më e madhe e të dhënave vijnë nga burimet e gazetarisë/mediatike, të cilat përbëjnë 2,5 milionë të përmendjeve, apo rreth 85% të të gjitha postimeve. Vendin e dytë e zënë platformat e mediave sociale me 342 500 përmendje (12%), kryesisht nga X (e njohur më parë si Twitter) me 177 600 përmendje (6%) dhe YouTube me 149 700 përmendje (5%). Një përqindje shumë më e vogël vjen nga forumet, përkatësisht 85 700 përmendje në total (3%), pjesa më e madhe e të cilave (60 500) nga Reddit. Platformat e mediave institucionale përbëjnë pjesën më të ulët, me vetëm 19 700 përmendje (1%).

ritheksοn rolin mbizotërues të mediave tradicionale në formësimin dhe amplifikimin e narrativave mbi armët e zjarrit. Platformat e mediave sociale, në veçanti X (e njohur më parë si Twitter) dhe YouTube, përbënin rreth 12 përqind të përmendjeve, çka nënvizon rolin e tyre plotësues, por jo parësor, në diskutimet dixhitale.

U identifikua një model i qartë që tregon se rritja e përmendjeve në diskutimet online lidhet ngushtësisht me tragjeditë me armë zjarri. Rritja më e theksuar u regjistrua në maj të vitit 2023, në vijim të vrasjeve në masë në Serbi, të cilat nxitën gjerësisht debatet online dhe mbulimet mediatike.[59] Këto ngjarje tragjike kanë tendencën të rrisin numrin e përmendjeve mbi armët të zjarrit, si dhe të nxisin një ndryshim të dukshëm të qëndrimit. Analiza e qëndrimit tregon se diskutimet përmbanin kryesisht një ton negativ: 24 për qind e të gjitha përmendjeve përmbanin një qëndrim negativ ndaj armëve të zjarrit, dhe vetëm 2 për qind ishin pozitive. Bisedat në media sociale ishin edhe më të polarizuara. Përkatësisht 33 për qind përmbanin një qëndrim negativ dhe 4 për qind përmbanin një qëndrim pozitiv, çka pasqyron përgjigjet emocionale dhe ndasitë në mendime në forumet publike.

Analiza cilësore e përmbajtjes online nënvizon gjithashtu se si njerëzit në mbarë rajonin janë të ekspozuar ndaj përmbajtjeve që mund të zvogëlojnë perceptimin e tyre mbi sigurinë. Këtu përfshihet mbulimi mediatik në nivel makro i konflikteve ndërkombëtare, tensionet rajonale të lidhura me angazhimin e forcave ushtarake dhe rritja e shpeshtësisë së incidenteve me armë zjarri në nivel vendor, nga vrasjet brenda familjes deri në të shtënat në shkolla. Me shumë gjasa, raportimet e vazhdueshme mbi dhunën dhe pasigurinë rrisin më tej shqetësimet e publikut lidhur me armët e zjarrit. Gjithashtu, portretizimet emocionale dhe alarmuese në lajme dhe në media sociale përforcojnë ndjenjën e frikës. Në këtë kontekst, armët e zjarrit konsiderohen si një simptomë dhe një simbol i paqëndrueshmërisë së gjerë në shoqëri.

Nga ana tematike, diskutimet online fokusoheshin në pesë tema kryesore: vrasjet dhe krimet me armë zjarri, zotërimi i ligjshëm dhe i paligjshëm i armëve të zjarrit, sekuestrimet e armëve të zjarrit dhe amnistitë, rregulloret dhe legjislacioni kombëtar, si dhe dinamikat më të gjera rajonale të lidhura me armatimet. Këto tema pasqyrojnë shqetësimet e përditshme të lidhura me sigurinë dhe frikën e perceptuar lidhur me militarizimin në Ballkan. Gjithashtu, ato nënvizojnë angazhimin e publikut në aspektet kyçe të kontrollit të armëve të zjarrit, ku përfshihen kuadrot ligjorë dhe mekanizmat e zbatimit. Në veçanti, diskutimet lidhur me zotërimin e paligjshëm, amnistitë dhe sekuestrimet janë ndërthurur shpeshherë me debatet publike mbi autoritetin e institucioneve, korrupsionin dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të politikave.

Së fundmi, vlen të theksohet se kultura popullore dhe influencuesit në media sociale kanë një ndikim të dukshëm në formësimin e qëndrimeve dhe në nxitjen e angazhimit

**59** Analiza mujore e përmendjeve online tregoi se në përgjithësi ka nivele të qëndrueshme diskutimi mbi armët e zjarrit, me rritje të dukshme në maj 2023 në vijim të dy incidenteve të vrasjeve në masë në Serbi (në shkollën fillore “Vladislav Ribnikar” dhe në Malo Orašje/Dubona), në shtator-tetor 2023, e cila lidhet me shumë gjasa me incidentin e Banjska në Kosovë dhe me fillimin e konfliktit Izrael–Palestinë, si dhe në janar 2025 në vijim të vrasjeve masive në Cetinje.

lidhur me armët e zjarrit. Tekstet e këngëve që përmendin armë dhe dhunë, të cilat shpesh lartësohen në videot muzikore, ishin ndër përmbajtjet me nivelet më të larta të ndërveprimit. Disa influencues në Instagram dhe YouTube kanë luajtur një rol kyç në ruajtjen e vizibilitetit mbi narrativat e lidhura me armët e zjarrit, qoftë duke amplifikuar artikujt mediatikë ose duke injektuar opinione personale në debatet publike. Këta zëra, me ose pa qëllim, kontribuojnë në normalizimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve lidhur me armët e zjarrit, veçanërisht tek audiencat e reja, çka thekson nevojën për njohuri mediatike të synuara dhe për strategji që trajtojnë këto narrativa.

# 8.

# GJETJET DHE REKOMANDIMET

Ekzistojnë studime të kufizuara teorike dhe empirike lidhur me vlerësimin e kërkesës për armë zjarri. Gjithashtu, ka relativisht një numër të ulët studimesh mes ekspertësh të fokusuara specifikisht në zhvillimin e teorive mbi kërkesën për armë zjarri, duke përfshirë në literaturën për kriminologjinë. Në fakt, nuk janë identifikuar studime empirike që shqyrtojnë në thellësi këtë çështje në Ballkanin Perëndimor. Për më tepër, ka të dhëna të kufizuara në dispozicion të publikut që të mundësojnë një vlerësim të thelluar të kërkesës për armë zjarri të paligjshme. Vlerësimi i lidhjeve ndërmjet legjislacionit për armët e zjarrit dhe kërkesës për armë zjarri të paligjshme në të gjashta juridiksionet përballet me pengesa, ndër të tjera, si pasojë e nivelit të pabarabartë të disponueshmërisë dhe cilësisë së të dhënave, ndonëse janë bërë disa përmirësime. Pavarësisht përpjekjeve nga autoritetet e Ballkanit Perëndimor për të përmirësuar të dhënat dhe analizën lidhur me armët e zjarrit,[60] është e vështirë të nxirren konkluzione përfundimtare mbi kërkesën në Ballkanin Perëndimor.

Ky vlerësim paraqet një kuadër teorik novator për vlerësimin e kërkesës për armë zjarri. Studimi prezanton një model teorik novator për të përcaktuar më mirë kërkesën për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor dhe më tej. Kërkesa është funksion i tre elementëve të ndërthurur: preferenca, çmimi dhe burimet. Ajo ndikohet gjithashtu nga faktorët e rrezikut dhe ato mbrojtës në nivel individual, familjeje, komuniteti dhe shoqërie. Kuadri është i përshtatshëm për të vlerësuar kërkesën në tregjet e ligjshme dhe të paligjshme dhe mund të ndihmojë për të zbërthyer modelet e blerjes së armëve të zjarrit dhe keqpërdorimin e tyre në të gjithë rajonin. Kërkesa nuk konceptohet si një element fundor statik, por si një kusht dinamik dhe i ndërlidhur që ndikohet nga përvojat e jetës, kushtet socio-ekonomike dhe normat kulturore.

Studimi tregon se qasjet me metoda të ndërthurura mund të rrisin njohuritë dhe të mbështesin politikat praktike për zvogëlimin e kërkesës për armë zjarri**.** Studimi ka zbatuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumëdisiplinore që kombinon një shqyrtim të thelluar të literaturës me gjashtë anketime në nivel juridiksioni, më shumë se 40 intervista me ekspertë, 18 grupe fokusi dhe 6 grupe të konsultimit me banorët për rastet e krizave. Këto metoda mbështeten nga intervistat me informatorët kyçë, dhjetëra ekspertë dhe një shqyrtim përshkrues i ndikimeve te kërkesa të 30 ligjeve për armët e zjarrit (2012-2024) dhe direktivave të BE-së për armët e zjarrit. Metodologjia mundëson triangulimin ndërmjet të dhënave cilësore dhe sasiore, si dhe mundëson një kontekstualizim më të thellë të sjelljeve individuale në kuadrot më të gjerë socialë dhe ligjorë.

## Gjetjet kryesore

**Anketimi shfaq mospërputhje ndërmjet perceptimeve mbi pasigurinë dhe kërkesës për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor.** Anketimet e realizuara në Shqipëri, Serbi, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut

60 Shihni https://www.seesac.org/Roadmap-Monitoring/.

tregojnë se pothuajse një e treta e të gjithë të anketuarve përmendin shprehimisht “sigurinë personale” si një nga arsyet kryesore për të zotëruar armë. Megjithatë, gjysma e banorëve mendojnë se të pasurit e armëve të zjarrit në shtëpi nuk e rrit ndjesinë e tyre të përgjithshëm të sigurisë. Për më tepër, vetëm dy në dhjetë të anketuar mendojnë se armët e zjarrit do të rrisnin realisht sigurinë e tyre në shtëpi, çka sugjeron se frika e publikut nuk përkthehet automatikisht në rritje të kërkesës.

**Vlerësimi shfaqi gjithashtu se si ndryshimet demografike ndikojnë ndjeshëm në qëndrimet ndaj armëve të zjarrit, duke e renditur gjininë si faktorin më kryesor.** Zakonisht, burrat në mbarë rajonin janë më në favor të zotërimit dhe përdorimit të armëve të zjarrit, krahasuar me gratë. Më tepër se gjysma e të anketuarve meshkuj pohuan se kanë mbajtur armë zjarri, ndërsa në rastin e grave pak më tepër se një e dhjeta e tyre e pohuan diçka të tillë. Gjithashtu, meshkujt e grupmoshës 18-40 vjeç shprehin interes më të madh për zotërimin e armëve të zjarrit, krahasuar me brezat më të vjetër, gjë që tregon ndryshime të mundshme në modelet e kërkesës në të ardhmen.

**Njohjet personale dhe prejardhja socio-ekonomike duket se ndikojnë në nivelin e familjaritetit me armët e zjarrit.** Më specifikisht, burrat dhe personat me të ardhura më të larta raportojnë nivele shumë më të larta të njohjes së zotëruesve ose përdoruesve të armëve të zjarrit, krahasuar me gratë dhe personat ekonomikisht të disavantazhuar. Në këtë rast vlen të nënvizohet edhe dallimi ndërmjet juridiksioneve: Të anketuarit në Mal të Zi dhe Serbi raportuan nivelin më të lartë të njohjes së pronarëve të armëve të zjarrit, ndërsa në Kosovë dhe Shqipëri nivelet janë ndjeshëm më të ulëta.

**Motivet e lidhura me përdorimin dhe zotërimin e armëve të zjarrit ndryshojnë ndjeshëm ndërmjet juridiksioneve.** Të anketuarit në Mal të Zi nënvizojnë, në një masë të madhe dhe në një përqindje shumë më të lartë se mesatarja rajonale, traditën si arsyen kryesore për zotërimin e armëve të zjarrit, ndërsa për sa i përket shqetësimeve të sigurisë në Mal të Zi, niveli i tyre është relativisht më i ulët krahasuar me mesataren. Nga ana tjetër, të anketuarit në Bosnjë-Hercegovinë e vënë fort theksin te siguria dhe mbrojtja, në një nivel shumë më të lartë se mesatarja rajonale. Në Shqipëri, motivi kryesor është “rekreacioni”, ndërkohë që është rritur numri i personave që i shohin armët e zjarrit si simbol të statusit.

**Pjesa më e madhe e të anketuarve mbështesin fort zbatimin e kontrolleve më të rrepta për armët e zjarrit, pavarësisht frikës nga krimi.** Më tepër se gjysma e personave të anketuar besojnë se aksesi universal në armët e zjarrit do të rriste nivelin e krimit. Ky perceptim është më i lartë te grupmoshat e mëdha dhe grupet ekonomikisht të disavantazhuara. Vetëm një numër i ulët, përkatësisht një në dhjetë persona, e shohin rritjen e nivelit të zotërimit të armëve si një faktor që redukton krimin. Vlen të theksohet se tre të katërtat e të anketuarve në Shqipëri parashikojnë nivele më të larta krimi në

rastin e aksesit universal, çka sugjeron një skepticizëm të gjerë lidhur me zotërimin e armëve të zjarrit si një mjet që garanton sigurinë.

**Përvoja individuale me armët e zjarrit ndikon gjithashtu qartësisht në perceptimet mbi sigurinë, ligjshmërinë dhe aksesueshmërinë.** Individët e ekspozuar ndaj armëve të zjarrit, veçanërisht në kontekste të dhunshme, perceptojnë nivele shumë më të larta të zotërimit të armëve (33 për qind) dhe i konsiderojnë armët e paligjshme të zjarrit si lehtësisht të aksesueshme (41 për qind). Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, mbi 60 për qind e pronarëve aktualë dhe pronarëve aspirues kanë përvojë të drejtpërdrejtë me armët e zjarrit, çka thekson se si njohuritë personale ndikojnë te kërkesa dhe qëndrimet ndaj rregullimit të armëve.

**Perceptimi i popullsisë së rajonit rreth përhapjes së armëve të zjarrit mbetet një shqetësim në mbarë rajonin.** Gati dy të tretat e banorëve të Ballkanit Perëndimor vlerësojnë se gjysma e bashkëqytetarëve të tyre zotërojnë armë zjarri. Megjithatë, ekziston një pakicë e konsiderueshme që besojnë se zotërimi tejkalon 50 për qind. Këto vlerësime variojnë ndjeshëm nga njëri juridiksion në tjetrin. Banorët e Malit të Zi dhe të Bosnjë-Hercegovinës kanë më shumë gjasa të perceptojnë nivele më të larta të zotërimit, krahasuar me Serbinë, Shqipërinë dhe Kosovën ku perceptohet nivele shumë më të ulëta.

**Në mbarë rajonin ekzistojnë qëndrime të forta kundërshtuese për sa i përket ekspozimit të të rinjve ndaj armëve të zjarrit**. Mbi 80 përqind e të anketuarve shprehen të shqetësuar për ekspozimin e të rinjve ndaj përmbajtjeve të dhunshme në media dhe 65 përqind nuk janë dakord që fëmijët të luajnë me armë lodër. Këto qëndrime kundërshtuese janë veçanërisht më të theksuara në Shqipëri dhe Bosnjë-Hercegovinë, dhe shumë më pak në Kosovë dhe Mal të Zi. Ndërkohë, një shumicë e konsiderueshme besojnë se meshkujt në moshë madhore duhet të dinë si të përdorin armët e zjarrit, çka tregon për ekzistencën e një konsensusi të fshehtë kulturor që bën dallimin ndërmjet përshtatshmërisë së zotërimit të aftësive për përdorimin e armëve të zjarrit dhe zotërimit të tyre në praktikë.

**Në përgjithësi, banorët i perceptojnë procedurat ligjore për blerjen e armëve të zjarrit si komplekse dhe të vështira për t'u kuptuar.** Pothuajse gjysma e të anketuarve nuk ndihen të informuar mjaftueshëm në lidhje me procesin ligjor të blerjes, ku gratë raportojnë një nivel më të ulët informimi se burrat. Dallimet ndërmjet juridiksioneve ilustrojnë më tej përvojat e ndryshme: Të anketuarit në Malin e Zi e perceptojnë procesin si më të thjeshtë krahasuar me mesataren rajonale, ndërsa shumica dërrmuese e të anketuarve në Shqipëri dhe Serbi e përshkruajnë atë si të ndërlikuar. Kjo tregon se si dallimet në qartësinë e kuadrit rregullator ndikojnë te kërkesa dhe qëndrimet ndaj zotërimit të ligjshëm të armëve të zjarrit.

**Edhe pse pasiguria personale nxit fuqishëm kërkesën për armë zjarri, grupet e fokusit kanë konstatuar ekzistencën e perceptimeve të ndryshme mbi lidhjen e tyre.** Ndonëse shumë prej të anketuarve nga juridiksionet përmendin frikën nga krimi, dhunën e organizuar dhe kërcënimet personale, veçanërisht në Shqipëri, Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë, disa të tjerë mbeten skeptikë lidhur me faktin nëse armët e zjarrit rrisin sigurinë, dhe e vënë theksin te përmirësimi i sigurisë pas viteve 90'. Një pjesë e të anketuarave femra nënvizojnë shpeshherë shqetësimet lidhur me dhunën në familje dhe dhunën publike, dhe i shohin armët e zjarrit si mjete mbrojtëse, ndërsa disa të tjera nënvizojnë se zotërimi i armëve të zjarrit duhet të jetë përgjegjësi e institucioneve publike. Shqetësimet lidhur me normalizimin, keqpërdorimin aksidental dhe nivelin e dobët të zbatimit janë shfaqur në mënyrë të përsëritur.

**Normat kulturore dhe lidhjet simbolike me armët e zjarrit janë përshkruar nga pjesëmarrësit në grupet e fokusit si faktorë që formësojnë ndjeshëm kërkesën, veçanërisht te burrat**. Në të gjitha juridiksionet, gjuetia, tradita familjare dhe identiteti mashkullor shfaqen vazhdimisht si arsyet kryesore për zotërimin e armëve të zjarrit. Shpeshherë, armët e zjarrit trajtohen si pasuri e çmuar familjare që trashëgohen brez pas brezi dhe shihen si simbol i detyrës mashkullore për të mbrojtur familjen dhe shtëpinë. Edhe pse tradicionalisht të dominuara nga burrat, është konstatuar një rritje e interesit të grave në veprimtaritë e qitjes sportive dhe vetëmbrojtjes, çka sugjeron ndryshime në rolet gjinore tradicionale. Pavarësisht kësaj, traditat e rrënjosura thellësisht ndërlikojnë përpjekjet për të nxitur përdorimin e përgjegjshëm të armëve të zjarrit dhe miratimin e rregulloreve më të rrepta.

**Pjesëmarrësit në grupet e fokusit identifikuan mediat tradicionale dhe dixhitale si faktorë të fuqishëm nxitës në formësimin e qëndrimeve pozitive ndaj armëve të zjarrit, veçanërisht midis të rinjve.** Raportimi i krimit dhe dhunës në mënyrë provokuese, së bashku me portretizimet e armëve të zjarrit si simbole të heroizmit dhe fuqisë në kulturën popullore, duket se përforcojnë kërkesën. Platformat e mediave sociale normalizojnë më tej zotërimin e armëve të zjarrit nga meshkujt e rinj në moshë, të cilët "konsumojnë" dhe ndajnë rregullisht përmbajtje që lartësojnë armët pa pasur një kontekst thelbësor. Ky normalizim i nxitur nga media ndërlikon më tej përpjekjet për kontrollin e armëve të zjarrit dhe sugjeron nevojën për iniciativa edukative dhe ndërgjegjësuese më të sofistikuara dhe të synuara.

**Ekzistonin dallime të konsiderueshme ndërmjet pjesëmarrësve në grupet e konsultimit për rastet e krizave që advokonin për akses më liberal në armët e zjarrit dhe pjesëmarrësve që i frikësoheshin përshkallëzimit të dhunës, veçanërisht në kontekstin e dhunës familjare dhe nga partnerët intimë.** Pjesëmarrësit në të gjitha juridiksionet, duke përfshirë në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë, theksuan nevojën për një verifikim sigurie gjithëpërfshirës të aplikantëve për leje për armë zjarri, ekzaminime të shëndetit mendor dhe ruajtje të sigurt të armëve dhe municioneve. Edhe personat në

favor të rritjes së aksesit tek armët e zjarrit pranuan se rritja e numrit të armëve në pronësi mund të çojë në shtimin e rasteve të vetëvrasjes ose plagosjes aksidentale, veçanërisht tek të rinjtë.

**Zotëruesit e armëve të zjarrit duket se vlerësojnë si kontrollin po ashtu edhe traditën.** Gjatë diskutimeve të kryera, pronarët e armëve të ligjshme në Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinë e përshkruan veten si të përgjegjshëm, dhe u shprehën se shpeshherë përballen me kërkesa tejet strikte apo burokratike. Shumë prej tyre përmendën gjuetinë, koleksionimin ose lidhjet emocionale me armët e trashëguara si arsye për blerjen apo zotërimin e armëve të zjarrit. Pavarësisht ligjeve të rrepta për marrjen e lejeve, shumë prej pronarëve deklarojnë se zotërojnë disa armë zjarri, çka sugjeron se trashëgimia kulturore dhe shqetësimet mbi sigurinë individuale vazhdojnë të kenë më tepër peshë se pengesat financiare dhe administrative.

**Gjuetarët dhe qitësit sportivë kërkojnë barazi ligjore në zbatimin e kontrolleve për armët e zjarrit.** Siç pritej, gjuetarët dhe qitësit sportivë kanë mbështetje të jashtëzakonshme për përdorim dhe sigurt dhe të rregulluar të armëve të zjarrit. Megjithatë, ata shfaqin rëndom pakënaqësi lidhur me nivelin e tepërt të rregullimit të perceptuar prej tyre, duke përfshirë në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Pavarësisht rregullave të brendshme të rrepta në shoqatat e gjuetisë, pjesëmarrësit kritikuan mospërputhjet në zbatimin e ligjit dhe bënë thirrje për politika më të qarta dhe më proporcionale për armët e zjarrit.

**Shitësit e armëve paralajmërojnë hapa negativë në drejtim të kuadrit rregullator, si dhe mangësi në treg.** Shitësit e licencuar të armëve të zjarrit, veçanërisht në Shqipëri, Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë, konstatuan se frika nga krimet dhe lidhjet kulturore me armët e zjarrit janë faktorët që nxisin kërkesën. Megjithatë, rregullimi i tepërt, kufizimet e bankave për subjektet e shitjes me pakicë së armëve të zjarrit dhe kostot e larta të importit, u përshkruan si faktorë që shtyjnë blerësit e ligjshëm drejt tregjeve të paligjshme. Për shembull, shitësit në Kosovë nënvizuan ndikimin e inflacionit të çmimeve si pasojë e procedurave komplekse të importit. Shitësit në të gjitha juridiksionet bënë thirrje për politika të ekuilibruara që mundësojnë aksesin e ligjshëm duke kufizuar njëkohësisht tregtinë e paligjshme.

**Ekspertët për të rinjtë paralajmërojnë mundësinë e normalizimit dhe të distancimit emocional ndaj dhunës ekstreme me armë.** Ekspertët që punojnë me të rinjtë në Malin e Zi, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut konstatuan një nivel të rritur të pranimit, dhe madje edhe lartësim, të armëve të zjarrit nga disa adoleshentë. Diçka e tillë përforcohet nga media sociale, ndikimi nga bashkëmoshatarët dhe ekspozimi ndaj konflikteve në familje. Një fakt alarmues është se ekspertët në Serbi raportuan distancim emocional nga studentët pas vrasjeve në masë të vitit 2023 në një shkollë fillore në Beograd, çka sugjeron zhdukje të empatisë dhe një ndryshim shqetësues në perceptimin e rrezikut.

**Përfaqësuesit e mediave bënë thirrje për ndryshim të narrativës në raportimin e dhunës me armë dhe akses institucional në të dhënat e lidhura me armët e zjarrit.** Gazetarët nga Serbia, Shqipëria dhe Kosova kritikuan mungesën e standardeve koherente të raportimit dhe përdorimin e gjuhës provokuese në mbulimin e rasteve të lidhura me armët e zjarrit. Portretizimet gjinore dhe aksesi i kufizuar në të dhënat nga policia dhe institucionet gjyqësore kufizojnë raportimin e balancuar. Për më tepër, lartësimi i armëve të zjarrit në videot muzikore, filmat dhe përmbajtjet online (një fakt i përmendur veçanërisht në Maqedoninë e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovinë) vazhdon të ndikojë në perceptimet e të rinjve. Ekziston një konsensus i gjerë mbi nevojën për narrativa të përgjegjshme dhe për trajnime në fushën e medias.

**Disa autoritete publike nënvizojnë mangësitë e vazhdueshme në zbatimin e legjislacionit për armët e zjarrit në të gjithë Ballkanin Perëndimor.** Zyrtarë nga të gjashta juridiksionet kanë arritur një konsensus të gjerë për sa i përket faktit që pavarësisht se kuadrot ligjorë janë të fortë, efikasiteti i tyre kufizohet nga zbatimi jokonsistent, bashkëpunimi i pamjaftueshëm ndërmjet agjencive dhe strukturat institucionale të fragmentuara. Shqipëria dhe Bosnjë-Hercegovina janë vlerësuar për regjimet e rrepta të licencimit. Megjithatë, Shqipëria ka raportuar përpjekje për të luftuar tregtinë e paligjshme online të armëve të zjarrit dhe Bosnjë-Hercegovina ka raportuar përpjekje për të trajtuar tepricën e armëve nga konfliktet e mëparshme. Nga ana tjetër, është identifikuar se Kosova has goxha vështirësi lidhur me inspektimet rutinë në terren dhe mbikëqyrjen e zbatimit. Mali i Zi ka nënvizuar veçanërisht dobësitë e raportuara lidhur me vlerësimet mjekësore dhe psikologjike të aplikantëve, ndërsa reformat në Serbi që nga viti 2023 kanë synuar çështje kritike si armët e zjarrit të konvertuara dhe ato me origjinë nga periudha e luftës, duke e vënë theksin te reagimi dhe sfidat e mbetura në kuadrot rregullatorë. Zyrtarët kanë theksuar nevojën urgjente për zbatim më konsistent të ligjeve, përmirësim të bazave të të dhënave dhe koordinim më të mirë ndërmjet juridiksioneve, për të reduktuar në mënyrë efektive keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të zjarrit.

**Ligjet tejet penguese për armët e zjarrit mund të nxisin, në mënyrë të paqëllimshme, blerjen e paligjshme të tyre.** Kur procedurat ligjore perceptohen si tejet të vështira për shkak të kostove të larta, vonesave burokratike apo transparencës së kufizuar, civilët me preferencë të larta për zotërimin e armëve të zjarrit mund t'u drejtohet kanaleve informale. Pjesëmarrësit në grupin e fokusit, duke përfshirë pronarët e ligjshëm dhe tregtarët e licencuar, konstatuan se rregullat e ndërlikuara të importit, kostot e larta për përmbushjen e kërkesave dhe zbatimi i pabarabartë, mund të shtyjnë blerësit potencialë drejt tregut të zi ose blerjeve ndërkufitare. Këto dinamika përshkallëzohen nga pabarazitë rregullatore ndërmjet juridiksioneve, të cilat mund të lehtësojnë trafikimin dhe blerjet përmes përfaqësuesve fiktivë ("straw man").

**Veprimtaritë e lidhura me sferën kriminale vazhdojnë të ndikojnë te kërkesa për armë zjarri.** Intervistat me zyrtarë dhe ekspertë konfirmuan se grupet e krimit

të organizuar kanë akses të qëndrueshëm në armët e zjarrit. Zinxhirët e furnizimit të paligjshëm furnizohen nga stoqet e periudhave të konflikteve, armët jovdekjeprurëse të konvertuara dhe rrugët e trafikimit që shfrytëzojnë boshllëqe rregullatore ndërkufitare. Pavarësisht reformave ligjore për harmonizimin me legjislacionin e BE-së, të cilat vijojnë në çdo juridiksion, dobësitë në zbatim vazhdojnë të përbëjnë sfidë për kontrollin. Zyrtarët publikë në juridiksione nënvizuan qëndrueshmërinë e këtyre rrjeteve, çka sugjeron se nje legjislacion konvencional efektiv kundër kërkesës për armë në sferën kriminale është i lidhur ngushtësisht me përmirësimin e koordinimit dhe harmonizimit ligjor në nivel rajonal.

**Legjislacioni për armët e zjarrit mund të ndikojë në kërkesën për armë për përdorim civil duke ndikuar te preferencat, çmimet dhe burimet.** Siç sugjerohet nga modelet teorike dhe siç konfirmohet nga evidencat rajonale, niveli i rregullimit ndikon në kërkesën për armë zjarri duke riformësuar preferencat, duke rritur kostot e blerjes dhe duke kufizuar aksesin. Pjesëmarrësit në grupin e fokusit cituan në mënyrë të përsëritur kostot e larta, procesin kompleks të licencimit dhe paqartësitë administrative si faktorë pengues, ndërsa disa të tjerë i konsideronin po këta faktorë si nxitës të blerjeve të paligjshme. Edhe pse lidhja kulturore me armët e zjarrit mbetet e fortë, legjislacioni mund të ndryshojë legjitimitetin e perceptuar. Diçka e tillë u pa në ndryshimet në arsyet e dhëna pas reformave: arsyet e lidhura me mbrojtjen dhe kanosjen u rritën në Maqedoninë e Veriut dhe në Bosnjë-Hercegovinë, ndërsa arsyet e lidhura me veprimtaritë rekreative u rritën në Shqipëri dhe Kosovë.

**Duke pasur parasysh sa më lart, legjislacioni i ri mund të reduktojë dëmet e lidhura me armët pa zvogëluar nivelin e përgjithshëm të pronësisë.** Në mbarë Ballkanin Perëndimor, reformat ligjore janë shoqëruar me ulja të numrit të vetëvrasjeve, vrasjeve dhe plagosjeve me armë zjarri. Megjithatë, nivelet e pronësisë së ligjshme kanë vazhduar të rriten në shumicën e juridiksioneve, duke sugjeruar se nuk mjaftojnë vetëm ligjet për të frenuar kërkesën për armë për përdorim civil. Shqipëria, e cila miratoi kontrolle më të rrepta, regjistroi një rënie të përkohshme, çka thekson se është e rëndësishme që ndryshimet ligjore të shoqërohen nga masa të forta zbatuese dhe mesazhe të vazhdueshme publike.

**Ndryshimet në arsyet për zotërimin e armëve të zjarrit pasqyrojnë ndikimin simbolik dhe praktik të legjislacionit.** Të dhënat e anketimit tregojnë se arsyet e publikut për blerjen e armëve të zjarrit kanë evoluar në përgjigje të ndryshimeve ligjore. Në periudhat pas reformave (për shembull, 2016-2022), arsyet si gjuetia dhe veprimtaritë rekreative regjistruan rritje në disa juridiksione ndërsa vetëmbrojtja u përmend më shpesh në juridiksione të tjera. Këto tendenca sugjerojnë se legjislacioni mund të orientojë jo vetëm sjelljen, por edhe narrativat e lidhura me përdorimin e armëve të zjarrit, çka përforcon rëndësinë e perceptimit në formësimin e kërkesës.

**Të dhënat e besueshme në intervale kohore janë thelbësore për kontrollin efektiv të armëve të zjarrit.** Në të gjitha juridiksionet, shqyrtimi identifikoi mungesë të të dhënave të standardizuara dhe të shtrira në kohë për dhënien e lejeve për armët e zjarrit, pronësinë e tyre dhe dhunën e lidhur me armë. Pa një gjurmim konsistent, është e vështirë të vlerësohen ndikimet e legjislacionit apo të identifikohen modelet e reja të kërkesës. SEESAC dhe partnerët e tij janë në pozitën e duhur për të udhëhequr përpjekjet për harmonizimin e të dhënave, çka do të mundësojë standarde referencë më të mira në nivel rajonal, analiza të tendencave, si dhe projektim të politikave dhe të programit.

**Rekomandohet kryerja e një studimi të synuar të tregut për të kuptuar faktorët që nxisin kërkesën e paligjshme.** Për të plotësuar anketimin dhe analizën e grupit të fokusit, është thelbësore të kryhet një ekzaminim më i thellë i dinamikave të tregut të paligjshëm. Rastet studimore që shqyrtojnë ndërveprimin midis çmimit, disponueshmërisë së armëve të zjarrit dhe zbatimit të masave nga policia në të gjitha juridiksionet, mund të hedhin dritë mbi mënyrën se si kuadrot ligjorë ndikojnë në tregtinë e ligjshme dhe të paligjshme. Monitorimi i luhatjeve të çmimeve të armëve të zjarrit me leje dhe pa leje, përpara dhe pas reformave madhore, do të jepte një tablo më të qartë të ndikimit të politikave, duke mundësuar ndërhyrje më të përshtatura dhe të bazuara në evidenca.

# Rekomandimet strategjike

## Reduktimi i kërkesës për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor kërkon një strategji gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në evidenca që trajton blerjen dhe keqpërdorimin e armëve (të paligjshme).

Ky seksion paraqet një sërë rekomandimesh largpamëse për politikat, të bazuara në gjetjet e anketimeve rajonale, grupeve të fokusit, konsultimeve me ekspertë dhe analizës së çështjes. Propozimet janë projektuar për të mbështetur autoritetet publike, grupet e shoqërisë civile dhe partnerë të tjerë në forcimin e kontrollit të armëve të zjarrit dhe në zvogëlimin e kërkesës së ligjshme dhe të paligjshme. Rekomandimet theksojnë rëndësinë e sistemeve të të dhënave të shtrira në kohë, fushatave të ndërgjegjësimit të publikut, krijimit të besimit në institucionet e sigurisë, licencimit të bazuar në rrezik dhe veprimeve të koordinuara në nivel rajonal. Duke integruar masat parandaluese, edukative dhe zbatuese, si dhe duke harmonizuar përgjigjet në nivel vendor, juridiksioni dhe ndërkufitar, Ballkani Perëndimor mund të shkojë drejt një kuadri më të sigurt, transparent dhe të përgjegjshëm për kontrollin e armëve të zjarrit për përdorim civil.

## Forcimi i sistemeve të të dhënave të shtrira në kohë dhe i studimit të tregut për të monitoruar kërkesën për armë zjarri dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit në mbarë Ballkanin Perëndimor.

Pavarësisht përmirësimeve të kohëve të fundit, mungesa e të dhënave të standardizuara në intervale kohore për zotërimin, licencimin dhe sekuestrimin e armëve të ligjshme dhe të paligjshme, si dhe për dhunën me armë, zvogëlon mundësinë për të vlerësuar kërkesën dhe për të zhvilluar ndërhyrje të përshtatshme. Autoritetet rajonale, me mbështetje nga organizatat rajonale si SEESAC, duhet t'i japin përparësi harmonizimit të të dhënave ndërmjet juridiksioneve dhe duhet të përmirësojnë cilësinë e të dhënave për të gjurmuar tendencat me kalimin e kohës. Indikatorët e besueshëm janë thelbësorë për të vlerësuar ndikimin e legjislacionit, për të identifikuar pikat e nxehta (hotspot) të veprimtarisë së paligjshme dhe për të orientuar ndërhyrjet e synuara.

Përmes bashkëpunimit me institucionet kërkimore vendase, SEESAC mund të udhëheqë gjithashtu një iniciativë rajonale për të hartëzuar dhe monitoruar dinamikat e tregut të armëve të zjarrit, duke përfshirë tendencat e çmimeve, rrugët e trafikimit dhe mangësitë në zbatim. Kjo do të përfshinte porositjen e studimeve të synuara në nivel juridiksioni, zhvillimin e një kuadri të harmonizuar për gjurmimin e veprimtarive në tregun e zi, si dhe krijimin e një qendre themelore të të dhënave për të mbështetur politikëbërjen e bazuar në fakte. Gjithashtu, gjetjet mund të mbështesin sistemet e paralajmërimit të hershëm që parashikojnë ndryshimet në treg, si dhe dialogët mbi politikat që synojnë harmonizimin e legjislacionit dhe përmirësimin e koordinimit ndërkufitar në kuadër të zbatimit.

## Zhvillimi dhe kryerja e fushatave strategjike të ndërgjegjësimit dhe edukimit.

Për të zvogëluar preferencën e shoqërisë për armë zjarri, autoritetet dhe shoqëria civile në Ballkanin Perëndimor duhet të zhvillojnë fushata të synuara të ndërgjegjësimit të publikut, duke u fokusuar veçanërisht te meshkujt e rinj dhe të rritur (të rrezikuar). Përmbajtja edukative duhet të integrohet në kurrikulën shkollore që në moshë të vogël, duke u fokusuar te rreziqet që u kanosen pjesëtarëve të familjes dhe miqve nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit dhe përmbajtjes së rrezikshme online. Duhet të miratohen programe mbi njohuritë mediatike për të ndihmuar të rinjtë që të vlerësojnë në mënyrë kritike lartësimin e armëve në filma, video muzikore dhe videolojëra. Ndërtimi i partneriteteve me edukatorët, shoqërinë civile dhe organizatat e drejtuara nga të rinjtë mund të ndihmojë për të garantuar dhënien e mesazheve në formate angazhuese dhe të përshtatshme sipas kontekstit. Fushatat publike duhet të përshtaten për të pasqyruar realitetin specifik në juridiksione dhe duhet të projektohen për të parandaluar

normalizimin dhe përcjelljen ndër breza të qëndrimeve që përkrahin keqpërdorimin dhe zotërimin e paligjshëm të armëve të zjarrit.

Në të njëjtën kohë, institucionet duhet të shfrytëzojnë mediat sociale dhe tradicionale duke trajnuar gazetarët mbi praktikat e raportimit të përgjegjshëm, si dhe duke angazhuar influencuesit dhe figurat publike për të ndërtuar narrativa më konstruktive mbi armët e zjarrit, duke përfshirë në lidhje me aspekte si burrëria, siguria dhe tradita. Kjo mund të përfshijë zhvillimin në mënyrë të përbashkët të përmbajtjeve lidhur me figurat vendase, si personalitetet sportive, udhëheqësit fetarë dhe artistët, për të zhvlerësuar lidhjen midis armëve të zjarrit dhe forcës, statusit apo patriotizmit. Njoftimet periodike në shërbimet publike mund të promovojnë alternativa të tjera ndaj mbajtjes së armëve për vetëmbrojtje dhe mund të nxjerrin më mirë në pah dëmet afatgjata sociale dhe psikologjike të shkaktuara nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit. Mesazhet duhet të jenë të qëndrueshme dhe të dukshme, si dhe duhet të jetë vlerësuar ndikimi i tyre për të garantuar ndryshime afatgjata në sjellje dhe qëndrime.

## Vendosja e fokusit në përmirësimin e sigurisë faktike dhe të perceptuar, si dhe në forcimin e besimit tek institucionet

Kërkesa e përhapur për armë zjarri shpeshherë e ka origjinën te ndjesitë e pasigurisë personale, mungesa e besimit tek institucionet publike dhe frika e vazhdueshme e lidhur me konfliktet e armatosura aktuale dhe/ose të mëparshme. Autoritetet publike duhet të ndërmarrin hapa proaktivë për të përmirësuar sigurinë e publikut dhe mekanizmat e drejtësisë penale, duke përfshirë, në veçanti, njësi policore të dukshme, gjithëpërfshirëse dhe reaguese ndaj shqetësimeve vendore. Integrimi i masave parandaluese për armët e zjarrit në strategjitë më të gjera të zvogëlimit të krimit dhe dhunës në familje është një element kritik, pasi gratë dhe të rinjtë shpeshherë përmendin mbrojtjen si arsye kryesore të interesit për armë zjarri. Njësitë policore duhet të trajnohen në qasjet e parandalimit të traumës dhe të pajisen me njohuri për t'u angazhuar me komunitetet e prekura nga trashëgimi i konflikteve, përjashtimi social ose kanosja kriminale.

Për më tepër, autoritetet mund të zgjerojnë dhe të promovojnë mekanizma anonimë dhe të sigurt që u mundësojnë banorëve të ndajnë shqetësimet lidhur me armët e paligjshme, pa pasur frikë nga hakmarrja. Këto sisteme duhet të mbështeten nga ekipe të ndërhyrjes së shpejtë që janë në gjendje t'u përgjigjen kërcënimeve me armë zjarri, në veçanti në ambientet familjare ose shkollore, përpara përshkallëzimit të dhunës. Nga ana e tyre, institucionet gjyqësore duhet të garantojnë zbatimin në mënyrë konsistente dhe transparente të dënimeve për zotërimin e paligjshëm, trafikimin dhe keqpërdorimin e armëve, duke përfshirë në rastet kur shkelja përfshin aktorë nga institucionet publike. Duke shfaqur paanshmëri dhe profesionalizëm, sistemi i drejtësisë penale mund të zhvlerësojë gradualisht arsyen për mbajtjen e armëve dhe mund të rrisë besimin e publikut te sundimi i ligjit. SEESAC mund ta mbështesë këtë axhendë duke lehtësuar të nxënit ndërkufitar, duke zhvilluar tregues risku për armët e zjarrit që do të aplikohen nga policia, si dhe duke mbështetur kurrikulat e trajnimit në përputhje me realitetet rajonale.

## Përmirësimi dhe zbatimi i sistemeve të dhënies së lejeve për armët e zjarrit përmes një qasjeje parandaluese dhe të bazuar në rrezik

Dhënia e lejeve për armët e zjarrit në Ballkanin Perëndimor duhet të shërbejë jo vetëm si një mekanizëm mbrojtës, por si një instrument proaktiv i sigurisë publike me synim identifikimin dhe përjashtimin e individëve me rrezik të lartë. Për të arritur këtë objektiv, autoritetet publike mund të përmirësojnë sistemet ekzistuese duke përcaktuar si praktikë kryerjen e vlerësimeve psikologjike të detyrueshme dhe të standardizuara, si dhe duke forcuar ndjeshëm verifikimet e së shkuarës, në veçanti për aplikantët me historik të dhunës në familje, lidhje kriminale, sjellje të rrezikshme dhe probleme me shëndetin mendor. Gjithashtu, mund të rritet mbikëqyrja ndaj institucioneve mjekësore private për të parandaluar vlerësimet sipërfaqësore ose të falsifikuara. Mekanizmat e vlerësimit duhet të rishikohet në mënyrë periodike për të marrë në konsideratë ndryshimet në rrethanat personale. Rritja e kufirit ligjor të moshës për zotërimin e armëve në 25 vjeç, si dhe shqyrtimi i mundësisë së dhënies së miratimit nga bashkëshorti ose pjesëtarët e familjes, mund të ofrojë nivele shtesë mbrojtjeje në familjet e cenueshme.

Po aq i rëndësishëm është edhe monitorimi i përshtatshëm pas dhënies së lejes për armë zjarri. Autoritetet publike duhet të përcaktojnë si praktikë kryerjen e inspektimeve të detyrueshme dhe periodike në terren nga profesionistë të trajnuar për të verifikuar ruajtjen në mënyrë të sigurt, përshtatshmërinë e vazhdueshme dhe faktin nëse aplikanti vazhdon ta ketë në zotërim armën. Këto kontrolle duhet të udhëhiqen nga protokolle të qarta, dhe dyshimet duhet të rezultojnë automatikisht në rishikime të mëtejshme ose në revokim të lejes. Njohuritë e policisë vendase, të cilat përdoren në mënyrë informale në disa vende, duhet të integrohen në mënyrë formale në proceset e vendimmarrjes. Gjithashtu, bazat e të dhënave të juridiksioneve duhet të dixhitalizohen, të ndërlidhen dhe të ndërveprojnë me ato të policisë, sistemit gjyqësor dhe sektorit shëndetësor, për të garantuar përditësime në kohë reale dhe sinjalizime automatike. SEESAC mund të mbështesë këto reforma duke lehtësuar shkëmbimin rajonal mes homologëve, duke zhvilluar udhëzime teknike dhe duke ofruar module trajnimi për të garantuar një qasje licencimi të unifikuar dhe të bazuar në rrezik, në të gjitha juridiksionet.

## Nxitja e zotërimit të përgjegjshëm dhe zgjerimi i alternativave ligjore të dorëzimit vullnetar

Zvogëlimi i disponueshmërisë së armëve të zjarrit, në veçanti i armëve të paligjshme ose të mbajtura në mënyrë të pasigurt, kërkon strategji të qëndrueshme, të bazuara në komunitet, të cilat ndërthurin dorëzimin vullnetar me nxitjen e zotërimit të përgjegjshëm. Autoritetet publike duhet të përcaktojnë si praktikë periodike amnistitë dhe fushatat, të mbështetura nga veprimtari të qarta të informimit të publikut, mesazhe në media dhe incentiva praktike, si zbritje në faturat e shërbimeve utilitare, zbritje të taksave vendore ose akses në shërbime të subvencionuara. Siç është faktuar nga iniciativat e mëparshme

në rajon, suksesi amplifikohet duke garantuar anonimitet, duke dhënë garanci për mosndjekje penale dhe përmes angazhimit aktiv të figurave në komunitet, autoriteteve bashkiake dhe organizatave të shoqërisë civile. Në rajonet ku ka pasur konflikte të armatosura dhe mungesë besimi në autoritetet publike, mesazhet e përshtatura në nivel lokal dhe informimi mbi parandalimin e traumës mund të ndihmojnë për të tejkaluar skepticizmin dhe për të normalizuar dorëzimin vullnetar.

Paralelisht, duhet të krijohet një kulturë më e fortë e zotërimit të përgjegjshëm të armëve përmes edukimit dhe zbatimit të masave rregullatore. Zyrtarët duhet të zgjerojnë fushatat lidhur me ruajtjen e sigurt, veçanërisht në zonat rurale dhe në zonat ku ka shumë zotërues të armëve. Kjo mund të realizohet përmes incentivave të tilla si dhënia falas ose subvencionimi i kasafortave për armët, përmes ofrimit të programeve vullnetare të certifikimit për ruajtjen e sigurt, si dhe përmes masave si inspektimet rastësore në banesë për pronarët e pajisur me leje. Këto veprime forcojnë normat e sigurisë publike, si dhe u mundësojnë autoriteteve të identifikojnë kushtet e rrezikshme përpara se të përshkallëzohen. Gjithashtu, kuadrot ligjorë duhet të miratojnë një model zbatimi më progresiv, duke bërë dallimin midis shkeljeve administrative (p.sh. armë e zjarrit të trashëguara por të paregjistruara) dhe përdorimit për veprimtari kriminale (p.sh. armët e përdorura për kanosje ose sulme). Kjo qasje e kalibruar mund të nxisë pajtueshmërinë ligjore pa krijuar vështirësi për pronarët e ligjshëm dhe mund të krijojë alternativa më të qarta për regjistrimin ose dorëzimin vullnetar. SEESAC mund të shërbejë si katalizator duke koordinuar shkëmbimet e praktikave më të mira, duke mbështetur zhvillimin e fushatave dhe duke monitoruar rezultatet në juridiksione.

## Përmirësimi i koordinimit rajonal dhe institucional për të zvogëluar kërkesën për armë zjarri

Trafikimi i armëve të zjarrit dhe zotërimi i paligjshëm në Ballkanin Perëndimor kanë natyrë ndërkombëtare dhe nuk mund të trajtohen në mënyrë kuptimplotë përmes përpjekjeve të fragmentuara në nivel juridiksioni. Autoritetet publike duhet të përshpejtojnë kalimin nga koordinimi i posaçëm (ad hoc) në platformat e institucionalizuara dhe të formalizuara për shkëmbimin e inteligjencës, bashkëpunimin operacional dhe ngritjen e kapaciteteve në mënyrë të përbashkët. Harmonizimi i klasifikimeve të armëve të zjarrit, standardeve të dhënies së lejeve dhe protokolleve të regjistrimit është thelbësor për të eliminuar mangësitë që shfrytëzohen nga trafikantët, veçanërisht në juridiksionet me kontrolle të pamjaftueshme ose zbatim jokonsistent. Dallimet në ekzaminimet mjekësore, kufijtë e moshës minimale dhe praktikat e inspektimit në terren në juridiksione, aktualisht krijojnë cenueshmëri që mund të shfrytëzohen nga grupet e organizuara për të zgjedhur juridiksionin me rregullat më të favorshme.

Në nivel juridiksioni, autoritetet vendore duhet të përmirësojnë infrastrukturën dixhitale për të garantuar gjurmim në kohë reale të armëve të zjarrit përmes ciklit të tyre të jetës, nga importi dhe shpërndarja e deri te përdoruesi fundor dhe çaktivizimi. Bazat e ndërveprueshme të të dhënave duhet të mundësojnë lidhje midis ministrisë së

brendshme, doganave, sektorit shëndetësor, sistemit gjyqësor dhe organeve ligjzbatuese. Ushtrimet simuluese ndërkufitare periodike, seminaret për ndarjen e informacionit dhe shkëmbimet mes ekspertëve jo vetëm që mund të përmirësojnë kapacitetet zbatuese, por mund të rrisin gjithashtu besimin tek institucionet dhe harmonizimin e politikave. Ngritja e një mekanizmi të pavarur mbikëqyrës për të monitoruar pajtueshmërinë me standardet e përbashkëta dhe miratimi i standardeve referencë publike mund të rrisë llogaridhënien. Përpjekjet e koordinuara, si p.sh. ato të lehtësuara nga SEESAC, mund të ndihmojnë në shkatërrimin e rrjeteve të trafikimit, eliminimin e mangësive në zbatim, si dhe mund të mbrojnë përpjekjet në nivel juridiksioni që të mos cenohen nga zbatimi i dobët në juridiksionet fqinje.

## Zgjerimi i mediave online dhe angazhimi strategjik dixhital për të ndryshuar preferencat e lidhura me kërkesën për armë zjarri

Ndryshimi i perceptimit publik dhe zvogëlimi i kërkesës për armë zjarri në Ballkanin Perëndimor kërkon një strategji proaktive dhe të koordinuar për mediat dixhitale. Autoritetet publike duhet të krijojnë partneritete, kur është e mundur, me mediat tradicionale dhe ato online, si dhe me grupet përkatëse të shoqërisë civile, për të nxitur raportimin e saktë, të përgjegjshëm dhe jo provokues të incidenteve të lidhura me armë zjarri, me qëllim që të luftohet lartësimi i kulturës së armëve që është identifikuar si një shqetësim kryesor nga grupet e fokusit dhe ekspertët për të rinjtë. Transparenca institucionale dhe trajnimi mbi mediat janë gjithashtu thelbësore. Në të njëjtën kohë, platformat e mediave sociale duhet të angazhohen për të kufizuar përmbajtjet që nxisin përdorimin e armëve të zjarrit, veçanërisht tek adoleshentët. Qeverisja vendore, shoqëria civile dhe krijuesit e përmbajtjeve dixhitale, duke përfshirë muzikantët, transmetuesit online dhe zhvilluesit e lojërave, duhet të mobilizohen për të zhvilluar bashkërisht mesazhe kundër dhunës dhe për të eksploruar vullnetarisht kode të sjelljes për mënyrën e shfaqjes së armëve të zjarrit në industrinë e zbavitjes. Gjithashtu, duhet të forcohen protokollet për komunikimin në raste krizash, të cilat aktivizohen pas incidenteve të të shtënave të profilit të lartë, me qëllim që të parandalohet keqinformimi, të minimizohen rreziqet e replikimit/kopjimit të krimeve dhe të kanalizohet vëmendja drejt burimeve parandaluese.

Paralelisht, në programet institucionale dhe të donatorëve duhet të integrohen fushata dixhitale afatgjatë për të trajtuar konfuzionin e publikut lidhur me zotërimin e ligjshëm dhe të paligjshëm të armëve të zjarrit, si dhe për të normalizuar dorëzimin vullnetar. Këto përpjekje duhet të shkojnë përtej përgjigjeve reaktive ndaj krizave dhe duhet të ofrojnë mesazhe gjatë të gjithë vitit që theksojnë përgjegjësitë e zotërimit të armëve dhe që nënvizojnë rreziqet e keqpërdorimit të tyre, në veçanti në kontekstin familjar dhe nga të rinjtë. Të dhënat nga anketimi dhe grupet e fokusit nënvizojnë se frika nga krimi, pasiguria personale dhe ndjesia e detyrave burrërore, janë faktorë që nxisin kërkesën, ndërsa njohuria e publikut mbi ligjet është e ulët. Fushatat duhet të përshtaten sipas këtyre dinamikave, si dhe duhet të përfshijnë të dhëna nga monitorimi në mediat sociale dhe studimet mbi sjelljen. Mesazhet duhet të fokusohen tek të rinjtë,

të krijojnë lidhje emocionale dhe të shpërndahen përmes platformave me angazhim të lartë, si TikTok, Instagram dhe YouTube, duke përdorur një gjuhë që pasqyron realitetet vendore. Duke u ndërthurur me iniciativat në nivel komuniteti dhe arsimin me bazë shkollën, angazhimi dixhital strategjik mund të ndryshojë normat dhe të ulë kërkesën për armë zjarri me kalimin e kohës.

*Shtojca 1.*

# Shqyrtimi i hipotezave të përzgjedhura mbi kërkesën për armë zjarri

| ***Hipoteza për kërkesën*** | ***Mekanizmi*** | ***Rezultati*** | ***Vëzhgimet*** |
|---|---|---|---|
| Perceptimet për nivel të lartë pasigurie rrisin kërkesën për armë zjarri | Synimi për të pasur më shumë siguri dhe për të mbrojtur veten, familjen, shtëpinë dhe pronën, nxit blerjen/zotërimin e ligjshëm dhe/ose të paligjshëm të armëve të zjarrit. | Po | Të dhënat nga anketimi dhe grupet e fokusit sugjerojnë se pasiguria është një faktor nxitës kryesor në të gjitha juridiksionet, veçanërisht në juridiksionet ku besimi në institucione është i ulët (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë). |
| Përvoja e viktimizimit rrit kërkesën për armë zjarri | Synimi për të parandaluar përsëritjen e viktimizimit të vetes, familjes apo personave të tjera, nxit blerjen/zotërimin e ligjshëm dhe/ose të paligjshëm të armëve të zjarrit. | Po | Të dhënat nga grupet e fokusit dhe intervistat treguan se gratë dhe të rinjtë i përmendën traumat personale dhe dhunën në familje si faktorë të lidhur me kërkesën për armë zjarri. |
| Normat e burrërisë rrisin kërkesën për armë zjarri | Dëshirat për të përmbushur nevojat për të pasur influencë dhe status, si dhe nocionet e burrërisë, nxisin blerjen/zotërimin e ligjshëm dhe/ose të paligjshëm të armëve të zjarrit | Po | Anketimet, grupet e fokusit dhe intervistat me ekspertë e mbështesin fuqimisht këtë pohim në të gjitha juridiksionet: rolet mbrojtëse dhe pritshmëritë ndër breza nxisin kërkesën. |
| Zakonet tradicionale të lidhura me zotërimin e armëve ndikojnë te kërkesa | Dëshira për të përmbushur vazhdimisht pritshmëritë dhe normat mbizotëruese (këtu përfshihen të shtënat festive, nocionet e pavarësisë) nxit blerjen/zotërimin e ligjshëm dhe/ose të paligjshëm të armëve të zjarrit | Po | Anketimet, grupet e fokusit dhe intervistat konstatuan se ka ndërlidhje të forta kulturore me armët e zjarrit (veçanërisht për gjuetinë), si dhe lidhje simbolike dhe të lidhura me ceremonitë (veçanërisht në Bosnjë-Hercegovinë dhe Mal të Zi). |

| ***Hipoteza për kërkesën*** | ***Mekanizmi*** | ***Rezultati*** | ***Vëzhgimet*** |
|---|---|---|---|
| Gjuetia për qëllime të sigurimit të jetesës mund të formësojë kërkesën për armë zjarri | Preferencat për armë zjarri mund të ndikohen nga nevojat për sigurimin e jetesës, në veçanti lidhur me rezervat e gjuetisë. | Pjesërisht | Anketimet dhe grupet e fokusit treguan se gjuetia është një ndër faktorët kryesorë nxitës, edhe pse më shumë për qëllime rekreative se sa për të siguruar jetesën. |
| Disponueshmëria e gjerë e armëve të zjarrit rrit kërkesën | Preferenca e vazhdueshme dhe ulja e kostove të armëve të zjarrit (si pasojë e disponueshmërisë së lartë) kontribuojnë në blerjen/ zotërimin e ligjshëm dhe/ose të paligjshëm të armëve të zjarrit | Pjesërisht | Edhe pse lidhja shkak-pasojë e këtij pohimi është komplekse, dëshmitë anekdotike sugjerojnë se disponueshmëria e stoqeve nga periudha e luftës dhe niveli i ulët i zbatimit bëjnë që kërkesa të mbetet në nivele të larta, veçanërisht në tregjet e paligjshme. |
| Një legjislacion i rreptë për armët e zjarrit zvogëlon kërkesën për armë të ligjshme | Rritja e çmimeve të blerjes së armëve të zjarrit, si pasojë e rregullave dhe rregulloreve të vendosura, mund të zvogëlojë më tej nivelin e pronësisë së ligjshme | Jo detyrimisht | Të dhënat nga shqyrtimi statistikor tregojnë se ligjet e rrepta mund të zvogëlojnë dëmet e lidhur me armët e zjarrit, por jo detyrimisht pronësinë e tyre në të gjitha juridiksionet. |
| Legjislacioni për armët e zjarrit dhe ndërhyrjet përkatëse mund të ndikojnë në nivelin e viktimizimit | Miratimi dhe zbatimi i ligjeve për dhënien e lejeve dhe pronësinë e armëve të zjarrit mund të ketë ndikim në uljen e formave të caktuara të viktimizimit | Po | Një shqyrtim i të dhënave administrative zbuloi se niveli i vrasjeve, vetëvrasjeve dhe krimeve të tjera me armë pëson një ulje të përgjithshme në periudhat pas reformave. Lidhjet shkak-pasojë duhet të mbështeten nga një analizë statistikore më e detajuar. |
| Direktivat e BE-së rrisin kërkesën për kategori të caktuara të armëve të zjarrit | Harmonizimi i ligjeve për armët e zjarrit me direktivat e BE-së për armët e zjarrit që ndalojnë armët e zjarrit të kategorisë A, mund të kontribuojë në rritjen e blerjeve të armëve të zjarrit të kategorisë B.[61] | Të dhëna të pamjaftueshme | Edhe pse teorikisht është e mundur, nuk ka të dhëna nga rajoni që ta mbështesin këtë pretendim. Nevojitet analizë e mëtejshme. |

**61** Sipas Direktivës së BE-së "Për armët e zjarrit" (2017), llojet e armëve të zjarrit grupohen në kategoritë A, B dhe C. Armët e kategorisë A janë të ndaluara, përveçse nga individë të caktuar. Armët e zjarrit të kategorisë

| ***Hipoteza për kërkesën*** | ***Mekanizmi*** | ***Rezultati*** | ***Vëzhgimet*** |
|---|---|---|---|
| Ngjarjet e vrasjeve në masë mund të rezultojnë në uljen e kërkesës për armë zjarri. | Tronditja psikologjike dhe emocionale nga vrasjet në masë mund të ndryshojë preferencat për armë zjarri dhe, nëse shoqërohet nga kufizime legjislative, mund të rrisë çmimet.[62] | Pjesërisht | Sipas intervistave me grupet e fokusit, pezullimet e përkohshme të lejeve dhe reagimet nga publiku rezultuan në rënie të shitjeve pas të shtënave në vitin 2023 në Serbi. Nevojitet një analizë më e detajuar për të konfirmuar këto tendenca. |
| Teknologjitë e reja, si p.sh. printimi në 3D, mund të rrisin kërkesën. | Prodhimi i decentralizuar i armëve të zjarrit, si dhe i pjesëve dhe komponentëve specifikë, mund të reduktojë ndjeshëm koston, (në terma realë dhe relativë) dhe të nxisë kërkesën. | Të dhëna të pamjaftueshme | Nuk ka të dhëna të qarta në rajon për ta konfirmuar këtë dinamikë, edhe pse është një rrezik i ri që ia vlen të kihet parasysh. |
| Lartësimi dhe tregtimi i armëve të zjarrit përmes internetit. | Ekspozimi në faqet e shitjes që lartësojnë armët e zjarrit mund të rrisë preferencat, ndërsa aksesi në armë zjarri me zbritje çmimi në faqet e Darknet-it mund të ulë çmimin e tyre. | Të dhëna të pamjaftueshme | Disa prej grupeve të fokusit nënvizuan se si normalizimi dhe lartësimi i armëve të zjarrit në media mund të ndikojë te kërkesa. Për më tepër, studimet për përdorimin e Darknet-it në rajon janë në nivele të ulëta. |

B kërkojnë “autorizim”. Në rastin e armëve të zjarrit të kategorisë C, duhet të deklarohet pronësia e tyre, por nuk nevojitet autorizim. Armët e zjarrit të kategorisë A përfshijnë të gjitha armët e dorës dhe pushkët automatike dhe gjysmëautomatike me krehra që mund të mbajnë më shumë se 10 fishekë (në rastin e pushkëve), ose më shumë se 20 fishekë (në rastin e armëve të dorës).

**62** Hipoteza alternative, sipas së cilës vrasjet në masë mund të rrisin kërkesën, është e pranishme ne SHBA, e cila besohet se ka mangësi në këtë drejtim.

*Shtojca 2.*

# Shpjegimi i elementeve që ndikojnë te faktorët e përzgjedhur të kërkesës dhe mbrojtjes.

| | ***Faktorët e rrezikut dhe ato mbrojtës*** | ***Shpjegimi duke përdorur teorinë e kërkesës*** |
|---|---|---|
| ***Në nivel individual*** | Mashkull në moshë të re/të mesme (faktor rreziku) | Rrit *preferencën* për armë zjarri si pasojë e normave të burrërisë, ndikimit nga bashkëmoshatarët dhe lidhjeve kulturore me forcën, mbrojtjen dhe statusin. |
| | Mungesa e perceptuar e sigurisë (faktor rreziku) | Rrit *preferencën* për zotërimin e armëve të zjarrit si një mekanizëm vetëmbrojtjeje, veçanërisht në vendet ku besimi tek institucionet është i dobët. |
| | Përvoja me viktimizimin (faktor rreziku) | Shton *preferencën* si pasojë e traumës, nevojës emocionale për kontroll dhe frikës nga përsëritja e incidenteve. |
| | Precedentët penalë (faktor rreziku) | Kufizon aksesin ligjor (çmim i lartë), por *rrit preferencën* për kanale të paligjshme; shpeshherë, lidhet me kërkesën për armë të pagjurmueshme. |
| | Përfshirja në krim (faktor rreziku) | Rrit në mënyrë të drejtpërdrejtë *aksesin* në tregjet e paligjshme dhe *ul kostot e blerjes*, duke i bërë armët e zjarrit më të preferuara dhe më të aksesueshme. |
| | Femër në moshë të re/e moshuar (faktor mbrojtës) | Ka tendencën të zvogëlojë *preferencën* si pasojë e perceptimeve kulturore, shmangies së rrezikut dhe shqetësimeve lidhur me keqpërdorimin; përjashtim bëjnë kontekstet e dhunës në familje. |
| | Siguria dhe mbrojtja e perceptuar (faktor mbrojtës) | Ul *preferencën* për armë zjarri, veçanërisht për qëllime vetëmbrojtjeje, duke rritur besimin te mbrojtja nga institucionet. |
| | Niveli më i lartë arsimor dhe/ose të ardhurat më të larta (faktor mbrojtës) | Mund të zvogëlojë *preferencën* falë rritjes së ndërgjegjësimit, por *rrit burimet* për blerje të ligjshme dhe ruajtje të sigurt. |
| | Ndërgjegjësimi mbi rreziqet dhe trajnimet për sigurinë (faktor mbrojtës) | Zvogëlon *preferencën* dhe *normalizon sjelljen e përgjegjshme*; mbrojtje kundër keqpërdorimit impulsiv apo simbolik. |

| | ***Faktorët e rrezikut dhe ato mbrojtës*** | ***Shpjegimi duke përdorur teorinë e kërkesës*** |
|---|---|---|
| ***Në nivel familjeje*** | Prania e armëve të zjarrit në banesë (faktor rreziku) | Rrit *preferencën* si pasojë e familjariteti me armët dhe normalizimit të tyre; rreziku rritet nëse armët ruhen në mënyrë të papërshtatshme ose keqpërdoren. |
| | Ekspozimi ndaj dhunës ndërpersonale dhe abuzimi me substancat (faktor rreziku) | Rrit *preferencën* si pasojë e nivelit të shtuar të frikës, mungesës së perceptuar të qëndrueshmërisë dhe normalizimit të dhunës. |
| | Mungesa e armëve të zjarrit në banesë (faktor mbrojtës) | Zvogëlon *preferencën* dhe *aksesin*, duke shërbyer si element që kufizon kërkesën, veçanërisht tek të rinjtë. |
| | Ruajtja e sigurt e armëve të zjarrit në banesë (faktor mbrojtës) | Zvogëlon rrezikun e keqpërdorimit, impulsivitetit apo vjedhjes; ul *aksesin efektiv* duke ruajtur njëkohësisht pronësinë. |
| | Prindërimi pozitiv dhe mbështetja nga bashkëmoshatarët (faktor mbrojtës) | Ul *preferencën* përmes modeleve të mospërdorimit të dhunës dhe krijimit të lidhjeve emocionale; lidhet me reduktimin e nivelit të lartësimit të armëve. |
| | Mosdhënia e pëlqimit nga familjarët ose partneri (faktor mbrojtës) | Ul *preferencën* si pasojë e frenimit nga personat e afërm, veçanërisht në rastin e individëve të pavendosur apo që nuk janë të prirur ndaj rrezikut. |
| ***Në nivel komuniteti*** | Normat sociale që normalizojnë përdorimin e armëve (faktor rreziku) | Rrit *preferencën* përmes validimit kulturor (p.sh. të shtënat festive, etiketimet "heroike"). |
| | Dhuna në komunitet dhe pakënaqësitë historike (faktor rreziku) | Mbështet ose shton *preferencën*, veçanërisht në komunitetet me trauma nga konfliktet ose me tensione etnike të perceptuara. |
| | Efikasiteti dhe kohezioni social i dobët (faktor rreziku) | Rrit *preferencën* për strategji vetëmbrojtjeje, si p.sh. armatimi, veçanërisht në rastet kur institucionet zyrtare mungojnë ose konsiderohen të anshme. |
| | Normat sociale që dekurajojnë përdorimin e armëve të zjarrit (faktor mbrojtës) | Zvogëlon *preferencën* duke nxitur eliminimin e stigmatizimit ose zgjidhjen e konflikteve jo të dhunshme; mbështetet nga institucionet dhe udhëheqësit në nivel vendor. |
| | Mjedisi i qëndrueshëm në lagje dhe shkollimi (faktor mbrojtës) | Stabilizon rrugëtimin e të rinjve dhe zvogëlon ekspozimin ndaj mjediseve me rrezik; kufizon formimin e *preferencës* për armë. |

| | ***Faktorët e rrezikut dhe ato mbrojtës*** | ***Shpjegimi duke përdorur teorinë e kërkesës*** |
|---|---|---|
| | Numri i ulët i incidenteve me armë zjarri në komunitet (faktor mbrojtës) | Stabilizon rrugëtimin e të rinjve dhe zvogëlon ekspozimin ndaj mjediseve me rrezik; kufizon formimin e *preferencës* për armë. |
| ***Në nivel shoqërie*** | Burrëria dhe normat e nderit (faktor rreziku) | Rrit *preferencën* për zotërimin e armëve, në veçanti kur lidhet me aspekte si mbrojtja, trashëgimia apo statusi. |
| | Nivelet e larta të pabarazisë (faktor rreziku) | Rrit *preferencën* te popullsitë e margjinalizuara që i perceptojnë armët e zjarrit si element mbrojtjeje ose fuqizimi. |
| | Besimi i ulët tek institucionet e sigurisë (faktor rreziku) | Cenon besimin te siguria publike, rrit *preferencën* për armë zjarri personale, duke përfshirë të paligjshme. |
| | Mungesa e qëndrueshmërisë në periudhat pas konflikteve (faktor rreziku) | Rrit *preferencën* e bazuar te frika; shpeshherë, lidhet me pasigurinë e identitetit dhe traumën në komunitet. |
| | Prania e krimit të organizuar (faktor rreziku) | Ul çmimin, rrit *aksesin* dhe shton *preferencën* përmes normalizimit në ambientet kriminale. |
| | Faktorët nxitës online dhe teknologjikë (faktor rreziku) | Rrisin *aksesin* dhe *ulin çmimin* përmes kanaleve të paligjshme; normalizojnë kërkesën përmes lartësimit të armëve nëpërmjet mjeteve dixhitale. |
| | Besimi i publikut tek institucionet (faktor mbrojtës) | Ul *preferencën* për mjete për vetëmbrojtje duke rritur besimin tek institucionet e drejta dhe të besueshme të sigurisë. |
| | Normat që favorizojnë barazinë gjinore (faktor mbrojtës) | Kufizojnë kërkesën e nxitur nga normat e burrërisë dhe *zvogëlojnë preferencën*, veçanërisht te meshkujt e rinj në moshë. |
| | Niveli i ulët i pabarazisë dhe investimet sociale (faktor mbrojtës) | Nxisin stabilitetin dhe zvogëlojnë kërkesën e krijuar nga margjinalizimi apo pakënaqësitë. |
| | Perceptimi për rregullore efektive për armët e zjarrit dhe për zbatimin efektiv të tyre (faktor mbrojtës) | Rrit çmimin (përmes barrierave) dhe ul *preferencën*, veçanërisht kur rregulloret zbatohen në mënyrë të drejtë. |

*Shtojca 3.*

# Analiza statistikore e variablave parashikues dhe klasifikues

Studimet e mëparshme sugjerojnë se individët që shprehin një dëshirë për të zotëruar armë zjarri dhe që kanë më shumë përvojë në situatat që përfshijnë armë zjarri, janë më të prirur për të shfaqur qëndrime pozitive ndaj zotërimit dhe përdorimit të armëve të zjarrit. Për të testuar këto supozime, SEESAC realizoi një analizë klasifikuese, pra një vlerësim statistikor me shumë variabla që përcakton klasifikimin e një grupi, duke përdorur rezultatet e anketimit në të 6-ta juridiksionet.[63]

Gjetjet sugjerojnë se variablat parashikues me lidhjet më të forta statistikore me kërkesën për armë zjarri janë qëndrimi pozitiv ndaj zotërimit të armëve të zjarrit[64], përvoja e mëparshme me mbajtjen e armëve të zjarrit dhe pranimi i përdorimit të armëve të zjarrit në skenarë të caktuar.[65] Lidhje më pak të forta janë identifikuar në lidhje me perceptimin e të anketuarve mbi efektet e disponueshmërisë universale dhe përvojën me armët e zjarrit në kontekste të dhunshme.

| ***Variablat klasifikues*** | ***Koeficientët*** |
|---|---|
| Qëndrimi mbështetës ndaj zotërimit të armëve të zjarrit | ***.65*** |
| Përvoja me mbajtjen e armëve të zjarrit | ***.55*** |
| Qëndrimi mbështetës ndaj përdorimit të armëve të zjarrit në kontekste të caktuara | ***.33*** |
| Perceptimi mbi efektin që ka aksesi universal tek armët e zjarrit në nivelet e krimit | ***.16*** |
| Përvoja me armët e zjarrit në kontekste të dhunshme | ***.02*** |

**63** Analiza shqyrtoi pesë variabla specifikë: 1) përvoja me mbajtjen e armëve të zjarrit, 2) përvoja me armët e zjarrit në një kontekst të dhunshëm, 3) qëndrimi mbështetës ndaj pohimeve specifike që mbështesin mbajtjen e armëve të zjarrit, 4) niveli i pranimit të përdorimit të armëve të zjarrit në situata të caktuara, dhe 5) perceptimi mbi efektin që ka aksesi universal tek armët e zjarrit në nivelet e krimit.

**64** Qëndrimi pozitiv ndaj zotërimit të armëve të zjarrit u përcaktua bazuar në katër pyetje: çdo mashkull në moshë madhore duhet të zotërojë armë zjarri; çdo femër në moshë madhore duhet të zotërojë armë zjarri; zotërimi i armëve të zjarrit është një pjesë e rëndësishme e identitetit kombëtar; juridiksioni juaj duhet të miratojë ligje më tolerante dhe më pak strikte për zotërimin dhe përdorimin e armëve të zjarrit.

**65** Kontekstet e pranueshme përfshinin: gjatë festimeve, për vetëmbrojtje në rastet kur dikush tjetër sulmon i pari, për vetëmbrojtje në rastet kur ekziston rreziku i një sulmi, si dhe për të kërcënuar/lënduar/ndëshkuar persona të tjerë.

# Referenca të përzgjedhura


Abbasi, H. 2021. What's behind far-right trend of using 3D tech to make guns?, Al Jazeera, 31 July. https://www.aljazeera.com/news/2021/7/31/what-behind-far-right-trend-using-3d-tech-make-guns

Al Jazeera 2023. Eight children, security guard killed in Belgrade school shooting, 3 May. https://www.aljazeera.com/news/2023/5/3/school-shootout-kills-one-injures-five-in-serbias-belgrade

Arsovska, J. 2015. Decoding Albanian Organised Crime: Culture, Politics, And Globalisation, University of California Press. https://www.jstor.org/stable/10.1525/j.ctt13x1h1s

Arsovska, J. 2014. Introduction: Illicit Firearms Market in Europe and Beyond. European Journal on Criminal Policy Research 20, 295–305. https://link.springer.com/article/10.1007/s10610-014-9254-6#cities

Arsovska, J. 2008. Illicit arms trafficking and the limits of rational choice theory: the case of the Balkans, Trends in Organised Crime 11, October 22. https://www.academia.edu/12994251/Illicit_arms_trafficking_and_the_limits_of_rational_choice_theory_the_case_of_the_Balkans

Arsovska, J. and Zabyelina, Y. 2014. 'Irrationality, Liminality and the Demand for Illicit Firearms in the Balkans and the North Caucasus' . European Journal on Criminal Policy and Research, Vol. 20, Issue 3, 399-420. https://link.springer.com/article/10.1007/s10610-014-9231-0#citeas

Bennett, C. and Saferworld. 2011. Public perceptions of safety and security in Kosovo: Time to act, May. https://www.saferworld.org.uk/resources/publications/553-public-perceptions-of-safety-and-security-in-kosovo

Bice, D. and Hemley, D. 2002. The Market for New Handguns: An Empirical Investigation, The Journal of Law andhttps://www.seesac.org/f/docs/Gender-and-SALW/Gender-Analysis-Report_NORTH-MACEDONIA.pdf Economics (45) 1. https://www.journals.uchicago.edu/doi/10.1086/324656

Boerman, F., et al. 2017. Nationaal dreigingsbeeld 2017: Georganiseerde criminaliteit [National threat assessment 2017: Organised crime], Driebergen: Dienst Landelijke Informatieorganisatie. https://www.politie.nl/binaries/content/assets/politie/onderwerpen/nationaal-dreigingsbeeld/2017/nationaal-dreigingsbeeld-2017.pdf

Borgogna, N., McDermott, R. and Brasil, K. 2022. The precarious masculinity of firearm ownership, Psychology of Men and Masculinities 23(2). https://psycnet.apa.org/doiLanding?doi=10.1037%2Fmen0000386

Brauer, J. and Muggah, R. 2007. Completing the Circle: Building a Theory of Small Arms Demand, Contemporary Security Policy 27(1). https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/13523260600603279?journalCode=fcsp20

British Broadcasting Corporation (BBC). 2021. Spain dismantles workshop making 3D-printed weapons, BBC, 19 April. https://www.bbc.com/news/world-europe-56798743

Bronic, A. and Vasovic, A. 2023. Man with neo-Nazi symbols kills 8 in second Serbia mass shooting, 5 May. https://www.reuters.com/world/europe/two-killed-several-injured-serbian-village-shooting-2023-05-04/

Calcut, R., et al. 2019. Effects of mass shootings on gun sales: a 20-year perspective, Journal of Trauma Acute Care and Surgery 87(3). https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC7369030/

Carapic, J. 2014. Handgun Ownership and Armed Violence in the Western Balkans, SAS Issue Brief, September. https://www.smallarmssurvey.org/resource/handgun-ownership-and-armed-violence-western-balkans-av-issue-brief-4

Centre for Peace and Disarmament Education and Saferworld. 2005. Turning the Page: Small Arms and Light Weapons in Albania, December. https://www.files.ethz.ch/isn/15132/Albania.pdf

Chaudhri, V. and Geanakoplos, J. 1998. A note on the economic rationalization of gun control, Economic Letters 58. http://dido.econ.yale.edu/~gean/art/1998-el58.pdf

